



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLI I LARTË I SHITETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

RAPORT AUDITIMI PERFORMANCE

"Ndikimi i aktivitetit minerar në fondin pyjor"

Tiranë 2025

P Ë R M B A J T J A

| | | |
|-----------|--|-----------|
| 1. | PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDIMIT..... | 5 |
| | 1.1 Konteksti i problemit social..... | 5 |
| | 1.2 Rëndësia e auditimit të performancës..... | 6 |
| | 1.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë..... | 7 |
| 2. | SUBJEKTI/ET NËN AUDITIM..... | 8 |
| | 2.1 Hyrje në subjektet nën auditim..... | 8 |
| | 2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim..... | 13 |
| | 2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit..... | 14 |
| | 2.4 Pesha në buxhet..... | 15 |
| | 2.5 Përkufizimet dhe terminologjia..... | 17 |
| | 2.6 Skema e analizës së programit auditues..... | 19 |
| | 2.7 Feedback-u i subjektit gjatë auditimit..... | 19 |
| 3. | DETAJET E AUDITIMIT..... | 20 |
| | 3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit..... | 20 |
| | 3.2 Objektivi i auditimit..... | 20 |
| | 3.3 Pyetjet e auditimit..... | 21 |
| | 3.4 Fushëveprimi i auditimit..... | 22 |
| 4. | SHTJELLIMI I PYETJEVE AUDITUESE..... | 22 |
| | 4.1 Si është gjendja e fondit pyjor në vendin tonë?..... | 22 |
| | 4.2 A ka politika për të siguruar mbrojtjen e fondit pyjor nga aktiviteti mineral?..... | 25 |
| | 4.3 A është garantuar nga institucionet përgjegjëse monitorimi dhe inspektimi i mbrojtjes dhe rehabilitimit të fondit pyjor nga ndikimi i aktivitetit mineral?..... | 35 |
| 5. | TRAJTIMI I OBSERVACIONEVE..... | 48 |
| 6. | ANEKSE | 57 |
| 7. | GRUPI I PUNËS | 66 |

Lista e shkurtimeve

| | |
|----------------|--|
| RSH | Republika e Shqipërisë |
| BE | Bashkimi Evropian |
| KLSH | Kontrolli i Lartë i Shtetit |
| MIE | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë |
| MTM | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit |
| AKM | Agjencia Kombëtare e Mjedisit |
| AKBN | Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore |
| AKP | Agjencia Kombëtare e Pyjeve |
| NJVQV | Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore |
| QKB | Qendra Kombëtare e Biznesit |
| SHGJSH | Shërbimi Gjeologjik Shqiptar |
| VKM | Vendimi i Këshillit të Ministrave |
| TVSH | Tatim mbi vlerën e shtuar |
| PRM | Plani i Rehabilitimit të Mjedisit |
| RKFP | Regjistri Kombëtar i Fondit Pyjor |
| INTOSAI | The International Organization of Supreme Audit Institutions |
| EUROSAI | The European Organisation of Supreme Audit Institutions |

PËRMBLEDHJE

Mbrojtja dhe menaxhimi i pyjeve janë të domosdoshëm për të siguruar një të ardhme të shëndetshme për njerëzit dhe planetin. Ato *luajnë një rol të rëndësishëm në reduktimin e fatkeqësive natyrore, zbusin ndryshimet klimatike, kontribuojnë në balancimin e oksigjenit, dyoksidit të karbonit, lagështirës, etj.*¹

Në vendin tonë, për shkak të vlerës dhe rëndësisë së tyre, pyjet janë pasuri kombëtare dhe trajtohen si të tilla.

Nëpërmjet auditimit me temë “*Ndikimi i aktivitetit mineral në fondin pyjor*” është synuar vlerësimi dhe analizimi i masave të marra nga institucionet përgjegjëse me qëllim mbrojtjen e fondit pyjor nga aktiviteti mineral. Gjithashtu për të siguruar që politikat për mbrojtjen e pyjeve të jenë efektive dhe të integruara për sigurimin e një ekuilibri midis ruajtjes së fondit pyjor, zhvillimit ekonomik dhe mjedisit.

Nëpërmjet këtij auditimi u analizua në mënyrë objektive dhe të paanshme veprimtaria e Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, Ministrisë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe Bashkive Selenicë, Skrapar, Krujë, Dimal, Berat për periudhën 2021-2023 për të parë se deri në çfarë mase ka qenë efektive dhe efiçiente veprimtaria e bashkëpunimi i këtyre institucioneve për mbrojtjen e fondit pyjor.

Në përfundim të auditimit u evidentua se:

Procesi i heqjes nga fondi pyjor për lejet minerare pajisura me leje shfrytëzimi dhe leje mjedisi pothuajse në shumicën e rasteve nuk finalizohet me akt ligjor.

Monitorimin për realizimin e planeve të rehabilitimit të mjedisit nga aktiviteti mineral në fondin pyjor nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, pothuajse nuk është realizuar.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore nuk ka pasur bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe Njësive të Vetëqeverisjes Vendore lidhur me veprimtarinë e subjekteve që ushtrojnë aktivitetet mineral në fondin pyjor në territoret që administrohen nga Bashkitë Selenicë, Skrapar, Krujë, Dimal, Berat.

Rehabilitimit mjedisor është kryer vetëm 4 % të sipërfaqes totale, ndërsa procesi i ripyllëzimit është kryer vetëm nga një subjekt në Bashkia Dimal për sipërfaqen prej 16.2 ha.

Raportet e monitorimit të kryera nga Agjencia Kombëtare të Burimeve Natyrore nuk japin informacion të plotë mbi respektimin e realizimit të projektit mineral, realizimin e operacioneve e të punimeve minerare dhe depozitimin e mbetjeve minerare, lëvizjen e rezervave minerare, kryerjen e operacioneve minerare, respektimin e standardeve të sigurisë në punë e të mbrojtjes së shëndetit të punonjësve.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit në periudhën 2021-2023 nuk ka kryer inspektime subjektet minerare që zhvillojnë aktivitetin në fondin pyjor.

Vlera e fondit për rehabilitimin e sipërfaqeve të pyjeve e depozituar është shumë herë më e ulët se vlera për rehabilitim e përllogaritur nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;

Në Bashkitë Dimal, Berat, Çorovodë, Selenicë dhe Krujë, subjektet e pajisur me leje minerare që ndikojnë në fondin pyjor nuk disponojnë kontrata mbi marrjen e detyrimit të përcaktuar për pyllëzimin, ripyllëzimin apo përmirësimin e fondit pyjor të hequr si pasoje e aktivitetit mineral.

Për të gjitha çështjet e mësipërme, janë dhënë rekomandime në drejtim të përmirësimit të shkaqeve që çojnë në këto mangësi me qëllim eliminimin dhe zbutjen e ndikimeve negative që këto problematika kanë në mjedis, ekonomi dhe shëndetin e popullsisë.

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT

1.1 Konteksti i problemit social

Roli jetësor i pyjeve, mbrojtja dhe menaxhimi i tyre i qëndrueshëm janë të domosdoshëm për të siguruar një të ardhme të shëndetshme për njerëzit dhe planetin.

Pyjet luajnë një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm për ekosistemet dhe mirëqenien e njerëzve ku disa prej tyre mund të përmendim:

- *Rregullimi i Klimës dhe Reduktimi i CO₂*, pyjet janë ndër "lavamanët" kryesorë të karbonit, prodhimin të oksigjenit, thelbësor për jetën e gjallë;
- *Ruajtja e Biodiversitetit*, pyjet janë shtëpia e rreth 80% të biodiversitetit të tokës, shumë specie të rrezikuara e kanë habitatin e tyre kryesor në pyje;
- *Mbrojtja dhe Parandalimi i Erozionit*, rrënjët e pemëve mbajnë tokën të qëndrueshme, dhe veprojnë si barriera natyrore për ujë;
- *Burim i Ujit të Pastër*, pyjet ndihmojnë në filtrimin e ujit, duke e pastruar atë nga ndotjet dhe duke mbrojtur burimet ujore që ushqejnë lumenjtë dhe liqenet;
- *Rregullimi i ciklit të ujit*: pyjet luajnë një rol kyç në rregullimin e ciklit të ujit;
- *Burime Ekonomike dhe Sociale Produkte natyrore dhe zhvillimin e komuniteteve lokale*;
- *Rregullimi të Temperaturave Lokale*, pyjet ndihmojnë në uljen e temperaturave;
- *Përfitime Shëndetësore dhe Psikologjike*, kontakti me natyrën dhe pyjet ka treguar përfitime për shëndetin mendor, duke reduktuar stresin dhe përmirësuar gjendjen emocionale;
- *Përballimit të i Ndryshimeve Klimatike dhe adaptimit të tyre klimatike*.

“Pyjet luajnë një rol të rëndësishëm në reduktimin e risqeve për të ndodhur fatkeqësi natyrore, si p.sh. përmytjet, thatësitrat, rrëshqitjet e dheut apo ngjarje të tjera ekstreme. Ato zbusin ndryshimet klimatike nëpërmjet përthithjes së karbonit, kontribuojnë në balancimin e oksigjenit, dyoksidit të karbonit dhe lagështisë në ajër, si dhe mbrojnë pellgjet ujëmbledhëse.”¹

Në vendin tonë, për shkak të vlerës dhe rëndësisë së tyre, pyjet janë pasuri kombëtare dhe trajtohen si të tilla. Funkzioni i pyjeve si një e mirë publike prevalon mbi çdo interes tjetër të çdo subjekti.² Referuar dokumenteve të politikave³, vendi ynë nuk po kalon një situatë të mirë sa i përket pyjeve, në vitet e fundit, ⁴ kjo se cilësia e pyjeve tona ka ardhur duke u ulur duke u karakterizuar si një *“vend i pasur me pyje të varfër”*.⁵ Sipas të dhënave të INSTAT⁶, shumë shqetësuese shfaqet rënia e volumit të pyjeve me rreth 40% në 15 vitet e fundit, ku në vitin 2022 volumi ishte rreth 50 milion³, krahasuar me 80 milion³ në vitin 2006. Referuar të njëjtit burim, edhe fondi pyjor kombëtar ka pësuar rënie krahasuar me vitin 2006.

Një ndikim negativ në fondin pyjor ndërmjet të tjerave ka edhe aktiviteti minerar. Në vendet në zhvillim vlerësohet se 7% e pyjeve të humbura është shkaktuar nga aktiviteti minerar⁷. Ky është një shqetësim në rritje edhe në Shqipëri, pasi një pjesë e aktivitetit minerar zhvillohet në ngastra, të cilat janë pjesë e fondit kombëtarë pyjor, e që rrjedhimisht e ndikon atë. Disa nga demet që sjellin aktivitetet minerare në janë:

- *Humbja e sipërfaqeve pyjore*, ku shumë aktivitetet minerare shpesh kërkojnë prerjen dhe shkatërrimin e pyjeve për të krijuar hapësira për eksplorim dhe nxjerrje të mineraleve;
- *Shkatërrimi i tokës*, nxjerrja minerare shkatërron strukturën e tokës për rritjen e bimëve;
- *Erozioni*, pastrimi i tokës për aktivitete minerare shkakton erozion të madh;
- *Ndotja e ujërave*, aktiviteti minerar kontribuon në ndotjen e burimeve ujore;
- *Humbja e biodiversitetit*, pyjet janë shtëpia e shumë specieve bimore dhe shtazore;

¹ Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm nr. 15, përshkrimi, <https://sdgs.un.org/topics/forests>

² Pika 1, neni 12, Ligji, nr. 57/2020, datë 30.4.2020 “Për Pyjet”

³ VKM 814, date 31.12.2018.

⁴ Mbi politikat e sektorit të pyjeve në Shqipëri 2019-2023, MTM, Dhjetor 2018, fq. 6

⁵ Mbi politikat e sektorit të pyjeve në Shqipëri 2019-2023, MTM, Dhjetor 2018, fq. 7

⁶ <https://www.instat.gov.al/al/temat/bujq%C3%ABsia-dhe-peshkimi/pyjet/#tab2>

⁷ Programi për Pyjet, Banka Botërore, qershor 2024, <https://www.profor.info/content/forest-smart-mining-advance-new-york-declaration-forests-and-sustainable-development-goals-0>

- *Ndryshimi i mikroklimës*, pyjet ndikojnë në ruajtjen e mikroklimave specifike;
- *Degradimi social-ekonomik* disa komunitete varen nga pyjet për burime jetese.

Kjo bën të nevojshëm identifikimin e ndikimit që aktiviteti minerar ka në fondin pyjor.

Për sa më sipër për të zbutur këto efekte, kërkohen politika të forta për mbrojtjen e pyjeve, si dhe plane për rehabilitimin e zonave të prekura nga minierat pas përfundimit të aktiviteteve minerare, të cilat duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të balancojnë nevojat ekonomike me mbrojtjen e mjedisit. Më poshtë janë disa elemente thelbësore që duhen përfshirë në këto politika dhe plane janë :

- ✓ *Politikat për mbrojtjen e pyjeve* si krijimi i zonave të mbrojtura dhe kufizimi i shfrytëzimit; ligje të rrepta dhe monitorimi i zbatimit të tyre; mbrojtja e të drejtave të komuniteteve lokale; inkurajimi i praktikave të qëndrueshme minerare;
- ✓ *Planet për rehabilitimin e zonave të prekura nga minierat* si rehabilitimi i tokës dhe pyllëzimi; kontrolli i erozionit dhe mbrojtja e tokës; monitorimi ekologjik; krijimi i rezervave natyrore;
- ✓ *Fonde dhe marrëveshjet për pastrimin dhe rehabilitimin* si të krijohet një fond nga kompanitë minerare që të përdoret për rehabilitimin pas përfundimit të aktiviteteve të tyre; hartimin e marrëveshjeve me kushte të qarta për rehabilitimin e zonave pas përfundimit të shfrytëzimit.

Të gjitha këto janë thelbësore për të siguruar që shfrytëzimi i mineraleve nuk sjell dëme të pariparueshme në ekosistemet pyjore, duke promovuar gjithashtu zhvillimin e qëndrueshëm.

Në dokumentet e politikave kombëtare për pyjet⁸ theksohet se, subjektet që shfrytëzojnë sipërfaqet pyjore nuk përmbushin detyrimin për ripyllëzimet apo zëvendësimin e tyre pas heqjes nga fondi pyjor, çka ndër vite ka rënduar gjendjen e pyjeve në vend. Në vitet e fundit, në Raport Progreset e BE-së për vendin tonë theksohet se, duhet të ndërmerren masa të menjëhershme për të rishikuar dhe përmirësuar cilësinë e vlerësimeve mbi ndikimin që sektori minerare ka në mjedis⁹, duke siguruar përfshirjen dhe konsultimin e publikut në këtë proces.

Për të gjitha këto madje dhe të tjera në kompleksitet, ky auditim merr një rëndësi të veçantë për të siguruar që politikat për mbrojtjen e pyjeve të jenë efektive dhe të integruara për sigurimin e një ekuilibri midis ruajtjes së fondit pyjor, zhvillimit ekonomik dhe mjedisit. Gjithashtu, për të mundësuar vlerësimin e bashkëpunimit midis institucioneve përgjegjëse për mjedisin, industrinë, etj., nëse politikat për mbrojtjen dhe menaxhimin e pyjeve janë efektive e të mjaftueshme, për shfrytëzimin e burimeve natyrore pa dëmtuar ekosistemet dhe zbatuar ligjet.

1.2 Rëndësia e auditimit të performancës

Auditimet e performancës vlerësojnë nëse synimet e politikave dhe skemat qeverisëse lidhen me problemet reale të shoqërisë dhe shqetësimet e palëve të interesit, duke dhënë një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjithë projekteve dhe programeve në entet publike të audituara. Këto auditime kryhen duke u bazuar tek Standardet Ndërkombëtare ISSAI dhe Udhëzuesi i Auditimit të Performancës (ISSAI 300, 3000, 3100, 3200, 5100 dhe 5200), Manuali i Auditimit të Departamentit të Performancës, Indikatorët e Performancës sipas praktikave më të mira audituese, të cilat shërbejnë si udhërrëfytes për konceptimin, planifikimin, kryerjen, konkludimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit të performancës. Këto dokumente përmbajnë një numër udhëzimesh dhe informacionesh që marrin në konsideratë kushtet specifike dhe karakteristikat e çdo auditimi performance. Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke synuar realizimin e misionit të tij, si institucion që ofron një ekspertizë të pavarur në ndihmë të një menaxhimi sa më të përgjegjshëm në shërbim të qytetarëve, jep një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjitha projekteve dhe programeve të institucioneve dhe enteve publike të audituara. Nëpërmjet auditimit të performancës synohet të analizohet ekonomiciteti, eficaenca dhe efektiviteti i programeve të ekzekutivit.

⁸ Mbi politikat e sektorit të pyjeve në Shqipëri 2019-2023, MTM, Dhjetor 2018, fq.21.

⁹ KE, Raport progresi vjetor për Shqipërinë, viti 2023, fq. 104.

Në linjë me prioritetet e përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH-së 2023-2027, miratuar me Vendimin nr. 247 datë 29.12.2022 të Kryetarit, KLSH ndërmori auditimin e performancës me temë “Ndikimi i aktivitetit minerar në fondin pyjor”. Ndikimi i subjekteve të pajisur me leje minerare në fondin pyjor, përmbushjen e masave kompensuese mbi ripyllëzimin dhe roli i institucioneve publike që administrojnë këto pasuri kombëtare, konsiderohen çështjet të ndjeshme në menaxhimin e pyjeve.

KLSH nëpërmjet këtij auditimi synon të paraqesë situatën aktuale në sipërfaqet pyjore të prekura nga shfrytëzimi minerar dhe rolin e institucioneve në lidhje me zbatimin e legjislacionit mbi administrimin e pyjeve nga subjektet të pajisur me leje minerare.

Në përfundim do të jepen rekomandimet përkatëse për të përmirësuar situatën aty ku është e mundur.

1.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në veprimtarinë e tij audituese gjatë viteve të fundit i ka kushtuar një rëndësi gjithmonë e më të madhe auditimit të veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse për përdorimin e fondit pyjor, si në nivel qendror ashtu edhe në nivelin vendor, me synim mbrojtjen e pyjeve si pasuri me rëndësi të veçantë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka ushtruar një sërë auditimesh pranë subjekteve nën auditim. Disa prej tyre si më poshtë:

- Auditim financiar dhe i përputhshmërisë të ushtruar në MTM, viti 2023;
- Auditim financiar dhe i përputhshmërisë të ushtruar në MIE viti 2022;
- Auditim financiar dhe i përputhshmërisë të ushtruar në AKP viti 2022;
- Auditim i përputhshmërisë të ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit viti 2023;
- Auditimi financiar dhe i përputhshmërisë të ushtruar në Bashkinë Dimal viti 2023;
- Auditimi financiar dhe i përputhshmërisë të ushtruar në Bashkinë Krujë viti 2024;
- Auditimi financiar dhe i përputhshmërisë të ushtruar në Bashkinë Selenicë viti 2023;
- Auditimi financiar dhe i përputhshmërisë të ushtruar në Bashkinë Skrapar viti 2023;
- Auditim “Për licensimin e subjekteve me veprimtari në fushën minerare viti 2023;
- Auditimin e Performancës me temë “Performanca e sistemit të shfrytëzimit minerar të mermerëve” viti 2023.

Për periudhën objekt auditimi nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në auditimet e ushtruara si më lart në lidhje me fondin pyjor në pronësi të bashkive janë konstatuar parregullsi e shkelje:

- Në tre Bashki Dimal, Krujë e Selenicë: në një rast kontrata e lidhur është dhënë jo në përputhje me kondicionet urbane sipas PPV në fuqi, në kohën e miratimit të kontratës; në dy raste subjektet qiramarrëse nuk kanë paguar detyrimet e kontratës; në një rast nuk është kryer inventarizimi kadastral pyjor për përditësimin e fuqisë lëndore, fuqisë kullimore, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës); në një rast nuk është shpallur lista për dhënie në përdorim e vendeve ose të shesheve të fondit pyjor publik, ku mund të ushtrohen këto veprimtari, për punë kërkimore e studimore, për mbarështim të florës dhe faunës së egër e për gjueti, për baza didaktike apo eksperimentale, për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike; në një rast pyjet e kullotat, ndonëse kanë kaluar në pronësi, nuk janë pasqyruar në kontabilitet;

- Nga auditimi i komunikimit shkresor midis AKM dhe QKB u konstatua se: në regjistrin e lejeve ekzistojnë leje me format të vjetër, VNM/Deklarata Mjedisore si dhe subjekte të pajisur me leje mjedisore apo VNM pa raportuar asnjëherë konkretisht, 1274 Leje Mjedisore format i vjetër si dhe 590 VNM/Deklarata Mjedisore.

- Agjencia Kombëtare e Pyjeve nga auditimi rezultoi së është jashtë sistemit të inspektimit, kryesisht për shkak se nuk janë unifikuar me Inspektoratin Qendror; Aktet nënligjore plotësuese në zbatim të ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet” ende nuk janë miratuar, konkretisht mungojnë rreth 18 VKM dhe udhëzime; Në lidhje me procesin inventarizimit të fondit pyjor konstatohet se inventari i fundit i përket vitit 2018 e për rrjedhojë rezulton se nuk ka nisur cikli i radhës 8 vjeçar i ri-inventarizimit kombëtar të pyjeve; Regjistri Kombëtar i Fondit Pyjor (RKFP) nuk është i plotë, pasi në këtë fond pyjor nuk janë të pasqyruara ato sipërfaqe pyjorë të cilat i kanë kaluar në pronësi Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit; Procesi i dixhitalizimit të fondit pyjor në sistemin ALFIS është i paplotë, pasi

rezultojnë se është pasqyruar pjesërisht vetëm fondi pyjor nën administrimin e bashkive dhe jo sipërfaqet pyjore të ministrive dhe Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura

- Në auditimin me temë “Performanca e sistemit të shfrytëzimit mineral të mermerëve”, është konstatuar: se asnjë prej subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e shfrytëzimit të mermerit nuk janë të pajisur me aktin përkatës ligjor/nënligjor (Miratimin e Ministrit të MTM, VKM ose Ligj të veçantë) për ndryshimin/heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes pyjore të shfrytëzuar; Sipërfaqja “de facto” ose reale e fondit pyjor në vitin 2022 është ulur me 0.89 km²; për 7 subjekte nuk është miratuar ndryshimi/heqja nga fondi pyjor, këto sipërfaqe rezultojnë ende në Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor, kur aktualisht ato janë sipërfaqe e shfrytëzuar si aktivitet mineral; evidentohet se sipërfaqja e shfrytëzuar rezulton të jetë 0.8879 km², ndërsa sipërfaqja e prekur nga rehabilitimi i mjedisit progresiv ose përfundimtar është 0; një subjekt i pajisur me leje minerare zhvillon veprimtari pa disponuar lejen mjedisore, duke qenë në mos përputhje me kriteret e përcaktuara në ligjin mineral dhe mjedisor.

2. SUBJEKTET NËN AUDITIM

2.1 Hyrje në subjektet nën auditim

Subjektet që do të përfshihen në këtë auditim janë:

1. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit
3. Agjencia Kombëtare e Pyjeve
4. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
5. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
6. Bashkia Selenicë,
7. Bashkia Skrapar
8. Bashkia Krujë
9. Bashkia Dimal
10. Bashkia Berat

➤ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)

Figura 1. Organigrama e strukturës përgjegjëse për pyjet në MTM



Burimi :MTM Përpunoi: Grupi i auditimit


Organigrama e MTM përfshin Drejtorinë e Natyrës dhe Pyjeve, pjesë e së cilës është dhe Sektori i Pyjeve e cila është struktura përgjegjëse për pyjet.

Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit, në përmbushje të rolit të saj, nëpërmjet strukturave përgjegjëse për pyjet në ministri ka këto përgjegjësi:

- Menaxhon procesin e hartimit të politikave për pyjet, përmirëson kuadrin ligjor rregullator në fushën e pyjeve, monitoron zbatimin dhe efektivitetin e tij, si dhe përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare për pyjet;
- planifikon financimin e sektorit bazuar në politikat dhe prioritetet e miratuara, duke garantuar shpërndarjen e drejtë dhe eficiente të fondeve;
- miraton planet e mbarështimit për të gjitha format e pronësisë;
- certifikon ekspertë për ushtrimin e veprimtarisë së certifikimit të shërbimeve të ekspertizës dhe profesionale në pyje e kullota, si dhe i shfuqizon ato sipas përcaktimeve të ligjit për pyjet ¹⁰.

➤ **Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)**

Figura 2. Organigrama e strukturës përgjegjëse për mjedisin në AKM



Burimi :AKM; Përpunoi: Grupi i auditimit

Agjencia Kombëtare e Mjedisit, nëpërmjet Drejtorisë së Shqyrtimit dhe Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve (Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis) ka këto kompetenca¹¹:

- shqyrton kërkesa për VNM paraprake apo deklarata mjedisore për veprimtari minerare sipërfaqësore dhe jep mendimin e saj në lidhje me këto veprimtari.
- shqyrton kërkesa për leje mjedisi Kod III.1 për veprimtari minerare sipërfaqësore dhe jep mendimin e saj mbi kërkesat e subjekteve.
- një nga kushtet e Vendimeve për VNM për këtë tip veprimtarie citohet: të bëhet zbatimi i ligjit 57/2020 “Për pyjet”.

¹⁰ Neni 15, Përgjegjësitë e institucioneve qendrore për pyjet, Ligj nr. 57/2020 “Për pyjet”


¹¹ VKM nr.568/2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit” e ndryshuar.

- bazuar në ligjin nr.10440/2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar "VNM/Deklaratë është e vlefshme pasi subjekti të bëjë heqjen nga Fondi Pyjor, në rast se aktiviteti bie në një të tillë."¹²
- një nga kushtet e lejeve mjedisore për këtë tipologji veprimtarie citohet: "Të jenë marrë të gjitha masat e nevojshme që në rast se sipërfaqja e kërkuar bie në Fond Pyjor, operatori të ndjekë procedurën për heqjen dorë nga Fondi Pyjor, përpara fillimit të punimeve të shfrytëzimit."

➤ Agjencia Kombëtare e Pyjeve (AKP)

Agjencia Kombëtare e Pyjeve, ka si mision: "Mirëqeverisjen e pyjeve në nivel kombëtar, ruajtjen dhe zhvillimin e tyre, përdorimin e qëndrueshëm dhe shumëfunksional të burimeve në fondin pyjor kombëtar, si pasuri natyrore me rëndësi kombëtare". Në funksionin drejtues Agjencia Kombëtare e Pyjeve ka rolin e një autoriteti që garanton performancën dhe efikasitetin e sektorit, siguron standarde dhe metodologji për aktivitetet dhe operacionet e sektorit, angazhon palët e interesuara dhe forcon koordinimin/bashkëpunimin midis tyre. Krijon një sistem të përshtatshëm për mbledhjen e informacionit dhe transferimin e njohurive. Është Përgjegjëse për garantimin e performancës dhe standardeve në lidhje me fondin pyjor kombëtar.

Figura 3. Struktura e AKP



Burimi: AKP; Përpunoi: Grupi i auditimit

¹² Përgjigje zyrtare AKM, kthim përgjigje për kërkesën për informacion 10.07.2024.

➤ **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)**

Organigrama e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë përfshin Drejtorinë e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Minierave dhe Industrisë, në të cilën është pjesë Sektori i Programeve të Zhvillimit në Fushën e Burimeve Minerare i cili ka kompetencë të:

- hartojë dhe të përgatisë dokumentacionin e nevojshëm për dhënien e lejeve minerare kërkim-zbulimin dhe shfrytëzimin e mineraleve;
- ndjekë në bashkëpunim me institucionet e varësisë, zbatimin e projekteve të investimeve dhe programit të prodhimit për marrëveshjet e koncesionit të dhëna në industrinë minerare;
- kontrollojë drejtpërdrejtë, apo nëpërmjet institucioneve të varësisë, personat juridikë dhe fizikë vendas e të huaj, që kryejnë aktivitetet minerar, duke kërkuar zbatimin e dispozitave të ligjit minerar dhe akteve nënligjore të dalë për zbatimin e tij;
- kryejë inspektimet e nevojshme, drejtpërdrejtë dhe nëpërmjet institucioneve të varësisë, për zbatimin e ligjit në të gjithë aspektet e tij dhe për sa i përket normave të teknikes së sigurimit dhe ruajtjes së jetës së njerëzve dhe mjedisit;
- vlerësojë masat ndëshkimore të propozuara për subjektet, që kryejnë aktivitetet minerar në kundërshtim me dispozitat e ligjit minerar dhe akteve nënligjore të dalë për zbatimin e tij;
- drejtojnë, nëpërmjet institucioneve të varësisë, mbikëqyrjen, monitorimin, veprimtarinë e shoqërive, që merren me aktivitetet minerar në lidhje për mbrojtjen në punë dhe shëndetin e punonjësve, si edhe për mbrojtjen dhe monitorimin e mjedisit për zonën e dhënë për kërkim zbulim apo shfrytëzim¹³.

Figura 4. Organigrama e strukturës përgjegjëse për lejet minerare në MIE



Burimi: MTM ; Përpunoi: Grupi i auditimit

➤ **Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore:**

AKBN ka si objekt të veprimtarisë së saj, zhvillimin, mbikëqyrjen e shfrytëzimit racional të burimeve natyrore, në bazë të politikave qeverisëse, dhe monitorimin e pas shfrytëzimit të tyre, në sektorin minerar, hidrokarbur dhe energjetik.


Referuar temës së auditimit¹⁴, fusha e veprimtarisë së AKBN konsiston në:

¹³ Rregullore e Brendshme e MIE

¹⁴ Neni 16, Statuti/Rregullore e funksionimit të AKBN

- propozimin, konsultimin, dhe bashkëpunimin me strukturat përkatëse të Qeverisë për hartimin dhe zbatimin e politikave e strategjive të saj, në fushën e minierave;
- sigurimin brenda fushës së veprimtarisë së vet, të oponencës qeveritare për studimet dhe projektet në fushën e veprimtarisë minerare, postminerare, të paraqitura nga subjektet shtetërore a private, vendas ose të huaj. Për raste të veçanta mund të kërkojë asistencë të specializuar;
- promovimin e burimeve minerare;
- negocimin e marrëveshjeve minerare dhe ndjekjen e zbatimit të planeve të zhvillimit të tyre;
- përgatitjen e dokumentacionit dhe praktikave të nevojshme për dhënien e lejeve, të licencave, autorizimeve, në përputhje me ligjin, të cilat mundësojnë hyrjen në marrëveshjet hidrokarbure dhe kryerjen e operacioneve hidrokarbure sipas marrëveshjeve të lidhura;
- mbikëqyrjen¹⁵ e veprimtarisë minerare, postminerare;
- realizimin e monitorimit të zonave të shfrytëzuara, të rrezikut mineral dhe të mbylljes së veprimtarisë minerare.

Figura 5 Struktura përgjegjëse për minierat në AKBN



Burimi: AKBN; Përpunoi: Grupi i auditimit

➤ **Bashkitë:**

- Skrapar;
- Selenicë;
- Krujë;
- Berat;
- Dimal.

Struktura përgjegjëse për pyjet në ministri, nëse vlerëson se dokumentacioni është i plotë përcjell kërkesën për hartimin e raportit tekniko-ekonomik dhe dhënien e dakordësisë, njësisë së vetëqeverisjes vendore, kur sipërfaqja pyjore, objekt i ndryshimit të kategorisë së përdorimit, është në pronësi të saj ose në pronësi private. Njësia e vetëqeverisjes vendore, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e administrimit të kërkesës, përcjell pranë ministrisë përgjegjëse për pyjet raportin tekniko-ekonomik së bashku me vendimin e Këshillit Bashkiak, i cili jep pëlqimin ose jo për vazhdimin e procedurës së ndryshimit të kategorisë së përdorimit të sipërfaqes pyjore në pronësi të saj ose private.¹⁶

¹⁵ Neni 15, Statuti/Rregullore e funksionimit të AKBN

¹⁶ Vendimi nr. 888, datë 27.12.2022.

Gjithashtu, NJQV-të hartojnë:

a) planeve të mbarështimit të ekonomive pyjore, si dokument bazë afatgjatë për pyjet, për realizimin e qeverisjes, zhvillimin dhe mbrojtjen e tyre, i vlefshëm për një periudhë 10-vjeçare. Planet e mbarështimit hartohen nga pronarët përkatës sipas formës së pronësisë, bazuar në metodikat/udhëzuesit e përgatitur nga ministria, nëpërmjet ekspertëve të certifikuar të fushës ose strukturave pyjore. Për të gjitha format e pronësisë, planet e mbarështimit miratohen nga ministri. Përjashtimisht për bashkitë, miratimi i planit të mbarështimit shoqërohet me miratimin paraprak të këshillit bashkiak përkatës;

c) planeve operacionale vjetore, të cilat garantojnë planifikimin e punimeve, zbatimin, kontrollin apo monitorimin e planeve të mbarështimit dhe për fondin pyjor publik e privat, brenda territorit administrativ të bashkisë dhe miratohen nga kryetari i bashkisë në përputhje me planin e mbarështimit¹⁷.

Figura 6. Struktura përgjegjëse për pyjet në Bashkinë Skrapar




Figura 7. Struktura përgjegjëse për pyjet në Bashkinë Selenicë




Figura 8. Struktura përgjegjëse për pyjet në Bashkinë Krujë



Figura 9. Struktura përgjegjëse për pyjet në Bashkinë Berat





Figura 10. Struktura përgjegjëse për pyjet në Bashkinë Dimal



2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim

2.2.1 Kriteret politike:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji Nr. 154/2014, “ Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 57/2020, datë 30.4.2020 “Për pyjet”, i ndryshuar;
- Ligj Nr.10304, datë 15.7.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”;
- Ligji nr.10 448, Datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit”*
- VKM Nr. 814, datë 31.12.2018 “Për Miratimin e Dokumentit të Politikave për Pyjet ne Shqipëri 2019–2030”;
- Urdhri nr. 67, datë 11.03.2018 “Plani i veprimit për veprimtaritë minerare me karrierë gurore”
- Të tjera.

¹⁷ Ligj nr. 57/2020 “Për pyjet”

2.2.2. Kriteret teknike dhe të monitorimit:

- VKM Nr.570 datë 17.07.2019 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”, i përditësuar
- VKM Nr. 547 datë 09.08.2006 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”, i përditësuar.
- VKM nr.1353,datë 10.10.2008 ”Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit, teknik, si dhe të kriterëve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor”.
- VKM nr.888, datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”
- VKM Nr. 297, datë 17.5.2023 “Për miratimin e procedurave për kryerjen e veprimtarive të shfrytëzimit në fondin pyjor kombëtar nga individë apo subjekte të licencuara”;
- VKM Nr. 171, datë 18.3.2022 “Për ngritjen e bazës së të dhënave për Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor dhe Regjistrin e Fondit Kullosor, përcaktimin e Strukturës, kriterëve teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mënyrës së mbajtjes së të dhënave në nivel vendor, rajonal e qendror, informacionit që duhet regjistruar , si dhe të afateve të përgatitjes e raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve”.
- VKM Nr. 558, datë 29.7.2022 “ Për përcaktimin e kriterëve për ndarjen e shkeljeve me pasoja të lehta apo me pasoja të rënda dhe sanksionet financiare në fondin pyjor kombëtar”
- VKM Nr. 559 datë 29.7.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike si dhe për prodhimet drusore”;
- VKM nr.537, datë 22.9.2021 “Për përcaktimin e kostove të përlllogaritura për pyllëzim kompensues në rastet e ndryshimit të destinacionit të fondit pyjor”;
- Vendim nr.419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja”
- Udhëzim Nr. 17, datë 20.4.2023 “Për bashkërendimin e funksioneve inspektuese në fushën e mbrojtjes së pyjeve”;
- Rregullore të brendshme MTM, MIE, AKP, AKM, Bashkitë Selenicë, Krujë, Dimal, Berat, Çorovodë;
- Udhëzim i përbashkët nr. 18, datë 24.08.2022, “Mbi garancitë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit të mjedisit për veprimtaritë minerare”
- Udhëzim i përbashkët nr. 19, datë 24.08.2022 “Mbi miratimin e formatit standard për hartimin e Planit të Rehabilitimit të Mjedisit në veprimtaritë minerare”
- Të tjera.

2.2.3 Praktika të mira

- “Aktivitete minerare i zgjuar me pyjet”, Banka Botërore, 2021, faqe 43.
- Programi për Pyjet, Banka Botërore, qershor 2024, <https://www.profor.info/content/forest-smart-mining-advance-neë-york-declaration-forests-and-sustainable-development-goals-0>

2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit

Ligji nr. 57/2020 “Për pyjet” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij janë të rëndësishëm pasi nëpërmjet sanksionimit të kriterëve juridike dhe administrative, ndihmojnë në rregullimin e administrimit të sektorit të pyjeve, organizimin institucional, rregullimit për përfitimet dhe shërbimet ndaj tij, për bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të angazhimeve ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë, për të garantuar përmbushjen në vijimësi të funksioneve mjedisore, ekonomike, sociale dhe kulturore në interes të të gjithë shoqërisë.¹⁸

Në vitet e fundit, pyjet kanë zënë një vend gjithmonë në rritje në axhendën politike dhe prioritetet e qeverisjes, duke kuptuar rëndësinë e pyjeve për cilësinë e jetës, zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit dhe ekuilibrat natyror.

Veprimtaria e subjekteve nën auditim është e orientuar drejt: miratimit të planeve të mbarështimit, garantimit të funksionalitetit të sistemit të kontrollit dhe të inspektimit të veprimtarive që zhvillohen në fondin pyjor kombëtar; monitorimit, mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës në fondin pyjor publik etj.

MTM është përgjegjëse për hartimin dhe miratimin e dokumenteve strategjike për ruajtjen dhe administrimin e fondit pyjor si dhe hartimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor në fushën e pyjeve.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit është përgjegjëse për përgatitjen e aktit të miratimit të lejes mjedisore/ VNM paraprake / të thelluar për subjektet aplikuese.

Strukturat përgjegjëse në bashki për pyjet mbajnë procesverbale inspektimi të veprimtarive që zhvillohen në fondin pyjor kombëtar.

2.4 Peshë në buxhet

Financimi i sektorit të pyjeve bazohet në parimin e qëndrueshmërisë, i cili nënkupton ekuilibrimin e shpenzimeve që kryhen për ruajtjen, rigjenerimin dhe zhvillimin e fondit pyjor kombëtar me të ardhurat që sigurohen nga shfrytëzimi i tij dhe shërbimet që ofron. Të ardhurat nga aktivitetet në fondin pyjor kombëtar përdoren vetëm dhe në funksion të rimëkëmbjes së pyjeve.¹⁹ Organi përgjegjës për vjeljen e të ardhurave në sektorin e pyjeve është struktura përgjegjëse për pyjet në bashki/zonat e mbrojtura²⁰

Burimet e financimit të sektorit të pyjeve janë:

- a) buxheti i shtetit;
- b) buxheti i njërive të vetëqeverisjes vendore;
- c) donacionet dhe grantet e ndryshme;
- ç) të ardhurat nga të gjitha aktivitetet e mundshme në fondin pyjor.²¹

Burimet financiare në dispozicion të ministrisë (përfshirë agjencitë) dhe të bashkive për pyjet publike përdoren për:

- a) mbrojtjen e pyjeve, florës, faunës së egër, mjedisit dhe biodiversitetit, si dhe parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve, dëmtuesve dhe zjarreve;
- b) punimet e mirëmbajtjes dhe të përmirësimit të gjendjes së pyjeve, ndërtimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës pyjore;
- c) investime të ndryshme në fondin pyjor publik për trajtimin, zhvillimin dhe shtimin e sipërfaqes së pyjeve dhe volumit të tyre;
- ç) hartimin dhe zbatimin e planeve të mbarështimit dhe monitorimin e pyjeve, studime e kërkime shkencore, si dhe për mbështetjen e bashkive si njësi të vetëqeverisjes vendore dhe pronarëve privatë;
- d) organizimin e fushatave periodike për edukimin dhe ndërgjegjësimin publik për mbrojtjen dhe mirëqeverisjen e pyjeve.²²

➤ **Bashkitë:**

Tabela 1: Të ardhurat nga aktiviteti në fondin pyjor/kullosor²³, si dhe sipërfaqja e fondit pyjor/kullosor, për bashkitë nën auditim.

| Zërat | 2021 | | 2022 | | 2023 | |
|----------|---|--------------------------------|---|--------------------------------|---|--------------------------------|
| | Të ardhura nga aktiviteti në fondin pyjor/kullosor (lekë) | Sip fondit pyjor/kullosor (ha) | Të ardhura nga aktiviteti në fondin pyjor/kullosor (lekë) | Sip fondit pyjor/kullosor (ha) | Të ardhura nga aktiviteti në fondin pyjor/kullosor (lekë) | Sip fondit pyjor/kullosor (ha) |
| Skrapari | N/A | 37,544 | 41,779,185 | 37,537 | 629,100 | 37,537 |

¹⁹ Pika 1, neni 13, Ligji, nr. 57/2020, datë 30.4.2020 “Për Pyjet”

²⁰ Pika 4, neni 13, Ligji, nr. 57/2020, datë 30.4.2020 “Për Pyjet”

²¹ Pika 2, neni 13, Ligji, nr. 57/2020, datë 30.4.2020 “Për Pyjet”

²² Pika 7, neni 13, Ligji, nr. 57/2020, datë 30.4.2020 “Për Pyjet”


²³ Të ardhurat nga aktiviteti në fondin pyjor dhe kullosor mbahen dhe raportohen së bashku nga subjektet përgjegjëse, për këtë arsye ato janë analizuar në grup.

| | | | | | | |
|-----------------|-------------------|---------------|-------------------|---------------|-------------------|---------------|
| Selenice | 10,695,907 | 10,266 | 10,695,907 | 10,266 | 6,648,920 | 10,266 |
| Kruje | N/A | 9,164 | 1,262,165 | 9,164 | 1,221,413 | 9,164 |
| Dimal | 6,506,000 | 2,137 | 6,506,000 | 2,137 | - | 2,137 |
| Berat | 3,671,000 | 16,402 | 3,671,000 | 15,767 | 3,189,162 | 15,767 |
| Total | 20,872,907 | 75,513 | 63,914,257 | 74,871 | 11,688,595 | 74,871 |

Burimi: AKP Përpunoi: G.A

Referuar të dhënave të përcjella nga AKP, për bashkitë nën auditim, në total janë siguruar më tepër të ardhura nga aktiviteti në fondin pyjor/kullosor në vitin 2022, në vlerën 63,914 mijë lekë në një sipërfaqe në administrim prej 74,871 ha. Kjo vlerë është ndikuar më së shumti si rezultat i një arkëtim në Bashkinë Skrapar.

Grafiku 1: Të ardhurat nga aktiviteti në fondin pyjor/kullosor (në lekë)



Burimi: AKP; Përpunoi: G.A

Në vitin 2023, janë siguruar më pak të ardhura, krahasuar kjo edhe me vitin 2021, edhe pse për këtë vit mungojnë të dhënat e të ardhurave për dy bashki (bashkinë Skrapar dhe Selenicë). Në total, në vitin 2023 të gjitha bashkitë kanë raportuar më pak të ardhura të siguruar nga aktiviteti në pyje dhe kullota, krahasuar më vitet e tjera, ndërsa vërehet se bashkia Dimal në këtë vit nuk ka përfituar të ardhura.

Për vitet 2021-2022 Bashkitë Dimal dhe Selenicë kanë siguruar më tepër të ardhura për hektarë. Ndërsa, në vitin 2023, Bashkia Selencë ka përfituar më tepër të ardhura për hektar, krahasuar me bashkitë e tjera. Për bashkinë Berat vërehet se të ardhurave e përfituara janë të pa ndryshuar, me një trend të lehtë rënës në vitin 2023.

➤ **MIE:**

Garancia financiare për rehabilitimin e mjedisit: Kjo garanci përllongaritet në vlerë monetare dhe përdoret nga zotëruesi i lejes minerare ose shteti për realizimin e planit të rehabilitimit progresiv dhe përfundimtar të mjedisit, gjatë dhe pas përfundimit të aktivitetit minerar. Ajo përfshin garancinë financiare për mbylljen e veprimtarisë minerare, mbylljen e sheshit të depozitimit të mbetjeve dhe rehabilitimin progresiv dhe përfundimtar të mjedisit.²⁴ Në rast se zotëruesi i lejes minerare përmbush detyrimet për rehabilitimin progresiv dhe përfundimtar të mjedisit, garancia i kthehet zotëruesit të lejes, ndryshe, ajo kalon në favor të shtetit.

Tabela 2: Të dhënat për garancitë financiare për rehabilitimin e mjedisit të derdhura për periudhën nën auditim.

| Zëri/Viti | 2021 | 2022 | 2023 |
|------------------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| Leje Shfrytëzimi | 66,949,686 | 68,168,657 | 68,942,677 |
| Leje Kërkim - Zbulimi | 344,035 | 298,288 | 580,555 |
| Total | 67,293,721 | 68,466,945 | 69,523,232 |

Burimi: MIE Përpunoi: G.A

²⁴ Ligji Nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për Sektorin Minerar Në Republikën E Shqipërisë”

Nga analizimi i të dhënave të mësipërme vërehet se totali i garancive financiare të derdhura për rehabilitimin e mjedisit ka pasur një rritje viti pas viti, përgjatë periudhës nën auditim. Ndërsa, vërehet se në secilin prej viteve peshën më të lartë të garancive financiare të derdhura e zënë ato për rehabilitimin e mjedisit nga aktiviteti minerar i shfrytëzimit, krahasuar me atë nga aktiviteti minerar i kërkim-zbulimit.

2.5 Përkufizimet dhe terminologjia

Në kuptim të këtij auditimi, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë²⁵:

- **“DPP”** është dokumenti i politikave për pyjet, ku politikat janë drejtimet kryesore ku fokusohet sektori, të cilat lidhen me vendimmarrjen për të ardhmen dhe realizojnë synimet e qeverisjes në përputhje me interesin publik e të grupeve të tjera të interesit.
- **“Administrimi i pyjeve”** është tërësia e masave organizative, teknike dhe financiare për zhvillimin dhe mbrojtjen e tyre.
- **ALFIS**- Sistemi i Informacionit të Pyjeve ALFIS, (Albanian Forest Information System) është Sistemi Shqiptar i Informacionit për Pyjet i ngritur në kuadër të Projektit të Shërbimeve Mjedisore.
- **“Bashki”** është njësi e vetëqeverisjes vendore, që ka në pronësi sipërfaqe të fondit pyjor brenda kufijve territorialë administrativë të saj, e cila është përgjegjëse për administrimin e fondit pyjor publik.
- **“Dëmtim i pyllit dhe mjedisit pyjor”** janë dëmtime me pasojë humbjen e funksioneve të pjesëve të pyllit ose mjedisit pyjor dhe prishjen e ekuilibrave biologjikë natyrorë, si rezultat i ndërhyrjeve nga njeriu ose nga faktorë të tjerë natyrorë.
- **“Ekonomi pyjore”** është njësi bazë e organizimit të sipërfaqes së fondit pyjor kombëtar për qeverisjen e pyjeve dhe drejtimin, planifikimin e kontrollin e mbarështimit të pyjeve, që zakonisht përfshin një masiv pyjor, me kufij të qartë natyrorë.
- **“Fond pyjor kombëtar”**, që përfaqësohet nga fondi pyjor publik dhe privat, është sipërfaqja e mbuluar me pyje, shkurre, toka me bimësi pyjore, përfshirë edhe sipërfaqet e zhveshura (çelirat, shkëmbinjtë, dunat dhe ranishtat), sistemet agropyjore, brezat mbrojtës, infrastrukturën përkatëse, si dhe pasuritë jo pyjorë bashkëshoqëruese, të cilat krijojnë një mjedis unik me pyjet e tokën pyjore.
- **“Grumbull pyjor”** është njësi bazë për hartëzimin e pyllit, që përfaqësohet nga një grup i dendur drurësh pak a shumë homogjenë në lidhje me përbërjen, dendësinë, madhësinë dhe habitatin e specieve.
- **“Infrastruktura pyjore”** përfshin mjetet, pajisjet, programet dhe aplikacionet kompjuterike, zyrat, ndërtesat, struktura pune/akomodimi, stenda informacioni, fidanishtet, magazinat, depot, rrjetin rrugor pyjor, teleferikët pyjorë, traktorët, makinat, motorët, radiot e antenat e radio komunikimit, pritrat, pendat, çezmat, rrethimet e gardhimet, tabelat, shenjat e ndryshme treguese e sinjalizuese, ato të mbarështimit pyjor, rrjetet e shërbimeve ujësjellës, elektrike, telekomunikacion etj., si dhe lehtësitë e tjera të ngritura në fondin pyjor publik për informimin dhe pritjen e vizitorëve.
- **“Inventarizimi kombëtar i pyjeve”** është procesi që realizon grumbullimin dhe vlerësimin e të dhënave për shtrirjen dhe gjendjen e fondit pyjor kombëtar, të cilat shërbejnë për hartimin e politikave në fushën e pyjeve, për zhvillimin e qëndrueshëm dhe shumëfunksional të tyre.
- **“Mbarështimi i pyjeve”** është planifikimi afatgjatë për pyjet, publike dhe private, i cili kryhet në bazë të kriterëve të caktuar për grumbullimin e informacionit për situatën/gjendjen faktike dhe përcaktimin e objektivave e masave të nevojshme, në funksion të statusit të dhënë, me synim përmbushjen e funksioneve ekologjike, ekonomike e sociale, duke zbatuar dhe harmonizuar parimet e zhvillimit të qëndrueshëm me nevojat e administruesve, pronarëve privatë dhe përdoruesve të tyre.
- **“PKP”** është Programi Kombëtar i Pyjeve.


²⁵ Ligj Nr. 57/2020 “Për Pyjet”, neni 3

- **“PKSP”** është Plani Kombëtar Sektorial i Pyjeve, që hartohet dhe miratohet sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
- **“Plani i mbarështimit”** është dokumenti bazë për mbarështimin e një ekonomie pyjore, që përmban analizën e gjendjes së pyjeve, përcakton objektivat që duhet të realizohen në funksion të statusit që kanë, si dhe planifikon masat për trajtimin e tyre dhe ndërhyrjet për vitet e ardhshme.
- **“Plan përmirësimi pyjor”** është procesi i planifikimit dhe organizimit të objektivave të planit të mbarështimit, në masa konkrete silvoteknike, që synojnë përmirësimin e gjendjes së pyllit.
- **“Plani operacional vjetor”** është dokumenti i planifikimit të të ardhurave dhe shpenzimeve nga aktivitetet në pyjet publike, buxheti i shtetit, donacionet ose grantet e ndryshme për realizimin e punimeve të përcaktuara ose rekomanduara nga planet e mbarështimit, të veprimtarive për zhvillimin dhe mbrojtjen e fondit pyjor, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së nevojshme, si dhe për qëllime të tjera të parashikuara nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
- **“Pronar privat i pyllit”** është personi fizik sipas përcaktimeve të Kodit Civil dhe/ose personi juridik, që gëzon të drejtat ekskluzive të pronësisë, gëzimit dhe disponimit të pyllit brenda kufijve të caktuar nga ligji.
- **“Qeverisja e pyjeve”** është garantimi i mbarështimit, i të drejtave e detyrimeve dhe financimit të pyjeve, ngritja dhe vënia në eficiencë e organizimit funksional, menaxhimi i përfitimeve nga shfrytëzimi i fondit pyjor kombëtar, si dhe realizimi i shërbimeve të nevojshme ndaj pyjeve.
- **“Regjistri Kombëtar i Fondit Pyjor (RKFP)”** është regjistri zyrtar i të dhënave kadastrale të fondit pyjor kombëtar, i organizuar në nivel qendror, rajonal dhe vendor, në të cilin regjistrohen të gjitha informacionet bazë dhe ndryshimet periodike të ndodhura në pronësinë, të drejtat reale, pozicionin hartografik, sipërfaqe, volum etj., shoqëruar me sistemin e informacionit gjeografik (GIS), i nevojshëm për administrimin dhe planifikimin e pyjeve.
- **“Ripyllëzim”** është mbjellja e drurëve pyjorë në një sipërfaqe të përkufizuar “pyll” ose “tokë me bimësi pyjore”, në të cilën, për arsye të ndryshme, nuk është siguruar ripërtëritja në rrugë natyrale, ose ripërtëritja është dëmtuar dhe nuk garanton zhvillimin e grumbullit të ri.
- **“Sistemi organizativ i sektorit të pyjeve”** është tërësia e integruar e institucioneve, aktiviteteve, dijës dhe infrastrukturës në shërbim të tyre në të gjitha nivelet e sektorit.
- **“Zhvillimi i qëndrueshëm i pyjeve”** është procesi i administrimit dhe shfrytëzimit të pyjeve, në mënyra dhe intensitete të tilla që të ruajnë larminë e tyre biologjike, prodhimtarinë dhe kapacitetet ripërtëritëse, për të përmbushur tani dhe në të ardhmen funksionet ekologjike, ekonomike dhe shoqërore, pa shkaktuar dëme në ekosistemet e tjera, si në nivel vendor, kombëtar, rajonal dhe botëror.
- **“Minierë”** është çdo gjë që mbi ose nën tokë, përfshirë edhe pjesët nën ujë, dhe sterilet, çdo shpim ose pus kërkim-zbulimi, i cili është në punë ose jo, i bërë për qëllim kërkimi, zbulimi ose shfrytëzimi të mineralit, si dhe çdo vend tjetër, ku shfrytëzohet një pasuri minerare, përfshirë këtu zonën minerare dhe të gjitha ndërtesat, konstruksionet, strukturat, makineritë, pajisjet, dambat, rrugët ose objektet e tjera, të vendosura në një zonë të tillë, të cilat përdoren ose kanë si qëllim të përdoren për kërkimin, zbulimin, shfrytëzimin, përpunimin a përfitimin e një minerali, të nxjerrë në përputhje me dispozitat e këtij ligji.
- **“Veprimtari minerare”** janë veprimtaritë e kërkimit, të zbulimit, të shfrytëzimit, të përpunimit, të mbylljes, të konservimit dhe të rehabilitimit të mjedisit minerar.
- **“Rehabilitim i mjedisit minerar”** është tërësia e veprimtarive që përfshijnë rehabilitimin progresiv e përfundimtar të mjedisit të zonës së lejuar minerare, rehabilitimin e sheshit të depozitimit të mbetjeve, si dhe të gjitha veprimtaritë e tjera, që realizon zotëruesi i lejes minerare, për parandalimin e dëmtimit të mjedisit e ndotjeve dhe për të garantuar një rehabilitim të plotë të ekosistemit në përgjithësi në zonën e lejuar minerare.
- **“Leje minerare”** është akti administrativ, i dhënë në përputhje me këtë ligj, për të kryer veprimtari minerare në zonën e lejuar dhe për mineralet e përcaktuara në të.
- **“Rentë minerare”** është përqindja e vlerës së mineralit të thatë të shitur, që i paguhet shtetit nga zotëruesi i lejes minerare, si kompensim për zvogëlimin e burimeve minerare.

- “**Plani i rehabilitimit të mjedisit**” është projekti teknik, i realizuar në përputhje me kërkesat bazë të legjislacionit minerar dhe mjedisor në fuqi, në bazë të një pune studimore-projektuese, që përfshin të gjitha masat, që do të zbatohen për rehabilitimin progresiv e përfundimtar të mjedisit dhe kthimin e tij në gjendje të rehabilituar, rehabilitimin e sheshit të depozitimit të mbetjeve dhe mbylljen e veprimtarisë minerare, vlerën e përgjithshme të garancisë financiare për realizimin e këtij plani, para zhvillimit të veprimtarive minerare, që paraqitet së bashku me dokumentacionin për marrjen e të drejtave minerare.
- “**Garanci financiare për rehabilitimin e mjedisit**” është vlera monetare që depozitohet çdo vit, në formën e një garancie bankare në favor të shtetit, në një bankë të nivelit të dytë në Shqipëri, që përdoret për realizimin e planit të rehabilitimit përfundimtar të mjedisit, sipas përcaktimeve të këtij ligj

2.6 Skema e analizës së programit auditues

Skema 1: Modeli Input – Output²⁶:



Feedback-u i subjektit në fazën studimore

Gjatë fazës studimore, subjektet nën auditim, i janë përgjigjur përgjithësisht në kohë takimeve prezantuese dhe konsultuese, por nuk i janë përgjigjur në të njëjtën mënyrë plotësisht të informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar, që lidhet me vjeljen e të dhënave paraprake.

Përgjithësisht MIE, MTM dhe pesë Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore subjekt auditimi pavarësisht qëndrimit mirëkuptues nga ana e grupit të auditimit, kanë shfaqur vonesa në dhënien e informacionit dhe përgjigjet e pyetësorëve të dërguar. Përveç vonesave, informacioni i dërguar nga këto subjekte


ka rezultuar përgjithësisht i pa plotë dhe i paqartë, duke bërë të detyrueshëm përsëritjen e kërkesave të grupit të auditimit për saktësimin e informacionit.

3. DETAJET E AUDITIMIT

3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit

Risqet e aktivitetit të subjekteve janë ato risqe me të cilat përballen institucionet e audituara në mbrojtjen e pyjeve, rehabilitimin dhe ripyllëzimin e sipërfaqeve të fondit pyjor kombëtarë që ndikohen nga zhvillimi i aktivitetit minerar.

Risqet e aktivitetit të subjekteve nën auditim janë analizuar dhe evidentuar të klasifikuara sipas analizës SWOT: fuqitë, dobësitë, mundësitë, kërcënimet²⁷, detajuar në faktorë të brendshëm dhe të jashtëm.



3.2 Objektivi i auditimit

Auditimi me temë “*Ndikimi i aktivitetit minerar në fondin pyjor*” ka si objektivi kryesor vlerësimin dhe analizimin e masave të marra nga institucionet përgjegjëse me qëllim mbrojtjen e fondit pyjor nga aktiviteti minerar. Në këtë mënyrë do të synohet të sigurohet një vlerësim i paanshëm dhe objektivi mbi nismat dhe iniciativat të cilat institucionet përgjegjëse kanë marrë lidhur me zhvillimin e aktivitetit minerar miqësorë me mjedisin dhe kryesisht me fondin pyjor. Me anë të këtij objektivi

²⁷ Për identifikimin e kërcënimeve, krahas analizave të kryera nga grupi i auditimit, një pjesë e tyre janë konstatuar në Dokumentin e Politikave për pyjet 2019-2030, fq. 15-21.

do të mund të konkludojmë se deri në çfarë mase ka qenë efektive dhe eficiente veprimtaria e institucioneve subjekt auditimi për periudhën 2021-2023.

3.3 Pyetjet e auditimit

A kanë rezultuar të mjaftueshme masat e marra nga institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e fondit pyjor nga aktivitetet minerare ?

1. Si është gjendja e fondit pyjor në vendin tonë?

2. A ka politika për të siguruar mbrojtjen e fondit pyjor nga aktiviteti minerar?

3. A është garantuar nga institucionet përgjegjëse monitorimi dhe inspektimi i mbrojtjes dhe rehabilitimit të fondit pyjor nga ndikimi i aktivitetit minerar?

3

1.2.1 A ka objektiva strategjike për mbrojtjen e pyjeve dhe rehabilitimin e zonave të prekura nga aktivitetet minerare ?

1.2.2. A janë plotësuar dhe përditësuar dokumentet rregullatorë për ruajtjen e fondit pyjor?

1.3.1. A janë marrë masat nga institucionet përgjegjëse, për monitorimin dhe inspektimin mbi ndikimin e aktivitetit minerar në fondin pyjor?

1.3.2. A është siguruar ndjekja e kryerjes së rehabilitimit dhe ripyllëzimit të fondit pyjor, nga ndikimi i aktivitetit minerar?

3.3 Fushëveprimi i auditimit

Ky auditim ka pasur si fushëveprimi analizimin dhe dhënien e një opinioni mbi politikat e ndërmarrja dhe miradministrimin e proceseve me synim garantimin e ruajtjes së fondit pyjor nga ndikimi i aktivitetit minerar. Auditimi për shkak të kompleksitetit të tij ka pasur një qasje në nivel makro duke parë nga perspektiva e detyrimeve që subjektet kanë, në lidhje me ruajtjen e fondit pyjor nga ndikimi i aktivitetit minerar. Periudha e auditimit është 01.01.2021-31.12.2023. Gjatë këtij auditimi do të fokusohemi në mënyrë të veçantë në veprimtarinë e MTM, MIE, AKP, AKM, Bashkitë Berat, Skrapar, Dimal, Selenicë dhe Krujë. Numri i lartë i subjekteve të përzgjedhur si edhe periudha e auditimit prej vitit 2021, është për të pasur një panoramë më të plotë lidhur me fokusin e auditimit në këndvështrimin e politikave të hartuara për ruajtjen e fondit pyjor dhe si ndikon aktiviteti minerar tek ky fond, gjithashtu dhe veprimtaria që institucionet përgjegjëse ushtrojnë në funksion të përmbushjes së objektivave strategjike dhe rregullatore në këtë fushë.

4.SHTJELLIMI I PYETJEVE AUDITUESE

Pyetja kryesore: A kanë rezultuar të mjaftueshme masat e marra nga institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e fondit pyjor nga aktivitetet minerare ?

Mesazhi i auditimit

Masat e marra nga institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e fondit pyjor nuk kanë rezultuar të mjaftueshme. Regjistri Kombëtar i Fondit Pyjor dhe Sistemi i Integruar i Informacionit për pyjet nuk funksionojnë duke mos garantuar një informacion të plotë e të përditësuar mbi fondin pyjor. Vetëm 7 nga 87 subjekte që operojnë në sektorin minerar në territorin e bashkive subjekt auditimi janë të pajisura me dokumentin e miratimit të heqjes së fondit pyjor duke sjellë kështu mos përditësimin e regjistrit kadastral të fondit pyjor, me pasojë mungesën e rehabilitimit dhe mos kryerjen e pyllëzimit kompensues.

Përgjegjës kryesor për këtë situatë është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe Bashkitë Krujë, Selenicë, Skrapar, Berat, Dimal, nuk ka pasur inspektime dhe monitorime periodike për aktivitetin minerar që ndikon në fondin pyjor të subjekteve në lidhje me detyrimet për rehabilitimin e mjedisit, rpyllëzimet, parandalimin e dëmtimit të fondit pyjor dhe ruajtjen e tij nga aktiviteti i paligjshëm.

Angazhimi i të gjitha institucioneve të sipër përmendura është i rëndësishëm për përmirësimin e situatës në tërësi.


4.1. Si është gjendja e fondit pyjor në vendin tonë?

Mungojnë të dhëna për treguesit e fondit pyjor dhe vlerësimi i gjendjes së pyjeve.

Pyjet janë ekosistemi mbizotërues tokësor i planetit tonë, dhe shpërndahen në të gjithë globin. Pyjet përbëjnë 75% të prodhimit parësor bruto të biosferës së Tokës dhe përmbajnë 80% të biomasës bimore të Tokës. Prodhimi parësor neto vlerësohet në 21.9 gigatonë karbon në vit për pyjet tropikale, 8.1 për pyjet e buta dhe 2.6 për pyjet boreale.

Shoqëria njerëzore dhe pyjet ndikojnë në njëra tjetrën në mënyra pozitive dhe negative. Pyjet ofrojnë shërbime ekosistemi për njerëzit dhe shërbejnë si atraksione turistike. Pyjet gjithashtu mund të ndikojnë në shëndetin e njerëzve. Aktivitetet njerëzore, përfshirë prerjen e burimeve pyjore, mund të ndikojnë negativisht në ekosistemet pyjore.

Bazuar në të dhënat kadastrale të vitit 2023 pyjet në Shqipëri shtrihen në një sipërfaqe 1.146.725 ha që përfaqëson 66 % të fondit pyjor dhe kullësor. Kullotat dhe livadhet zënë një sipërfaqe 449.175 ha ose 26 % të fondit pyjor dhe kullësor. Sipërfaqet më bimësi pyjore dhe inproduktive që janë pjesë e fondit pyjor zënë një sipërfaqe 121.351 ha ose 8,0 % të këtij fondi.



Burimi: Raporti i Gjendjes në Mjedis, viti 2023

- *Fondi pyjor sipas formës së qeverisjes.*

Pyjet e vendit mbulojnë një sipërfaqe prej 1,146,725 ha dhe llogaritet të ketë një volum në këmbë prej 54 milion m³. Vlerësimi i materialit drusor të klasifikuar sipas formave të menaxhimit të pyjeve është gur themeli për zbatimin dhe vlerësimin e teknikave për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve. Pyjet e Shqipërisë dominohen si në sipërfaqe ashtu edhe në volum nga pyjet fletorë dhe kjo është e lidhur ngushtësisht me pozicionin gjeografik dhe ekologjik të vendit. Kështu me shumë se 80% e pyjeve të vendit tonë kanë në përbërjen e tyre llojet fletore të cilët kanë mbi 70% të volumit drusor.

- *Shpërndarja e sipërfaqes dhe volumit për klasat e moshës për pyjet trungishte.*

Nga sipërfaqja totale rreth 402 mijë ha janë trungishte, 67% e trungishteve janë pyje të rinj (më pak se 81 vjeçare) dhe vetëm 34% janë pyje të pjekur/të arrirë (më të vjetër se të 80 vjeçare). Nga pyjet e pjekur vetëm 17% janë mbi 100 vjeçare.

- *Sipërfaqet pyjore e kullosore të djegura nga zjarret.*

Nga të dhënat e raportuara nga 61 bashkitë rezultojnë se numri i rasteve të zjarreve në pyje e kullota gjatë vitit 2023 është 150 me një sipërfaqe të përkrahur 1563 ha dhe sipërfaqe të djegur plotësisht 307ha. Materiali drusor i djegur plotësisht raportohet në volum prej 2722 m³, ndërsa materiali drusor i djegur por i përdorshëm raportohet nga bashkitë në volumin prej 5938 m³.

- *Fondi kullosor sipas pronësisë.*

Rreth 90% e sipërfaqes kullosore është në pronësi publike dhe vetëm 10% është në pronësi private.²⁸

Nga inventari i vitit 2021 rezultojnë se mbi 2/3 e territorit në Republikën e Shqipërisë e zënë pyjet dhe kullotat me rreth 1,730,000 ha. Vetëm pyjet zënë afërsisht 40% të territorit të vendit me 1,460,000 ha ku përfshihen pyjet e lartë, pyjet e ulët dhe shkurret.

- *Fondi Pyjor dhe Kullosor Kombëtar (FPKK) aktualisht administrohet nga:*

- **61 Bashkitë** për pyjet e kullotat të kaluara në administrim sipas VKM-së 433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të

²⁸ Raporti i Gjendjes së Mjedisit, viti 2023

inventaritet, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive” i ndryshuar.

- **Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura** për pyjet e kullotat brenda zonave të mbrojtura

- **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit** për sipërfaqet e fondit pyjor që administrojnë sipas:

- VKM-së nr. 707, datë 21.11.2018 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizmin të disa pronave të paluajtshme shtetërore, në vijën bregdetare Shkodër-Fier”.

- VKM nr. 708 datë 21.11.2018, “Për regjistrimin dhe kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë përgjegjëse për turizmin të disa pronave të paluajtshme, Shtetërore, në vijën bregdetare Vlorë–Sarandë”.

- **Pronarët privatë** për pyjet e kullotat që kanë në pronësi të tyre por që i përgjigjen detyrimeve që sanksionon ligji “Për Pyjet” 57/2020 dhe aktet e tjera nënligjore²⁹.

Bazuar në VKM-në nr. 1189 datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit”, Agjencia Kombëtare e Mjedisit harton çdo vit Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, (i cili miratohet nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit), si mjet i vlerësimit të gjendjes dhe cilësisë së mjedisit në tërësi. Të dhënat e monitorimit pas përpunimit, paraqiten në Raportin e Gjendjes së Mjedisit të vitit respektiv. Monitorimi i treguesve të fondit pyjor kryhet nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve, mbi bazën e përpunimit të rezultateve.³⁰

Nga auditimi u konstatua se: Ministri i Turizmit dhe Mjedisit ka miratuar programet kombëtare të monitorimit të mjedisit, për vitet 2021-2022-2023, ku janë përcaktuar edhe treguesit konkretë që monitorohen për pyjet, (fondi pyjor sipas pronësisë, formës dhe qeverisjes, sipas llojeve, volumeve, sipërfaqja e pyjeve sipas klasave të moshës, llojeve, volume, mundësia vjetore e shfrytëzimit...etj).³¹

Nga analizimi i kryer i raporteve të gjendjes së mjedisit për vitet 2021, 2022 dhe 2023, disa nga treguesit e përcaktuar në programin kombëtar nuk janë përfshirë në Raportet e gjendjes së mjedisit (RGJM) të viteve përkatëse si: hot spotet në pyje; zonat me rëndësi të veçantë për biodiversitetin, diversiteti i ekosistemeve e habitateve në pyje; diversiteti i ekosistemeve e habitateve në zonat e mbrojtura etj.

1. Gjetje nga auditimi: Në raportet e gjendjes së mjedisit të hartuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për vitet 2021-2023 mungojnë të dhëna për disa nga treguesit e fondit pyjor si: hot spotet në pyje, sipërfaqet e dëmtuara nga faktorë të tjerë atmosferikë, si furtuna, dëborë etj., llojet drusore të rrezikuara etj. Referuar kuadrit ligjor në fuqi, Agjencia Kombëtare e Pyjeve ka përgjegjësi për vlerësimin e gjendjes së pyjeve nëpërmjet procesit të monitorimit, të cilat duhet t’i dërgohen Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

1. Konkluzione: Raportet e gjendjes së mjedisit të hartuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për vitet 2021-2023, nuk i trajtojnë të gjithë treguesit për pyjet, sipas kuadrit rregullator.

1.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Pyjeve në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, të marrë masa për të vlerësuar të gjithë treguesit mjedisor për sipërfaqet pyjore, sipas programit të monitorimit të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Menjëherë dhe në Vijimësi

²⁹ Burimi Agjencia Kombëtare e Pyjeve

³⁰ Vendim nr.1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit.

³¹Vendim nr.1189, datë 18.11.2009, Aneks 1, pika 6

4.2. A ka politika për të siguruar mbrojtjen e fondit pyjor nga aktiviteti minerar?

4.2.1 A ka objektiva strategjike për mbrojtjen e pyjeve dhe rehabilitimin e zonave të prekura nga aktivitetet minerare?

Strategjia kombëtare e pyjeve është e pa përditësuar.

Shqipëria, ka objektiva strategjike për mbrojtjen e pyjeve dhe rehabilitimin e zonave të dëmtuara nga aktivitetet minerare. Por këto objektiva si pjesë e politikave kombëtare për ruajtjen e burimeve natyrore dhe zhvillimin e qëndrueshëm duhet të jenë të fokusuara në, menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve, rehabilitimin dhe ripyllëzimin e zonave të dëmtuara, zvogëlimin e ndikimit të aktiviteteve minerare në pyje, rritjen e kapaciteteve institucionale, përfshirjen e komuniteteve lokale, monitorim dhe raportim periodik.

Dokumenti i Politikës së Pyjeve 2019-2030 miratuar me VKM-në nr. 814, datë 31.12.2018, “Për pyjet” dhe VKM-së nr. 570 datë 17.07.2019 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”, ngarkojnë Agjencinë Kombëtare të Pyjeve për vlerësimin e gjendjes së pyjeve nëpërmjet procesit të monitorimit që nga pikëpamja metodologjike mbështetet tek treguesit sasiorë të Kriterëve për Menaxhimin e Qëndrueshëm të Pyjeve. Ligji nr. 57, datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, ka për qëllim mbrojtjen e pyjeve si pasuri me rëndësi të veçantë, për vlerat e mëdha dhe të pazëvendësueshme në mbrojtjen e klimës, të tokës, ruajtjen dhe përmirësimin e potencialeve prodhuese, të ekuilibrave të mjedisit natyror, biodiversitetit, burimeve gjenetike dhe regjimit hidrik, si detyrime me interes kombëtar dhe ndërkombëtar³².

Dokumenti i politikave për pyjet (DPP) është plani i nivelit më të lartë strategjik, që lidh qëllimin dhe vizionin e qeverisjes me masat dhe aktivitetet konkrete për realizimin e tyre. DPP-ja shërben si bazë për hartimin e strategjive dhe programeve të zhvillimit, hartimin dhe zbatimin e rregullave, orientimin e buxheteve, ngritjen dhe përmirësimin e institucioneve përgjegjëse. DPP-ja miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit. Ky dokument është hartuar dhe miratuar (miratuar me VKM-ne e 2018)³³.

Monitorimi dhe kontrolli i zbatimit të DPP-së dhe PKP-së bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe ciklike nga strukturat përgjegjëse sipas këtij ligji, duke bërë vlerësimin e ecurisë dhe ndryshimin e tyre çdo 3 vjet dhe rishikimin tërësor çdo 10 vjet. Nga auditimi dhe referuar përgjigjeve zyrtare të MTM, Dokumenti i Politikave të Pyjeve nuk është monitoruar, dhe nuk ka raporte monitorimi për të sepse nuk është hartuar Strategjia për Pyjet dhe rrjedhimisht nuk janë hartuar plane veprimi për të, monitorimi vjetor i të cilave do të sillte monitorimin e DPP dhe hartimin e Programit Kombëtar të Pyjeve³⁴.

Strategjia e Minerave 2010-2025 synon zhvillimin e aktiviteteve minerare miqësore me mjedisin përmes zbatimit të masave zbutëse, proceseve të rehabilitimit mjedisor, forcimit të mbikëqyrjes dhe monitorimit, për të siguruar më pak ndotje duke zbatuar teknologji të përparuara që kanë efekte minimale në mjedis. Ligji nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e mjedisit” ka si qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës. Ngritja e strukturave të inspektim-kontrollit brenda Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, do të rrisë monitorimin e parametrave si dhe sasinë e informacionit që do të merret nga subjektet.

Politikat e sektorit minerar drejtohen nga qëllimi për një zhvillim të qëndrueshëm dhe rritjen e të ardhurave të shtetasve shqiptarë. Ato janë në disa drejtime kryesore: Në aspektet e legjislacionit minerar, aspekteve rregullatorë dhe planifikimit strategjik, ekonomik, fiskal, përmirësimit të klimës së biznesit, forcimit institucional, transparencës dhe mirëqeverisjes, mbrojtjes së mjedisit dhe të aspekteve sociale.³⁵

³² <https://akm.gov.al/ep-content/uploads/2023/11/Programi-Kombetar-i-Monitorimit-te-Mjedisit-2024.pdf>

³³ Pika 2 e neni 10 të Ligjit nr. 57/2020, datë 30.4.2020 “Për Pyjet”

³⁴ Pika 5 e neni 10 të Ligjit nr. 57/2020, datë 30.4.2020 “Për Pyjet”.

³⁵ VKM-së nr. 479 datë 29.06.2011 “Strategjia Minerare e Republikës së Shqipërisë”

Për këto fusha referuar temës së auditimit ato duhet të fokusohen në zhvillimin e aktiviteteve minerare, duke përdorur teknologji që të jetë miqësore me mjedisin, të vlerësuara për efektet e tyre në mjedis nga sistemet e shfrytëzimit, trajtimit të mineraleve, zhvillimin e aktiviteteve minerare duke përdorur teknologji bashkëkohore në riciklimin e mineraleve, kontrollin e pluhurit, emisioneve të gazit dhe shkarkimit të ujërave, përmirësimi i rezultatit të zhvillimit të operacioneve minerare nëpërmjet adresimit mjedisor dhe social, si dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë në nivelin e komunitetit dhe ndarjes së përfitimeve, sigurimin e një mbylljeje efektive dhe rehabilitimi duke stimuluar rehabilitimin progresiv, menaxhimi i mbetjeve minerare në përputhje me direktivat e BE-së, mbrojtje të panoramës, parqeve kombëtare, florës dhe faunës dhe të trashëgimisë kulturore, rritje të sensibilitetit të autoriteteve lokale për rrezikun e minierave për të shmangur ndërtimet në zonat e ndikuara nga aktivitetet minerare.³⁶

Në zbatim të strategjisë minerare është miratuar “Programi i Veprimit 3 vjeçar 2019- 2021”, me VKM Nr.664, datë 10.10.2019. Drejtimet e zhvillimit të sektorit minerar për periudhën 3 (tre) vjeçare 2022 - 2024, ndër të tjera janë edhe shfrytëzimi racional i rezervave minerare dhe mirë administrimi i kësaj pasurie kombëtare, zhvillim i aktivitetit minerar me ndikim minimal në fondin pyjor, kullosor dhe mjedis, rehabilitimi mjedisor si pjesë e pandarë nga veprimtaritë minerare, monitorimi i zonave minerare dhe rehabilitimi i mjedisit të minierave të shfrytëzuara dhe të mbyllura etj.

Nga përgjigjet zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore në zbatim të ligjit të sektorit minerar dhe Udhëzimit të Përbashkët nr. 18 dhe 19 dhe Urdhrit 67/2018 , AKBN çdo 6 muaj dërgon në MIE raportin e mbikëqyrjes si dhe informacione të ndryshme në të cilat edhe të dhëna mbi gjendjen mjedisore, megjithatë nga auditimi, konstatohet se këto monitorime nuk përmbajnë këshillime me njësitë qeverisjes vendore të zonës minerare mbi të dhënat dhe detajet mbi kryerjen e operacioneve minerare, në përputhje me normat e ruajtjes së mjedisit minerar.³⁷

Fondi i Pyllëzimit nëpërmjet pagesave nga dëmtuesit dhe të ardhurave të tjera nuk është ngritur. Ky fond parashikohej të ngrihet edhe me të ardhura nga aktiviteti minerar. Në mungesë të monitorimit të Dokumentit të Politikave të Pyjeve, nuk është e mundur të identifikohet më tej faza në të cilën ndodhet ngritja e këtij fondi, nëse parashikohet të kryhet, problematikat e hasura me të, etj.

Në aktet e miratimit me VKM për heqje nga fondi pyjor për periudhën 2014-2018 referuar 5 NJQV-ve objekt auditimi, kanë dalë 7 VKM miratimi për heqje nga fondi pyjor, për 7 subjekte me leje aktive që vazhdojnë të kryejnë aktivitet minerar për një sipërfaqe prej 201.89 hektarë. Nga auditimi u konstatua se në 5 njësitë e vetëqeverisjes vendore objekt auditimi, nga rreth 87 leje subjektsh për aktivitet minerar, janë mbyllur për arsye teknike ose revokimi për mosplotësim kriteresh apo afati, 20 leje subjektsh.

2. Gjetje nga auditimi: Dokumenti i Politikave të Pyjeve nuk është monitoruar, sepse nuk është hartuar Strategjia për Pyjet dhe rrjedhimisht nuk janë hartuar plane veprimi për të, monitorimi vjetor i të cilave do të sillte monitorimin e DPP³⁸ dhe hartimin e Programit Kombëtar të Pyjeve³⁹.

2. Konkluzion: Mungesa e një kuadri strategjik si programi kombëtar të pyjeve ,strategjia e pyjeve dhe kuadri ligjor i pa përditësuar, paraqet një gjendje jo reale dhe të pamatshme të gjendjes së pyjeve në vend të cilat për rrjedhojë vështirësojnë marrjen e masave konkrete nga aktorët përgjegjës, për përmirësimin e gjendjes.

2.1. Rekomandim: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Pyjeve, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore në bashkëpunim dhe koordinim midis tyre, të vlerësojnë gjendjen reale të fondit pyjor në vend dhe të marrin masa për

³⁶ [Microsoft Word - 109-2011.doc \(energjia.al\)](#)

³⁷ Ligj nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, neni 43, pika ç

³⁸ Pika 2, neni 10 të Ligjit nr. 57/2020, datë 30.4.2020 “Për Pyjet”.

³⁹ Pika 5 e neni 10 të Ligjit nr. 57/2020, datë 30.4.2020 “Për Pyjet”.

hartimin dhe përditësimin të kuadrit rregullator strategjik dhe monitorimin sipas planeve të veprimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.2.2. A janë plotësuar dhe përditësuar dokumentet rregullatorë për ruajtjen e fondit pyjor?

Në Shqipëri, ekzistojnë politika dhe ligje që synojnë mbrojtjen e fondit pyjor nga aktivitetet minerare, duke marrë parasysh ndikimin e konsiderueshëm negativ që mund të ketë veprimtaria minerare në pyje dhe mjedis. Në këtë kontekst, disa elemente tipike të politikave dhe masave për mbrojtjen e pyjeve duhet të përfshijnë: legjislacion të veçantë mbi mbrojtjen e pyjeve që ndalojnë ose kufizojnë aktivitetet minerare në zona të mbrojtura pyjore, si rezervatet natyrore, parqet kombëtare ose pyjet me rëndësi ekologjike dhe sociale; vlerësim të ndikimit mjedisor (VNM) ku para fillimit të aktiviteteve minerare, kompanitë janë të detyruara të kryejnë një analizë të detajuar për ndikimin në pyjet dhe mjedisin përreth; zona të ndaluara për aktivitete minerare shpallja e zonave të mbrojtura dhe përjashtimi i tyre nga lejet minerare; programe të rehabilitimit pas minierave kompanitë duhet të detyrohen të zbatojnë plane rehabilitimi që përfshijnë ripyllëzimin dhe rikthimin e tokës në gjendjen e saj natyrore; rritjen e kapaciteteve inspektuese dhe monitorimit në mënyrë të vazhdueshme aktivitetet minerare në afërsi të fondit pyjor; politika për rritjen e ndërgjegjësimit; sanksione për shkeljet, për kompanitë që dëmtojnë fondin pyjor në mënyrë të paligjshme.

Referuar ligjit të vjetër për pyjet, procesi vijues i inventarizimit të pyjeve duhet të ishte përfunduar në vitin 2014, por ky proces nuk është kryer. Ai ka nisur në vitin 2018 dhe ka përfunduar në vitin 2021. Deri në tetor 2022, nuk ka pasur publikim të të dhënave të inventarizimit. Pretendohet se ka pasur shumë diferenca në kadastrën e pyjeve. Krahasuar me vitin 2004 pretendohet se fondi pyjor është zvogëluar me 400.000 hektarë (nga 1.200.000 ha në 800.000 ha).

Nga auditimi dhe intervistat e kryera në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, procesi i fundit i inventarizimit kombëtar të pyjeve (25% e fondit pyjor), është kryer në vitin 2021. Për shkak të mungesës së fondeve, procesi pasardhës i inventarizimit të pyjeve (25% e fondit pyjor), i cili duhet të kryhej në vitin 2023, nuk ka nisur ende.

Regjistri Kombëtar i Fondit Pyjor (RKFP)⁴⁰ dhe Sistemi i integruar i informacionit për pyjet (ALFIS) nuk funksionojnë. Aktualisht nuk ka kadastrë pyjesh funksionale dhe me informacion të plotë dhe të përditësuar.⁴¹ Gjatë auditimit dhe intervistave në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, u konstatua se që prej vitit 2014-2021, nuk është kryer një dorëzim i Regjistrit Kombëtar të Pyjeve, nga MTM tek AKP, çka nuk ka siguruar të dhënat historike të këtij regjistri⁴².

Nga auditimi në njësitë e qeverisjes vendore (Bashkitë) referuar edhe përgjigjeve zyrtare nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe nga një raport⁴³ nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve mbi vlerësimin e performancës dhe aktiviteteve menaxhuese dhe kontrolluese në sektorin e pyjeve nga strukturat përgjegjëse pranë njësitë të qeverisjes vendore (Bashkitë), organizimi i Strukturave përgjegjëse për menaxhimin dhe kontroll/inspektimin e pyjeve në 61 bashkitë dhe zbatimi i kriterëve të profesionalizimit në emërimin e punonjësve në sektorin pyjor konstatohet se ka struktura apo përgjegjës për pyjet (kjo e fundit në rastet kur sipërfaqja e pyjeve është shumë e vogël), por vërehet një shumëllojshmëri strukturash apo emërtesash si: Agjenci, Drejtori, Departament etj. Shpesh njësia përgjegjëse e pyjeve i bashkëlidhet sektorëve të bujqësisë, mjedisit, ujërave, baseneve etj.

⁴⁰ Pika 1, neni 6, e Ligjit nr. 57/2020, datë 30.4.2020 “Për Pyjet”

⁴¹ Pikat 1,2 dhe 3 të nenit 21 të Ligjit nr. 57/2020, datë 30.4.2020 “Për Pyjet”

⁴² Pika 1, neni 6, Ligjit nr. 57/2020, datë 30.4.2020 “Për Pyjet”

⁴³ “Raport nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve mbi vlerësimin e performancës dhe aktiviteteve menaxhuese dhe kontrolluese në sektorin e pyjeve nga strukturat përgjegjëse pranë njësitë të qeverisjes vendore (bashkive)”

Nuk ka një orientim dhe organizim të qartë. Pothuajse në të gjitha bashkitë strukturat menaxhuese dhe kontrollues/inspektuese janë brenda një sektori duke sjellë paqartësi të ndarjes së kompetencave menaxhuese dhe kontrolluese⁴⁴ që rrjedhin nga ligji 57/2020 “Për pyjet”.

Planet e mbarështimit të ekonomive pyjore, janë dokumenti bazë afatgjatë për pyjet, për realizimin e qeverisjes, zhvillimin dhe mbrojtjen e tyre, i vlefshëm për një periudhë 10-vjeçare. Planet e mbarështimit hartohen nga pronarët përkatës sipas formës së pronësisë, bazuar në metodikat/udhëzuesit e përgatitur nga ministria, nëpërmjet ekspertëve të certifikuar të fushës ose strukturave pyjore. Për të gjitha format e pronësisë, planet e mbarështimit miratohen nga ministri. Përjashtimisht për bashkitë, miratimi i planit të mbarështimit shoqërohet me miratimin paraprak të këshillit bashkiak përkatës. Këto plane garantojnë planifikimin e punimeve, zbatimin, kontrollin apo monitorimin e planeve të mbarështimit dhe për fondin pyjor publik e privat, brenda territorit administrativ të bashkisë dhe miratohen nga kryetari i bashkisë në përputhje me planin e mbarështimit.

Nga auditimi u konstatua se planet e mbarështimit të ekonomive pyjore (10 vjeçare) dhe Planet operacionale vjetore, nuk janë hartuar dhe miratuar nga bashkitë⁴⁵ Krujë, Skrapar, Dimal dhe Selenicë, ndërsa në Bashkinë Berat ka një plan mbarështimi 10 vjeçar të miratuar në vitin 2021. Gjithashtu vihen re probleme me të drejtat e pronës, mungesa e zyrave, mjeteve të lëvizjes, kushteve të punës dhe mbi të gjitha ajo e teknologjisë bashkëkohore që është e nevojshme për kryerjen e detyrave mbi administrimin e shfrytëzimin e fondit pyjor, referuar situatës faktike në terren.

Si kryhet përditësimi i lejeve minerare? Ku parashikohet që leja minerare nuk zbardhet (aprovim paraprak), pa dalë leja mjedisore?

-Nga përgjigjet zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore sqarohet se nisur nga Akt-Miratimi i lejes minerare, MIE njofton zyrtarisht me shkresë AKBN, Qendrën Kombëtare të Biznesit, Shërbimin Gjeologjik Shqiptar dhe Autoritetin Kombëtar të Sigurisë dhe Emergjencave në Miniera. Dhe sipas Akt-Miratimit të ministrit citohet se “data efektive e lejes minerare të shfrytëzimit është data e publikimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, të Qendrës Kombëtare të Biznesit”. Gjithashtu dhe sipas V.K.M Nr.942, datë 17.11.2010. “Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e Lejeve minerare në zonat e hapura. Ministri, brenda një afati prej 120 (njëqind e njëzet) ditësh kalendarike nga data e aplikimit në QKB, nxjerr aktin e miratimit ose të refuzimit të lejes së shfrytëzimit, kërkim zbulim-shfrytëzimit dhe garancive financiare për realizimin e programit minimal të punës dhe realizimin e planit të rehabilitimit të zonës minerare. Brenda këtij afati subjekti duhet të pajiset me lejen përkatëse mjedisore që mbulon zonën e kërkuar minerare. Në rast të mos pajisjes me këtë leje, ministri nxjerr aktin e refuzimit për pajisjen me leje minerare⁴⁶.

Si funksionon në rastet kur subjekti i revokohet leja minerare? A e humbet lejen mjedisore? Si merret informacion për revokimin e lejes minerare nga AKM?

Leja minerare revokohet sipas Nenit 47, të ligjit minerar Nr. 10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Rehabilitimi i zonës së lejuar minerare kryhet nga vetë zotëruesi i lejes apo nga subjektet e kontraktuara nga ai dhe nën përgjegjësinë e zotëruesit, në mënyrë progresive dhe brenda afateve kohore të përcaktuara, sipas planit të veprimtarive të mbylljes së minierës e atij të rehabilitimit të mjedisit ose subjekti deklaron se heq dorë nga rehabilitimi i sipërfaqes së prekur nga shfrytëzimi dhe fondi i ngurtësuar për garancinë e rehabilitimit kalon në favor të shtetit⁴⁷.

⁴⁴ ligji 57/2020 “Për pyjet” (neni 16,17,35) .

⁴⁵ shkronja b) dhe c) të pikës 2 të nenit 11 të Ligjit, nr. 57/2020, datë 30.4.2020 “Për Pyjet”

⁴⁶ Përgjigje zyrtare AKBN, email datë 13.11.2024

⁴⁷ Përgjigje email zyrtar MIE, datë 05.11.2024

Si jepen lejet minerare dhe ato mjedisore ?

Referuar aktivitetit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit , nëpërmjet Drejtorisë së Shqyrtimit dhe Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve dhe sipas VKM nr. 568/2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit” e ndryshuar:

AKM, Shqyrton kërkesa për VNM paraprake apo deklarata mjedisore për veprimtari minerare sipërfaqësore dhe jep mendimin e saj në lidhje me këto veprimtari; Shqyrton kërkesa për leje mjedisi Kod III.1 për veprimtari minerare sipërfaqësore dhe jep mendimin e saj mbi kërkesat e subjekteve. Një nga kushtet e Vendimeve për Vlerësim Ndikimi në Mjedis për këtë tip veprimtarie citohet: të bëhet zbatimi i ligjit 57/2020 “Për pyjet”. Bazuar në ligjin nr. 10440/2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar. “VNM/Deklaratë është e vlefshme pasi subjekti të bëjë heqjen nga Fondi Pyjor, në rast se aktiviteti bie në një të tillë.” Një nga kushtet e lejeve mjedisore për këtë tipologji veprimtarie citohet: “Të jenë marrë të gjitha masat e nevojshme që në rast se sipërfaqja e kërkuar bie në Fond Pyjor, operatori të ndjekë procedurën për heqjen dorë nga Fondi Pyjor, përpara fillimit të punimeve të shfrytëzimit.”⁴⁸

-Dhënia e një leje mjedisore jepet në bazë të një dokumenti ligjor të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ose institucionet e varësisë së saj, (dokumenti mund të jetë njoftim fituesi, informacion mbi zonat e hapura i pari në aplikim i pari në të drejta (zonat e hapura konkurruese), Shërbimi Gjeologjik Shqiptar për ndryshim apo kalim nga kërkim zbulim në shfrytëzim. Verifikimi nëse një leje minerare është apo jo aktive bëhet duke kontrolluar regjistrin kombëtar të lejeve licencave dhe autorizimeve pranë QKB-së. AKM nuk njoftohet për revokimin e lejes minerare. Revokimi i lejes mjedisore bëhet në përputhje me ligjin 10448/2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar.

Për vitin 2021 AKM ka propozuar miratimin e 10 akteve për Leje Mjedisore si aplikime të reja ndryshime (formatizim të aktit të lejes mjedisore apo ndryshime të administratorit) apo dhe transferime në vendet Dimal, Selenicë, Krujë Berat dhe Skrapar.

Në vitin 2022 AKM ka propozuar miratimin e 4 akteve për leje të reja, ndryshime kushteve të lejes mjedisore (formatizime) në vendet Dimal, Selenicë, Krujë Berat dhe Skrapar.

Në vitin 2023 AKM ka propozuar miratimin e 9 akteve për leje mjedisore si aplikime të reja, ndryshime të kushteve të lejeve mjedisore (formatizime) në vendet Dimal, Selenicë, Krujë Berat dhe Skrapar. Subjektet kanë zhvilluar dëgjesa me publikun me datat përkatëse⁴⁹.

Në aktet e miratimit me VKM për heqje nga fondi pyjor për periudhën 2014-2018 referuar 5 NJQV-ve objekt auditimi, kanë dalë 7 VKM miratimi për heqje nga fondi pyjor, për 7 subjekte me leje aktive që vazhdojnë të kryejnë aktivitet minerar për një sipërfaqe prej 201.89 hektarë. Nga auditimi u konstatua se në 5 njësitë e vetëqeverisjes vendore objekt auditimi, nga rreth 87 leje subjektsh për aktivitet minerar ,janë mbyllur për arsye teknike ose revokimi për mosplotësim kriteresh apo afati, **20** leje subjektsh.

Nga të dhënat zyrtare të vëna në dispozicion nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore subjekt auditimi, rezulton se nga 87 subjekte me leje aktive me rreth 3604.58 hektarë sipërfaqe nga fondi pyjor. Nga këto në 7 leje aktive subjektsh janë shoqëruar me akte miratimi për heqje nga fondi pyjor me një sipërfaqe prej 395.07 hektarë. Nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për 18 subjekte me një sipërfaqe prej 949.29 hektarë janë hartuar draft/aktet për miratimin e heqjes nga fondi pyjor. Në proces hartim/miratimi të dokumentacionit për heqje nga fondi pyjor janë 30 subjekte me leje aktive me një sipërfaqe prej 1346.67 hektarë. Pa kërkesa miratimi për heqje nga fondi pyjor, janë 32 subjekte me leje aktive me 913.55 hektarë.

⁴⁸ Përgjigje email zyrtar AKM, datë 18.07.2024

⁴⁹ Përgjigje zyrtare nga AKM me email, datë 24.10.2024


Tabela.

| Nr | Total i subjekteve me leje aktive minerare | Subjekte me VKM për heqje nga fondi pyjor, të miratuar | Draft miratimi në pritje | Proces miratimi | Pa kërkesa |
|----------------------|--|--|--------------------------|-----------------|-----------------|
| Nr. subjekteve | 87 Subjekte | 7 Subjekte | 18 subjekte | 30 subjekte | 32 subjekte |
| Sipërfaqjanë Hektarë | 604.58 hektarë | 395.07 hektarë | 949.29 hektarë | 1346.67 hektarë | 913.55 hektarë. |

Burimi i të dhënave : MTM Përpunoi : Grupi i auditimit



Burimi i të dhënave: MTM Përpunoi: Grupi i auditimit



Bazë ligjore/rregullatorë e pa përditësuar, e cila shkakton paqartësi në zbatimin e procedurave.

Referuar pikës 4 të nenit 5 të Ligjit, nr. 57/2020, datë 30.4.2020 “Për Pyjet”: Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit.

Gjithashtu, në Ligjin 57/2020, përcaktohet cila strukturë miraton heqjen nga fondi pyjor.

“Ndryshime (heqje/shtesa) të sipërfaqeve nga/në fondin pyjor kombëtar bëhen me:

- miratimin e ministrit për sipërfaqe deri në 1 ha;
- vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe mbi 1 ha, deri në 10 ha;

c) ligj të veçantë për sipërfaqe mbi 10 ha.”

Mirëpo, me daljen e VKM-së së fund vitit 2022, mbështetur në ligjin e ri, e që vijon të jetë në fuqi aktualisht, procedurat për dhënien në përdorim, ndryshimin e kategorisë së përdorimit dhe dokumentacioni i nevojshëm për ndryshime në sipërfaqen e fondit pyjor parashikohet edhe në këtë VKM.

Nga ana tjetër ligji për pyjet në nenin 25 të tij parashikon dhënien në shfrytëzim/përdorim për zhvillimin e veprimtarive në fondin pyjor (p.sh. nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte në karrierë, kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit dhe shfrytëzimit të mineraleve, hidrokarbureve dhe të ujit). Procedurë e cila inicohet nga bashkia, me shpalljen e vendeve dhe shesheve të fondit pyjor ku mund të kryhen këto veprimtari. Këto bëhen duke u lidhur marrëveshje me bashkinë përkatëse ku kryhet aktiviteti minerar referuar Urdhrit të Ministrit të Mjedisit nr. 1, datë 09.06.2016, i cili përcakton rregullat për dhënien në përdorim të Fondit Pyjor nga ana e bashkisë.

Ka mungesë koordinimi kompetencash dhe mungesë koherence në aktet rregullatorë midis MTM, AKP, MIE, AKBN dhe Njërive të Vetëqeverisjes Vendore në iniciimin dhe vazhdimin e aktivitetit minerar në fondin pyjor, sepse zonat pyjore me aktivitet minerar janë në territore të bashkive të cilat aktualisht, kanë probleme me regjistrimin e pasurive pyjore të tyre, të cilat administrohen nga ato.

AKM shqyrton kërkesa për Vlerësim Ndikimi në Mjedis paraprake apo deklarata mjedisore për veprimtari minerare sipërfaqësore dhe jep mendimin e saj në lidhje me këto veprimtari si dhe shqyrton kërkesa për leje mjedisi, për veprimtari minerare sipërfaqësore dhe jep mendimin e saj mbi kërkesat e subjekteve.

Ka pasur bashkëpunim të dobët midis AKBN dhe AKM, me qëllim monitorimin e realizimit të planeve të rehabilitimit të mjedisit nga aktiviteti minerar në fondin pyjor, ndërsa bashkëpunim midis AKBN dhe Njërive të Vetëqeverisjes Vendore lidhur me veprimtarinë e subjekteve që ushtrojnë aktivitet minerar në fondin pyjor në territoret që administrohen nga këto bashki, nuk ka pasur⁵⁰.

MTM ka sjellë vonesa në miratimin e akteve të heqjes nga fondi pyjor për veprimtarinë e subjekteve të cilat kanë aplikuar dhe nuk e kanë marrë këtë aprovim për rrjedhojë nuk kanë nisur aktivitetin minerar dhe në mungesë të këtij aprovimi, duhet të kishin humbur lejen minerare.

MIE jep leje minerare për ushtrimin e aktivitetit minerar dhe AKBN nga ana tjetër sipas veprimtarisë funksionale të saj, verifikon ndikimin e aktivitetit minerar në mjedis pas aktivitetit duke vlerësuar realizimin/përfundimin e rehabilitimit mjedisor sipas planit të rehabilitimit nga zotëruesit e leje minerare, por AKBN pretendon se nuk e ka tagrin të bëjë konstatime apo verifikime në zonë, për sa kohë subjektet apo personat që shfrytëzojnë, nuk janë subjekt i zbatimit të ligjit minerar.

Nuk ka pasur as grupe pune të përbashkëta apo tryeza diskutimesh nga aktorët pjesëmarrës për unifikimin e procesit të ruajtjes së fondit pyjor nga ndikimi i aktivitetit minerar duke përcaktuar akte ligjore dhe nënligjore të cilat identifikojnë kompetenca të qarta, pa krijuar vonesa në aktet e miratimit të heqjes nga fondi pyjor dhe krijimin e infrastrukturës së nevojshme për ruajtjen e fondit pyjor nga ndikimi i aktivitetit minerar. Institucionet përgjegjëse për sektorin e pyjeve kanë role apo funksione të copëzuara, duke u kthyer në institucione jofunksionale, që nuk shkojnë në drejtim të zbatueshmërisë së ligjit.

Kryerja e procedurave të heqjes nga fondi pyjor për lejet minerale të pajisura me leje shfrytëzimi dhe leje mjedisi por të pa finalizuar me akt ligjor sipas nenit 5 të ligjit 57/2020 “Për Pyjet”. Ky proces nuk përcaktohet në një leje në vetvete por është konsideruar si një proces që patjetër duhet të ndodhë. E gjithë procedura zhvillohet pasi subjekti pajiset me leje shfrytëzimi dhe mjedisi. Ndërkohë që subjektet kanë vazhduar aktivitetin e shfrytëzimit minerar me arsyen se ju mbaron

⁵⁰ Ligj nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, neni 43, pika ç

leja e shfrytëzimit dhe mjedisit. Ky fenomen ndodh kryesisht në aktivitetet minerare të shfrytëzimit të gurit gëlqeror, ranor, pllakë apo minerale të tjera me karrierë sipërfaqësore. Praktikrat e pa mbyllura të procesit të heqjes nga fondi pyjor të sipërfaqeve që shfrytëzohen si karriera sjellin si pasojë:

1. Mungesën e pagesës për pyllëzimin kompensues përkatës së sipërfaqeve që vihen në dispozicion nga bashkia bazuar në VKM-në 537 date 22.09.2021 “Për përcaktimin e kostove të përlllogaritura për pyllëzim kompensues, në rastet e ndryshimit të destinacionit të fondit pyjor” si dhe VKM nr. 888 datë 27.12.2022, “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”.

2. Mungesën e pasqyrit të ndryshimeve në regjistrin e kadastrës të fondit pyjor.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, procesi i fundit i inventarizimit kombëtar të pyjeve (25% e fondit pyjor), është kryer në vitin 2021. Për shkak të mungesës së fondeve që i alokohen Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, procesi vijues i inventarizimit të pyjeve (25% e fondit pyjor), i cili duhet të kryhej në vitin 2023, nuk ka nisur ende.

- Regjistri Kombëtar i Fondit Pyjor (RKFP)⁵¹ dhe Sistemi i integruar i informacionit për pyjet (ALFIS) nuk funksionojnë. Aktualisht nuk ka kadastrë pyjesh funksionale dhe me informacion të plotë dhe të përditësuar.⁵² Gjatë auditimit në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, u konstatua se prej periudhës 2014-2021, nuk është kryer një dorëzim i Regjistrit Kombëtar të Pyjeve, nga MTM tek AKP, çka nuk ka siguruar të dhënat historike të këtij regjistri⁵³.

3. Konkluzion: Mungesa e infrastrukturës dhe mosfunksionimi i sistemit të integruar të informacionit (ALFIS) ka bërë që mos të vijoje me procesin e inventarizimit të pyjeve i cili duhet të ishte përfunduar në vitin 2014. Ky proces ka nisur në vitin 2018 dhe ka përfunduar në vitin 2021. Deri në tetor 2022, nuk ka pasur publikim të të dhënave të inventarizimit.

3.1. Rekomandim: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve të marrin masa për vënien në përdorim dhe funksion të sistemit të integruar të informacionit për pyjet (ALFIS) dhe plotësimin e Regjistrit Kombëtar të Fondit Pyjor me qëllim funksionimin e kadastrës së pyjeve të pajisur me informacion të plotë dhe të përditësuar.

Deri më 30.06.2025

3.2. Rekomandim: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve të marrin masa për fillimin e procesit të inventarizimit kombëtar të pyjeve në rang vendi, duke bashkërenduar punën me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për regjistrimin e ekonomive pyjore sipas planeve të mbarështimit për çdo NJQV.

Deri më 30.06.2025

4. Gjetje nga auditimi: Në njësitë e vetëqeverisjes vendore objekt auditimi në strukturat përgjegjëse për pyjet, konstatohet se njësia përgjegjëse e pyjeve i bashkëlidhet sektorëve të bujqësisë, mjedisit, ujërave, baseneve etj, por nuk ka një orientim dhe organizim të qartë. Pothuajse në të gjitha bashkitë strukturat menaxhuese dhe kontrollues/inspektuese janë brenda një sektori duke sjellë paqartësi të ndarjes së kompetencave dhe përgjegjësiave menaxhuese dhe kontrolluese⁵⁴ që rrjedhin nga ligji 57/2020 “Për pyjet”.

4. Konkluzion: Paqartësia e kompetencave dhe mungesa e një sistemi të integruar nga Ministria përgjegjëse deri tek përdoruesi në pyje (qytetari/subjekti) e bën të paqëndrueshëm dhe të paqartë

⁵¹ Pika 1, neni 6, e Ligjit nr. 57/2020, datë 30.4.2020 “Për Pyjet”

⁵² Pikat 1,2 dhe 3 të nenit 21 të Ligjit nr. 57/2020, datë 30.4.2020 “Për Pyjet”

⁵³ Pika 1, neni 6, Ligjit nr. 57/2020, datë 30.4.2020 “Për Pyjet”

⁵⁴ ligji 57/2020 “Për pyjet” (neni 16,17,35) .

rolin e strukturave inspektuese për pyjet në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, në raport me mbrojtjen e fondit pyjor.

4.1. Rekomandim: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të marrë masa për përditësimin e politikave, harmonizimin e akteve ligjore dhe nënligjore lidhur me integrimin institucional në sistem, që të orientojë riorganizimin optimal të sektorit të pyjeve, si pjesë e reformës strukturore në qeverisje. Gjithashtu, të merren masa për përforsimin e rolit të strukturave, riorganizimin e funksioneve dhe grupimin e tyre, nëpërmjet delegimit të duhur dhe të plotë në njësitë vendore.

Është e nevojshme që riorganizimi i strukturave, të konsiderojë të gjitha nivelet, duke përfshirë sistemin ministror dhe shqyrtimin për shtim kompetencash në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe riorganizim të funksioneve të inspektimit kontroll më të madh në pyje, për minimizimin fenomeneve të shfrytëzimit të paligjshëm të fondit pyjor.

Deri më 30.06.2025

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se planet e mbarështimit të ekonomive pyjore (10 vjeçare) dhe Planet operacionale vjetore, nuk janë hartuar dhe miratuar nga bashkitë⁵⁵ Krujë, Skrapar, Dimal dhe Selenicë, ndërsa në Bashkinë Berat ka një plan mbarështimi 10 vjeçar të miratuar në vitin 2021. Disa nga arsyet e mos-hartimit të planeve të mbarështimit të ekonomive pyjore, vijnë dhe nga problemet me të drejtat e pronës.

Ka mungesa në logjistikë si mungesa e zyrave, mjeteve të lëvizjes, kushteve të punës dhe mbi të gjitha ajo e teknologjisë bashkëkohore që është e nevojshme për kryerjen e detyrave mbi administrimin e shfrytëzimin e fondit pyjor, referuar situatës faktike në terren.

5. Konkluzion: Mangësitë në plotësimin e kuadrit ligjor dhe infrastrukturës logjistike, sjellin për rrjedhojë menaxhim të dobët të ekonomive pyjore nga sektorët e pyjeve në njësitë e qeverisjes vendore.

5.1. Rekomandim: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të marrin masa për hartimin dhe përditësimin e planeve të mbarështimit të ekonomive pyjore dhe mbikëqyrjen e tyre për arritjen e objektivave strategjike, të përcaktuar në Dokumentin e Politikave të Pyjeve.

Deri më 30.06.2025

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka sjellë vonesa në miratimin e akteve të heqjes nga fondi pyjor për veprimtarinë e subjekteve të cilat kanë aplikuar dhe nuk e kanë marrë këtë aprovim, për rrjedhojë nuk kanë nisur aktivitetin minerar dhe në mungesë të këtij aprovimi, duhet të kishin humbur lejen minerare.

-Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë jep leje minerare për ushtrimin e aktivitetit minerar dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore nga ana tjetër sipas veprimtarisë funksionale të saj, verifikon ndikimin e aktivitetit minerar në mjedis pas aktivitetit duke vlerësuar realizimin/përfundimin e rehabilitimit mjedisor sipas planit të rehabilitimit nga zotëruesit e leje minerare, por AKBN nuk e ka tagrin të bëjë konstatime apo verifikime në zonë, për sa kohë subjektet apo personat që shfrytëzojnë, nuk janë subjekt i zbatimit të ligjit minerar.

-Ka mungesë koordinimi kompetencash dhe mungesë koherence në aktet rregullatorë midis MTM, AKP, MIE, AKBN dhe Njërive të Vetëqeverisjes Vendore në inicimin dhe vazhdimin e aktivitetit minerar në fond pyjor, sepse zonat pyjore me aktivitet minerar janë në territore të bashkive të cilat aktualisht kanë probleme me regjistrimin e pasurive pyjore të tyre, të cilat administrohen nga vetë ato.

⁵⁵ shkronja b) dhe c) të pikës 2 të nenit 11 të Ligjit, nr. 57/2020, datë 30.4.2020 "Për Pyjet"

-Ka pasur nivel të ulët bashkëpunimi midis AKBN dhe AKM, me qëllim monitorimin e realizimit të planeve të rehabilitimit të mjedisit nga aktiviteti mineralar në fondin pyjor, ndërsa nuk ka pasur bashkëpunim midis AKBN dhe Njësive të Vetëqeverisjes Vendore lidhur me veprimtarinë e subjekteve që ushtrojnë aktivitetet mineralar në fondin pyjor në territoret që administrohen nga këto bashki⁵⁶.

- Nga aktorët pjesëmarrës për unifikimin e procesit të ruajtjes së fondit pyjor nga ndikimi i aktivitetit mineralar, nuk ka pasur as grupe pune të përbashkëta apo tryeza diskutimesh duke përcaktuar akte ligjore dhe nënligjore të cilat identifikojnë kompetenca të qarta, pa krijuar vonesa në aktet e miratimit të heqjes nga fondi pyjor dhe krijimin e infrastrukturës së nevojshme për ruajtjen e fondit pyjor nga ndikimi i aktivitetit mineralar. Institucionet përgjegjëse për sektorin e pyjeve kanë role apo funksione të copëzuara, duke u kthyer në institucione jofunksionale, që nuk shkojnë në drejtim të zbatueshmërisë së ligjit.

6. Konkluzion: Mungesa e koherencës dhe paqartësia e kompetencave në aktet rregullatorë midis MTM, AKP, MIE, AKBN dhe Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, sjellin për rrjedhojë menaxhim të dobët të ekonomive pyjore nga sektorët e pyjeve dhe monitorim të dobët të ndikimit të aktivitetit mineralar në fondin pyjor.

6.1. Rekomandim: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Pyjeve, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe Bashkitë Krujë, Selenicë, Skrapar, Berat, Dimal në bashkëpunim të marrin masa, për përcaktimin e kompetencave të qarta nëpërmjet akteve ligjore të miratimit të heqjes së pyjeve nga fondi pyjor dhe krijimin e infrastrukturës së nevojshme për ruajtjen e tij nga ndikimi i aktivitetit mineralar.

Deri më 31.12.2025

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se procesi i heqjes së sipërfaqes nga fondi pyjor për lejet mineralare të pajisura me leje shfrytëzimi dhe leje mjedisi të operatorëve që ushtrojnë aktivitetet mineralar, pothuajse në shumicën e rasteve nuk finalizohet me akt ligjor sipas nenit 5 të ligjit 57/2020 “Për Pyjet” nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Sipas legjislacionit në fuqi, procedura e heqjes nga fondi pyjor zhvillohet pasi subjekti pajiset me leje shfrytëzimi dhe pa u miratuar leja e mjedisit. Nga auditimi u konstatua se subjektet kanë vazhduar aktivitetin e shfrytëzimit mineralar me arsyen se ju mbaron leja e shfrytëzimit. Ky fenomen ndodh kryesisht në aktivitetet mineralare të shfrytëzimit të gurit gëlqeror, ranor, pllakor apo minerale të tjera me karrierë sipërfaqësore. Praktikën e pa mbyllura të procesit të heqjes nga fondi pyjor të sipërfaqeve që shfrytëzohen si karriera, sjellin mungesën e pagesës për pyllëzimin kompensues përkatës së sipërfaqeve që vihen në dispozicion nga bashkia⁵⁷ si dhe mungesa në pasqyrimin e ndryshimeve në regjistrin kadastral të fondit pyjor.⁵⁸

7. Konkluzion: Mos finalizimi i procesit të heqjes nga fondi pyjor me akt ligjor duke e bashkërenduar me pasqyrimet e ndryshimeve në regjistrin kadastral të fondit pyjor, sjell një mosrakordim veprimesh në nivel qendror dhe vendor.

7.1. Rekomandim: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore si dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore pjesëmarrëse në këtë proces, të marrin masa që sipas kompetencave dhe përgjegjësisë funksionale të

⁵⁶ Ligj nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineralar në Republikën e Shqipërisë”, neni 43, pika ç

⁵⁷ VKM-në 537, datë 22.09.2021 “Për përcaktimin e kostove të përlogaritura për pyllëzim kompensues, në rastet e ndryshimit të destinacionit të fondit pyjor”

⁵⁸ VKM nr. 888 datë 27.12.2022 , “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”

përditësojnë aktet rregullatorë në mënyrë që procesi i heqjes nga fondi pyjor i këtyre sipërfaqeve të kryhet paralel me marrjen e lejes së shfrytëzimit dhe mjedisit dhe pa mbylljen e këtij procesi të mos zbardhet leja e mjedisit dhe e shfrytëzimit të aktivitetit. Nga ana tjetër të konsiderohet hartimi i një formati leje më vete me përmbajtje dhe detyrime, e cila do të kushtëzojë mos fillimin e aktivitetit minerar, pa u kryer heqja nga fondi pyjor e sipërfaqes ku do të punojë subjekti, i cili e ka marrë lejen e aktivitetit minerar.

Deri më 30.06.2025

4.3 A është garantuar nga institucionet përgjegjëse monitorimi dhe inspektimi i mbrojtjes dhe rehabilitimit të fondit pyjor nga ndikimi i aktivitetit minerar?

4.3.1 A janë marrë masat nga institucionet përgjegjëse, për monitorimin dhe inspektimin mbi ndikimin e aktivitetit minerar në fondin pyjor?

Institucionet përgjegjëse si Agjencia Kombëtare e Pyjeve, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe Bashkitë Krujë, Selenicë, Skrapar, Berat, Dimal kanë ndërmarrë disa masa për monitorimin dhe inspektimin e ndikimit të aktivitetit minerar në fondin pyjor, por efektiviteti i tyre shpesh vihet në pikëpyetje për shkak të sfidave institucionale, teknike dhe burimeve të kufizuara, mosrespektimi i lejeve minerare, koordinimi i dobët i institucioneve, aktiviteteve të paligjshme minerare, monitorim i pamjaftueshëm, etj.

- *Bashkitë nuk kanë kryer asnjë inspektim për aktivitetet minerare që operojnë në fondin pyjor.*

Referuar Ligjit “Për pyjet”, struktura përgjegjëse për pyjet në Bashki kontrollon dhe realizon proceset inspektuese për veprimtaritë që zhvillohen në fondin pyjor kombëtar nga subjektet private e publike, juridike e fizike, mbikëqyr zbatimin e kushteve të lejeve, licencave dhe detyrimeve kontraktuale nga ana e tyre, si dhe propozon tek institucioni përgjegjës pezullimin dhe shfuqizimin e tyre.

U konstatua se: Bashkia Krujë, Selenicë, Skrapar, Berat, Dimal nuk kanë kryer asnjë inspektim në subjektet minerare që operojnë në fondin pyjor, me synim mbrojtjen e pyjeve dhe e tokës pyjore.

- *Bashkitë Krujë, Dimal dhe Berat nuk kanë krijuar ende strukturë përgjegjëse për inspektimin.*

Referuar Ligjit “Për pyjet”, neni 40, pika 3, përcakton se “Ngarkohen organet e bashkive që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të përcaktojnë dhe të miratojnë ngritjen/riorganizimin e strukturave përgjegjëse për pyjet, ku përfshihen edhe ato kontrolluese, sipas përcaktimeve në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim”. Ligji nr. 57/2020 “Për pyjet” është miratuar në datën 30.04.2020. Ndërsa, kanë kaluar 4 vjet nga miratimi i ligjit, Bashkia Krujë, Dimal dhe Berat ende nuk kanë miratuar strukturën përgjegjëse me attribute inspektuese për pyjet. Për sa i përket Bashkisë Skrapar, struktura inspektuese për pyjet është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Skrapar me nr. 44, datë 15.11.2023, e cila u emërtua “Ndërmarrja e Shërbimit Pyjor” me 21 punonjës, nga të cilët, kanë funksion inspektimin 15 punonjës (2 përgjegjës sektori dhe 13 inspektorë terreni).

Po kështu, struktura përgjegjëse në Bashkinë Selenicë është miratuar me Urdhër nr. 10, datë 18.01.2022 të kryetarit të bashkisë Selenicë, strukturë e emërtuar “Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave”.

- *Personat e emëruar në strukturën inspektuese nuk janë me profilin e duhur arsimor.*

Bashkitë ngrenë strukturën përgjegjëse për pyjet brenda territorit të tyre, me personel me arsim profesional dhe të lartë pyjor, duke garantuar një raport të drejtë gjinor”.⁵⁹

Bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion të grupit të auditimit, vëmë re se; në strukturën vendore përgjegjëse për pyjet, në Bashkinë e Selenicës (pas krijimit të strukturës inspektuese) janë emëruar në detyrë 13 nëpunës, nga të cilët vetëm një nëpunës është me arsim të lartë inxhinier

⁵⁹ Ligji “Për pyjet”, neni 16, pika 3

pyjesh. Punonjësit e tjerë janë me arsim: mësues, informatikë, agronom, si dhe me arsim të mesëm etj.

Ndërsa në Bashkinë e Skraparit (pas krijimit të strukturës kontrolluese) nga 15 nëpunësit e punësuar në “Ndërmarrjen e Shërbimit Pyjor” vetëm 2 punonjës janë me profil inxhinier pyjesh, pjesa tjetër (11 persona) janë me arsim të mesëm. Punonjësit e tjerë janë agronom, ekonomik drejtësi etj.

➤ *Bashkitë nuk kanë kryer inspektime nëpërmjet sistemit unik e-inspektime.*

Nga momenti i miratimit të strukturës inspektuese për pyjet, në bashkinë e Selenicës dhe të Skraparit nuk është kryer asnjë inspektim në portalin unik e-Inspektimi, për subjektet minerare që operojnë në fondin pyjor. Referuar kthimit të përgjigjes të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve cilëson se “*bashkia Selenicë dhe bashkia Skrapar nuk janë trajnuar për fillimin e inspektimeve online pasi nuk kanë pasur në strukturën e tyre strukturën e plotësuar me inspektor me arsim të lartë, sipas parashikimit ligjor*”.

➤ *Bashkitë Selenicë dhe Skrapar nuk kanë miratuar programet mujore/vjetore për të kryer inspektime në subjektet që operojnë në fondin pyjor.*

Nga bashkitë që janë objekt auditimi (Bashkia Dimal, Krujë, Skrapar, Berat, Selenicë) vetëm 2 janë bashkitë që kanë miratuar strukturën inspektuese për pyjet, (trajtuar më sipër). Nëpërmjet programit vjetor të inspektimit planifikohen në mënyrë sasiore aktet e inspektimit duke u bazuar në numrin e inspektorëve shtetërorë dhe kualifikimet e tyre, numrin e subjekteve të inspektimit dhe kategoritë e tyre, shpërndarjen territoriale të subjekteve të inspektimit, sipas fushës së inspektimit, kompleksitetin dhe kohëzgjatjen e inspektimeve sipas subjekteve.⁶⁰

Referuar Urdhrit të Inspektorit të Përgjithshëm me nr. 13, datë 23.04.2015 “ Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë”, kapitulli 2 “Programi i veprimtarive të inspektimit” përcaktohet se “*Si pjesë e procesit të planit të inspektimit, Inspektorati shtetëror duhet t’i përmbahet disa dokumenteve kyçe, ku përfshihen raportet vjetore të inspektimit e të tjera të jashtme të cilat ndihmojnë Inspektoratin shtetëror që të krijojë një panoramë mbi gjendjen e subjekteve të inspektimit, si dhe risqet që i duhet të përballojë.*”.

Referuar Udhëzimit të Inspektorit të Përgjithshëm nr. 17, datë 20.04.2023 “Për bashkërendimin e funksioneve inspektuese në fushën e mbrojtjes së pyjeve” kapitulli III, pika 2 përcakton se “*Agjencia Kombëtare e Pyjeve harton programin vjetor dhe mujor të inspektimit të koordinuar për të gjitha strukturat përgjegjëse për inspektimin e pyjeve dhe e paraqet të përmbledhur pranë Inspektoratit Qendror për mendim këshillimor*”.

Nga auditimi u konstatua se Bashkia Selenicë dhe Skrapar të cilat kanë miratuar strukturën inspektuese për pyjet, nuk kanë hartuar programet mujore dhe vjetore.

➤ *Mungesë bashkëpunimi e bashkive me Agjencinë Kombëtare të Pyjeve për monitorimin e fondin pyjor.*

Sipas legjislacionit në fuqi, inspektorët e strukturave të pyjeve në bashki, bashkëpunojnë me strukturat përgjegjëse për kontrollin dhe monitorimin pranë agjencisë shtetërore përgjegjëse për pyjet.⁶¹

Nga analizimi i të dhënave të vendosura në dispozicion, grupit të auditimit, Bashkia Dimal, Selenicë, Krujë, Skrapar, Berat nuk kanë kryer asnjë inspektim të përbashkët me Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, lidhur me mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve në fondin pyjor kombëtar.

➤ *Raportet e monitorimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore kanë mangësi të dhënash.*

Struktura përgjegjëse e monitorimit në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore harton dhe i paraqet ministrit çdo 6 muaj një raport për çdo veprimtari minerare, i cili përmban të dhëna për respektimin e realizimit të projektit minerar; realizimin e operacioneve e të punimeve minerare dhe depozitimin e mbetjeve minerare; lëvizjen e rezervave minerare; kryerjen e operacioneve

⁶⁰ Urdhëri i Inspektorit të Përgjithshëm me nr.13, datë 23.04.2015 “ Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë

⁶¹ Ligji “ Për Pyjet”, neni 16, pika 5

minerare, në përputhje me normat e ruajtjes së mjedisit mineral, duke u këshilluar me njësitë qeverisjes vendore të zonës minerare; respektimin e standardeve të sigurisë në punë e të mbrojtjes së shëndetit të punonjësve, duke dhënë edhe rekomandimet përkatëse.⁶²

Procedurat nëpër të cilat kalon monitorimi mineral dhe postmineral janë vëzhgimi, regjistrimi, mbajtja nën kontroll i ndryshimeve fiziografike të tokës, ajrit, ujërave, sipërfaqësore apo nëntokësore, dhe ekosistemit në përgjithësi, në zonat ku ushtrohet apo është ushtruar veprimtari minerare, si dhe marrja e masave parandaluese për fenomenet negative, që shfaqen gjatë apo pas veprimtarisë minerare.⁶³

-U shqyrtuan monitorimet ⁶⁴e kryera nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore në subjektet minerare që operojnë në fondin pyjor dhe rezultoi se: në inspektimet e kryera bëhet një përshkrim i përgjithshëm i punës (si psh. subjekti ka miratuar planin vjetor të punës, numrin e punonjësve gjithsej, numri i punonjësve të siguruar nga aksidentet personale) si dhe plotësohet me të dhëna të deklarimeve të vetë subjektit. Grupi i punës i AKBN-së ka lënë detyrë për rehabilitimin e mjedisit në disa subjekte (tabela e mëposhtme), ndërkohë nuk është marrë asnjë masë administrative për shkeljet e konstatuara.

| Nr. rendor | Subjekti | Viti 2022 |
|------------|----------|-----------|
| 1 | T. E. | Berat |
| 2. | B . S. | Berat |
| 3. | T. B. | Berat |
| 4. | A. | Dimal |
| 5. | A. | Dimal |
| 6. | V. Ll. | Dimal |
| 7. | B. | Dimal |
| 8. | V. H. | Skrapar |
| 9. | P. N. | Skrapar |
| 10. | D. 2. | Skrapar |
| 11. | A. | Skrapar |
| 12. | B. B. | Skrapar |

Burimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore. Punoi: Grupi i auditimit

- Janë identifikuar 8 raste të raporteve të monitorimit, që AKBN nuk është shprehur në lidhje me rehabilitimin e mjedisit.

-Përgjigjja e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë citon se “gjatë monitorimit për subjektet minerare krahas mbikëqyrjes së aktivitetit mineral kontrollohet dhe rehabilitimi i mjedisit edhe gjatë zhvillimit të aktivitetit mineral dhe në përfundim të tij”.

Nga kontrolli i raporteve të monitorimit⁶⁵ të mbajtura nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, u konstatua se raportet e monitorimit/procesverbalet e inspektimit nuk përmbanin të dhëna për rehabilitimin e mjedisit gjatë aktivitetit mineral të subjektit përkatës.

Në vijim, paraqiten disa raste të identifikuara nga grupi i auditimit, ku specialistët e AKBN-së, në raportet e monitorimit, nuk janë shprehur në lidhje me rehabilitimin e mjedisit.

| 1. | Subjekti | Muaji i monitorimit |
|----|----------|---------------------|
| 2. | A.C. | Shtator 2023 |
| 3. | P. | Nëntor 2022 |
| 4. | V. H. | Qershor 2023 |
| 5. | M. p. | Maj 2023 |
| 6. | A.2. | Maj 2023 |
| 7. | Y. S. | Maj 2023 |
| 8. | V.I. | Shtator 2023 |

Burimi: AKBN.Punoi: Grupi i Auditimit

⁶² Ligji “Për sektorin mineral”, i ndryshuar, neni 43, pika 3

⁶³ Ligji “ Për sektorin mineral “, neni 2, pika 24.

⁶⁴ Janë përzgjedhur 31 praktika.

⁶⁵ Janë përzgjedhur 31 praktika.

➤ *AKBN nuk kryen monitorim 2 herë në vit në subjektet minerare.*

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore harton dhe i paraqet ministrit çdo 6 muaj një raport për çdo veprimtari minerare.

Nga ana e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore përgjatë viteve objekt auditimi 2021-2023 nuk janë monitoruar në mënyrë periodike, të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtarinë minerare në fondin pyjor në bashkitë Dimal, Selenicë, Krujë, Skrapar, Berat. Nga 31 subjekte të shqyrtuara/përzgjedhura nga grupi i auditimit, ka rezultuar se struktura përgjegjëse e monitorimit në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore nuk ka monitoruar 2 (dy) herë në vit, 11 subjekte (për periudhën 2021), 10 subjekte (viti 2022) dhe 29 subjekte për vitin 2023.

Nr. i subjekteve që janë monitoruar 2 herë në vit nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.

| | Subjektet gjithsej | Viti 2021 | Viti 2022 | Viti 2023 |
|------------------|--------------------|-------------|-------------|------------|
| Bashkia Berat | 7 | 0 subjekte | 0 subjekte | 0 subjekte |
| Bashkia Krujë | 3 | 2 subjekte | 3 Subjekte | 2 subjekte |
| Bashkia Dimal | 4 | 4 subjekte | 4 subjekte | 0 subjekte |
| Bashkia Selenicë | 6 | 4 subjekte | 4 subjekte | 0 subjekte |
| Bashkia Skrapar | 11 | 10 subjekte | 10 subjekte | 0 subjekte |

Burimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore. Punoi: Grupi i Auditimit.

Ndërsa, gjatë 6- mujorit të dytë të 2023 nuk është monitoruar asnjë subjekt minerar, për shkak të mungesës së fondeve.⁶⁶

➤ *Subjektet minerare në fondin pyjor nuk dorëzojnë raportet 3 mujore në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore.*

Zotëruesi i lejes së shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet ka detyrime të paraqesë pranë strukturës përgjegjëse çdo 3 muaj, jo më vonë se data 15 e muajit që vijon pas tremujorit përkatës, një informacion mbi realizimin e prodhimit, investimeve, vlerën e produkteve të shitura, punimeve minerare të realizuara dhe gjithë operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve, në përputhje me detyrimet e lejes së tij minerare dhe planin vjetor.⁶⁷

Me ndryshimet ligjore të ligjit “Për sektorin minerar” në vitin 2021, ndër të tjera, u ndryshua periudha e raportimit të subjekteve minerare në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, (informacioni të paraqitet në AKBN-në çdo 3 muaj, u bë informacioni të paraqitet çdo 6 muaj). Më poshtë, paraqitet lista e subjekteve minerare (6 subjekte) që nuk e kanë dorëzuar informacionin me të dhënat e kërkuara në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore.

| Nr. rendor | Subjekti | Dorëzimi i raporteve |
|------------|----------|------------------------|
| 1. | B. S. | Mungojnë 2 raporte |
| 2 | S. | Mungojnë 2 raporte |
| 3. | I. | Mungon 1 raport |
| 4. | G.C. | 1 raport jashtë afatit |
| 5. | T. E. | 1 raport jashtë afatit |
| 6. | B.&B. | 1 raport jashtë afatit |

Burimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve. Përpunoi: Grupi i auditimit .

➤ *Janë identifikuar 7 raste që subjektet minerare nuk dorëzojnë në AKM, raportet 6 mujore të vetmonitorimit për zbatimin e kushteve të lejes mjedisore.*

Subjektet që janë të pajisura me leje mjedisi, çdo 6 muaj, raportojnë në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për zbatimin e kushteve të lejes mjedisore. Më poshtë, janë paraqitur 7 subjekte minerare që janë identifikuar nga grupi i auditimit⁶⁸, që nuk kanë dorëzuar në mënyrë periodike çdo 6 muaj raportet e vetmonitorimit.

⁶⁶ Kthim përgjigje nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore

⁶⁷ Ligji Nr.10 304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 18

⁶⁸ Grupi i auditimit ka përzgjedhur 31 subjekte.

| Nr.rendor | Subjekti | Muaji i monitorimit |
|-----------|----------|------------------------|
| 1. | H. | Mungon viti 2023 |
| 2. | M. | Mungon viti 2023 |
| 3. | S. G. | 2021-2023 asnjë raport |
| 4. | S. | 2021-2023 asnjë raport |
| 5. | G. C. | 2021-2023 asnjë raport |
| 6. | I.C. | Viti 2022 |
| 7. | A. | Shkurt 2022-Gusht 2022 |

Burimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Punoi: Grupi i auditimit

- Janë identifikuar 13 subjekte minerare në fondin pyjor që nuk janë inspektuar nga struktura përgjegjëse për mjedisin.

Subjektet që ushtrojnë aktivitet minerar duhet të pajisen me leje mjedisi. Sipas legjislacionit në fuqi, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe agjencitë rajonale në varësi të saj inspektojnë subjektet (pasi pajisen me leje mjedisi), në lidhje me zbatimin e kushteve të lejes mjedisore.

Subjektet e mëposhtme minerare që ushtrojnë aktivitet në bashkitë respektive nuk janë inspektuar asnjëherë përgjatë viteve 2021-2023, edhe pse janë të pajisur me leje mjedisi.

| Nr.rendor | Subjekte | Adresa |
|-----------|-----------|----------|
| 1. | K. | Berat |
| 2. | A. | Dimal |
| 3. | A. | Dimal |
| 4. | V. Ll. | Dimal |
| 5. | B. | Dimal |
| 6. | S. P. | Skrapar |
| 7. | B . S. | Berat |
| 8. | P. R.e S. | Berat |
| 9. | S. G. | Berat |
| 10. | D. | Dimal |
| 11. | H. | Dimal |
| 12. | S. | Dimal |
| 13. | B. S. | Selenice |

Burimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Përpunoi:Grupi i Auditimit

- Mangësi të dhënash në listë-verifikimet e inspektimit të mbajtura nga AKM dhe agjencitë rajonale të mjedisit.

Formati standard i akt miratimit të lejes mjedisore tipi A dhe B përfshin kushte të përcaktuara “subjekti duhet të përgatisë dhe paraqes për miratim pranë AKM një plan të detajuar dhe kostot përkatëse për çmontimin ose mbylljen e instalimit. Planet për çmontimin dhe rehabilitimin duhet të rishikohen çdo vit dhe të paraqiten për miratim në AKM”.

Lista e verifikimit (që mbahet nga inspektorët shtetërore në subjekt, pas pajisjes me leje mjedisi) përmban kërkesa si: A janë zbatuar kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit të lejes mjedisore , referuar kushtit çmontimi , rehabilitimi dhe kontrolli pas ndërprerjes së operacioneve?

-Në subjektet e mëposhtme, listë verifikimet (të mbajtura nga inspektorët shtetërore) nuk janë plotësuar me të gjitha kërkesat përkatëse. Nuk është dhënë një informacion i saktë dhe i plotë, në lidhje me plotësimin e kushtit të planeve të rehabilitimit. Edhe pse në mungesë të këtij dokumenti (referuar sistemit e-Inspektimi), në vendimet përfundimtare të inspektimit, nuk është marrë asnjë masë administrative ndaj këtyre subjekteve.

| Nr. | Subjekti | Listë verifikimi | Datë |
|-----|--------------------|------------------------------|------------|
| 1. | D. 2. | Nr. AKM-BR-2021-000039 - 2/1 | 07/07/2021 |
| 2. | D. | Nr. AKM-BR-2021-000040 - 2/1 | 07/07/2021 |
| 3. | P. X. | Nr. AKM-DQ-2022-000066 - 2/1 | 11/03/2022 |
| 4. | P. | Nr. AKM-DQ-2021-000126 - 2/1 | 07/10/2021 |
| 5. | 05/10/2021 | AKM-DQ-2021-000131 - 2/1 | 05/10/2021 |
| 6. | P. N. | Nr. AKM-BR-2021-000108 - 2/1 | 10/08/2021 |
| 7. | SH. – A. | Nr. AKM-TR-2021-000028 - 2/1 | 21/06/2021 |
| 8. | 26/10/2021 | Nr. AKM-FR-2021-000197 - 2/1 | 26/10/2021 |
| 9. | T.E.SH. (Skrapar) | Nr. AKM-BR-2021-000078 - 2/1 | 14/07/2021 |
| 10. | Xh. | Nr. AKM-LE-2022-000017 - 2/1 | 23/02/2022 |
| 11. | X. 0. | Nr. AKM-DQ-2022-000042 - 2/1 | 01/03/2022 |
| 12. | Y.S. | Nr. AKM-FR-2021-000003 - 2/1 | 09/06/2021 |
| 13. | A.C. | Nr. AKM-FR-2021-000100 - 2/1 | 16/07/2021 |
| 14. | G.I.B. | Nr. AKM-BR-2021-000004 - 2/1 | 03/06/2021 |
| 15. | K. | Nr. AKM-BR-2021-000235 - 2/1 | 10/12/2021 |
| 16. | 17/06/2021M. | Nr. AKM-BR-2021-000006 - 2/1 | 17/06/2021 |
| 17. | Sh. | Nr. AKM-BR-2021-000120 - 2/1 | 05/08/2021 |

➤ *Institucionet e varësisë nuk zbatojnë Udhëzimin e përbashkët të 2 ministrive*
 Nëpërmjet një Udhëzimi të përbashkët me nr.18, datë 24.08.2022 mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit “Mbi garancinë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit të mjedisit për veprimtaritë minerare” janë parashikuar grupe të përbashkëta për të kryer kontrole për të vlerësuar realizimin/përfundimin e rehabilitimit mjedisor. Verifikimi dhe kontrolli i planit të rehabilitimit të mjedisit për lejet e kërkim-zbulimit kryhet nga një grup i përbashkët i ngritur me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për mjedisin dhe ministrit përgjegjës për veprimtaritë minerare. Grupi i punës ka në përbërje 3 anëtarë nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar dhe 2 anëtarë nga Agjencia Kombëtare të Mjedisit.

Ndërsa, kontrolli për rehabilitimin e mjedisit për lejet e shfrytëzimit dhe lejet e kërkimit-zbulimit-shfrytëzimit kryhet një grup pune me përbërje 3 anëtarë nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe 2 anëtarë nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

-Nga përgjigjja e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë cilësohet se “në zbatim të urdhrin nr.18, datë 24.08.2022 , vetëm një rast kemi kryer inspektim të përbashkët me AKM , për planin e mbylljes dhe rehabilitimit të mjedisit në lejen minerare të shfrytëzimit nr.711 , datë 10.07.2003 , objekti i F.-N.”K. “, bashkia Përrenjas . Inspektimi u krye me grup të përbashkët AKBN-AKM dhe u lanë detyrat përkatëse për rehabilitimin e plotë të shkallëve të karrierës ,rrethimin/ mbylljen e rrugëve hyrëse, zëvendësimin /shtimin e fidanëve të mbjellë dhe kohën e realizimit të këtyre detyrave. Rehabilitimi i kryer nga shoqëria nuk u pranua nga grupet e punës AKM-AKBN, pasi nuk është bërë i plotë”.


-Në vijim të Udhëzimit të mësipërm, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka kryer edhe një inspektim të përbashkët me Shërbimin Gjeologjik Shqiptar për objektin i F.-N. ”K.“, Bashkia Përrenjas.

Për sa më lart, konstatohet se strukturat e varësisë të MIE dhe MTM nuk kanë kryer kontrole të përbashkëta për realizimin e planit të rehabilitimit për veprimtaritë minerare.

➤ *Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore ka propozuar për revokim 33 leje minerare, në rang vendi. Asnjë revokim për subjektet minerare, në fondin pyjor.*

Zotëruesi i lejes minerare, gjatë periudhës së vlefshmërisë, ka detyrime të paraqesë çdo vit për shqyrtim pranë strukturës përgjegjëse një plan pune vjetor, të hartuar në përputhje dhe të harmonizuar në kohë me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në lejen e tij minerare.⁶⁹

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion grupit të auditimit rezultoi se: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore për periudhën objekt auditimi, ka propozuar tek Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, revokim të lejes minerare për 33 subjekte (në rang vendi), për shkeljet si: subjektet kanë ndërprerë aktivitetin prej 1 viti, subjektet nuk kanë miratuar planin e punës, subjektet nuk kanë zhvilluar aktivitet prej më shumë se 180 ditë, etj. Nga këto, 4 subjekte operojnë në bashkitë që janë objekt auditimi: 1 subjekt në bashkinë Skrapar, 2 subjekte në bashkinë Selenicë dhe 1 subjekt në bashkinë Krujë:



⁶⁹ Ligji “ Për sektorin minerar”, neni 18, pika ç.

| Nr. | Subjekti | Minerali | Bashkia | Leja minerare | Propozimi i AKBN-së | Arsyeja |
|-----|-------------|------------------|----------|----------------------------|----------------------------------|---|
| 1. | M. V.A. | Gëlq.mermerizuar | Skrapar | Nr.1784, datë 19.11.2015 | Nr. 4421 prot., datë 06.12.2021 | Për ndërprerje të aktivitetit. |
| 2. | B.M.I.sh. | Rërë Bituminoze | Selenicë | Nr.1496/3, datë 20.11.2014 | Nr.4715 prot, datë 14.11.2022 | Nuk ka zhvilluar aktivitet për më shumë se 180 ditë |
| 3. | B. M. I.sh. | Rërë Bituminoze | Selenicë | Nr.1496/2, datë 10.07.2013 | Nr.2672/2 prot., datë 21.11.2022 | Nuk është paguar garancia e rehabilitimit + nuk ka zhvilluar aktivitet për më shumë se 180 ditë |
| 4. | D. G. sh. | Gur Gëlqeror | Krujë | Nr. 794/1, datë 20.08.2004 | Nr.3368 prot., datë 17.07.2023 | Ka punuar jashtë projekt-programit |

Burimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore. Përpunoi: Grupi i Auditimit.

Për sa i përket subjekteve minerare në fondin pyjor (në bashkitë që janë objekt auditimi) nuk është propozuar asnjë subjekt për revokim.

Nga grupi i auditimit është identifikuar 1 rast që në raportin e monitorimit të mbajtur nga AKBN-ja është përshkruar se subjekti minerar nuk ka miratuar planet e punës dhe për këtë subjekt, AKBN-ja nuk ka kërkuar revokim të lejes minerare.⁷⁰

8. Gjetje nga auditimi: Në Bashkitë e audituara është konstatuar se: strukturat përgjegjëse për pyjet në bashkitë Dimal, Berat, Krujë, Selenicë, Skrapar nuk kanë kryer inspektime për zbatimin e kushteve të lejeve/licencave, në subjektet minerare që operojnë në fondin pyjor; Bashkitë Krujë, Dimal dhe Berat nuk kanë krijuar ende strukturë përgjegjëse për pyjet; në bashkinë e Selenicës dhe Skraparit, personat e emëruar në strukturën inspektuese nuk janë me profilin e duhur arsimor. Po ashtu, nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk janë kryer inspektime në mënyrë periodike në aktivitetet minerare në fondin pyjor, për sa i përket zbatimit të kushteve të lejes minerare dhe të lejes mjedisore.

9. Gjetje nga auditimi: Subjektet që kryejnë veprimtari minerare në fondin pyjor zotërojnë leje mjedisi “Tipi A/B”, në kushtet e së cilës përcaktohet edhe dorëzimi dy herë në vit i raporteve të vet monitorimit të Lejes Mjedisore. Grupi i auditimit ka konstatuar se për periudhën 2021-2023 nuk kanë dorëzuar, raportet e vetmonitorimit 7 subjekte minerare, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, sipas përcaktimeve të kuadrit rregullator.

- Nga auditimi në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore rezultoi se, 6 nga zotëruesit e lejes minerare në fondin pyjor (grupi i auditimit ka përzgjedhur 31 subjekte) nuk kanë paraqitur një informacion çdo 3 muaj, mbi realizimin e prodhimit, investimeve, vlerën e produkteve të shitura, punimeve minerare të realizuara dhe gjithë operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare.

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se edhe pse është hartuar një Udhëzim i përbashkët mes dy Ministrive të Infrastrukturës (MIE) dhe Mjedisit (MTM), në lidhje me kontrollin e planeve të rehabilitimit në subjektet minerare, mungon bashkëpunimi i strukturave të varësisë për zbatimin e tij.

-Po kështu, vërehet një mungesë bashkëpunimi mes Agjencisë Kombëtare të Pyjeve dhe strukturave përgjegjëse për pyjet në bashki, për kontrollin dhe monitorimin e subjekteve minerare që operojnë në fondin pyjor.

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i raporteve të monitorimit të mbajtura nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore rezultoi se: raportet e monitorimit nuk japin informacion të plotë mbi respektimin e realizimit të projektit minerar, realizimin e operacioneve e të punimeve minerare dhe depozitimin e mbetjeve minerare, lëvizjen e rezervave minerare, kryerjen e operacioneve minerare, respektimin e standardeve të sigurisë në punë e të mbrojtjes së shëndetit të punonjësve. Nga grupi i auditimit janë identifikuar 8 raste të raporteve të monitorimit, ku grupi i punës së AKBN-së nuk është shprehur në lidhje me rehabilitimin e mjedisit.

⁷⁰ Raporti i monitorimit në muajin Shtator 2021, në subjektin “S.”, sh.p.k, me vendndodhje në Dimal.

-Po ashtu, procedura e inspektimit e ndjekur nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit paraqet problematika si :13 subjekte minerare në fondin pyjor nuk janë inspektuar asnjëherë gjatë periudhës 2021-2023; lista e verifikimit për zbatimin e kushteve të lejes mjedisore, e mbajtur nga trupa inspektuese, nuk është plotësuar në mënyrë të detajuar, përsa i përket miratimit të planeve të rehabilitimit të mjedisit. Në sistemin “e -Inspektimit,” nuk janë bashkëlidhur planet e rehabilitimit të mjedisit (për subjektet përkatës), ndërsa vendimet përfundimtare për këto subjekte nuk kanë dalë me masë administrative, për mungesë dokumentacioni.

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore në rang vendi janë propozuar për revokim 33 leje minerare, për shkeljet ligjore si: ndërprerja e aktivitetit prej 1 viti dhe mosmiratimi i planit të punës nga subjektet që kanë leje minerare. Në asnjë rast nuk ka propozuar për revokim veprimtari minerare në fondin pyjor, edhe pse janë konstatuar subjekte me mungesë dokumentacioni.

8. Konkluzione: Subjektet minerare që operojnë në fondin pyjor nuk janë të inspektuara nga strukturat përgjegjëse, si dhe nuk dorëzojnë në mënyrë periodike raportet për zbatimin e kushteve të lejes minerare dhe mjedisore.

8.1. Rekomandim: Bashkitë Dimal, Berat, Krujë, Selenicë, Skrapar të marrin masa: Të emërojnë punonjës që plotësojnë kriteret e profesionalizmit, në strukturën përgjegjëse për pyje; për të inspektuar subjektet minerare që operojnë në fondin pyjor në lidhje me zbatimin e kushteve të licencave/lejeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, gjatë inspektimeve në mënyrë periodike, të marrin masa administrative për të gjithë subjektet minerare, të cilët nuk respektojnë zbatimin e të gjitha kushteve të lejes mjedisore dhe lejes minerare.

Menjëherë dhe në vijimësi

10.1. Rekomandim: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të ushtrojnë përgjegjësitë, sipas përcaktimeve ligjore për kontrollin administrativ të veprimtarive të strukturave të varësisë, si dhe nxjerrjen e përgjegjësive në rastet e moszbatimit nga ana e tyre, të akteve administrative në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

11.1. Rekomandim: Drejtoria e Monitorimit në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe Drejtoria e Inspektim-Kontrollit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, të marrin masa që raportet e monitorimit/listat e verifikimit, të mbajtura në subjektet minerare, të përmbajnë të gjithë elementët e nevojshëm, sipas kuadrit rregullator.

Menjëherë dhe në vijimësi

12.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore të marrë masa që subjektet që nuk kanë të miratuar planet vjetore të punës, të kërkojë pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, revokim të lejes minerare.

Deri në 30.06.2025

4.3.2. A është siguruar ndjekja e kryerjes së rehabilitimit dhe ripyllëzimit të fondit pyjor, nga ndikimi i aktivitetit minerar?

Mos përmbushja e detyrimit për rehabilitimit mjedisor nga subjektet të pajisur me leje kërkimi/shfrytëzimi.

Institucionet përgjegjëse nuk kanë ndërmarrë masat e përcaktuara ligjore për rehabilitimin e mjedisit nga subjektet të pajisur me leje minerare me ndikimin të aktivitetit minerar në fondin

pyjor, efektiviteti i tyre shpesh vihet në pikëpyetje edhe për shkak të sfidave institucionale dhe financiare.

Legjislacioni ka përcaktuar mënyrën dhe format për rehabilitimin e mjedisit nga veprimtaria minerare e kërkim/shfrytëzimit, gjithashtu është parashikuar një zgjidhje për rastet kur kompanitë braktisin zonën e lejes minerare, pa e kryer rehabilitimin mjedisor. Në këto raste, rehabilitimi duhet të kryhet nga AKBN dhe shpenzimet përballohen nga fondet e garancisë financiare që kompanitë kanë depozituar në thesarin e shtetit gjatë periudhës së aplikimit për leje minerare.

Mbrojtja dhe zhvillimi i qëndrueshëm i fondit pyjor kombëtarë aktualisht rregullohet nga Ligji nr.57 datë 30.04.2020 “Për pyjet”. Në zbatim të tij, ka dalë VKM nr. 888, datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre” për c ‘fuqizim të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, e ndryshuar Për ruajtjen dhe mos zvogëlimin e fondit pyjor si dhe garantimin e zëvendësimit të tij në ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”, përcaktohen kriteret për rastet e lejuara nga ligji të ndryshimit të sipërfaqeve në fondin pyjor kombëtar:

- a) miratimin e Ministrit të MTM për sipërfaqe deri në 1 ha;
- b) vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe mbi 1 ha deri në 10 ha;
- c) ligj të veçantë për sipërfaqe mbi 10 ha.⁷¹

Pasi subjekteve i miratohet heqja nga sipërfaqja e fondit pyjor me anë të një prej tre formave cituar më sipër, subjektet janë të detyruar të paguajnë kostot e përlllogaritura për pyllëzimin kompensues përkatës.

Pra, çdo subjekti të cilit i miratohet heqja nga fondi pyjor të sipërfaqes ku do të ushtrojë aktivitetin minerar duhet që të marrë masa për të garantuar zëvendësimin e kësaj sipërfaqeje pyjore në të cilën do të zhvillojë aktivitetin minerar.

Pas miratimit për ndryshimet (heqjen) në sipërfaqen e fondit pyjor, ndryshimet duhet të pasqyrohen në Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor (RKFP), që ngrihet dhe mirëmbahet nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve, në të cilin pasqyrohet tërësia e informacioneve kadastrale të nevojshme dhe e ndryshimeve periodike për çdo njësi të fondit pyjor kombëtar.

Në rastin e lejeve minerare të kërkim/shfrytëzimit nga subjektet me aktivitet minerar në ligjin minerar përcaktohet detyrimet e zotëruesit të lejes së kërkim-zbulimit dhe detyrimet e zotëruesit të lejes së shfrytëzimit si: Të paraqesë pranë strukturës përgjegjëse çdo 6 muaj kalendarikë, jo më vonë se data 15 e muajit që vijon pas gjashtëmuajorit përkatës kalendarik, një informacion mbi realizimin e prodhimit, investimeve, vlerën e produkteve të shitura, punimeve minerare të realizuara dhe gjithë operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare, në përputhje me detyrimet e tij të lejes minerare dhe planin vjetor;⁷²

Në konkurrimin për marrjen e lejes minerare janë të përcaktuara kushtet e përfitimit të lejeve minerare: d) paraqesin një plan rehabilitimi të mjedisit për lejet e kërkim-zbulimit e të shfrytëzimit, në përputhje me rregullat e mbrojtjes së mjedisit, të miratuara sipas legjislacionit në fuqi dhe me rregullat teknike minerare⁷³;


U konstatua se rehabilitim mjedisor është një proces që nuk zhvillohet sipas kushteve kontraktore të lejeve minerare që ndikojnë në fondin pyjor. Nga 87 leje minerare aktive për periudhën nga viti 2021 deri në 2023 në Bashkitë Selenicë, Skrapar, Krujë, Dimal dhe Berat kemi kryerjen e rehabilitimit mjedisor vetëm nga 4 subjekte konkretisht në Bashkinë Kruje 3 subjekte; dhe 1 subjekt rehabilitim pjesor në Bashkinë Çorovodë, ose janë rehabilituar vetëm 145.5 ha nga sipërfaqja e dhënë për aktivitet minerar prej 3604.58 ha që zë 4% e shpërfaqjes se dhenë për shfrytëzim.

⁷¹ Përcaktuar në nenin 5 të ligjit 57/2020


⁷² Nenet 13 dhe 25 të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

⁷³ ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 (shfuqizuar shkronja “ë” e pikës 1 me ligjin nr. 134/2014, datë 9.10.2014, ndryshuar fjalë e parë e pikës 1, shtuar fjalë në fund të shkronjës “c” dhe hequr referenca “ë” me ligjin nr. 65/2021, datë 20.5.2021)

Kryerja e rehabilitimit nga Subjekte minerare me ndikim në fondin pyjor Për periudhën 2021-2023



Raporti i Siperfaqes së dhënë për aktivitet minerar në fondin pyjor me sipërfaqen e rehabilituar në ha



Në zbatim të Urdhrit nr. 18, datë 24.08.2022, nga AKBN vetëm në 2 raste, është kryer inspektim i përbashkët me AKM, për Planin e Mbylljes dhe Rehabilitimit të Mjedisit në lejen minerare të kërkimit/shfrytëzimit, me kërkesë të vetë subjekteve pas rehabilitimit të zonës minerare. Inspektimi është kryer me grup të përbashkët AKBN-AKM. Rehabilitimi i kryer nga subjektet nuk u pranua nga grupet e punës të AKM dhe AKBN pasi nuk ishte bërë i plotë, është lënë detyrë të plotësojë dhe të bëjë kërkesë përsëri për verifikim në terren.

Legjislacioni në fuqi përcakton se përlllogaritjen të vlerave të garancive financiare të lejeve minerare të kërkim/shfrytëzimit (ku përfshihet edhe garancia financiare për rehabilitimin e mjedisit) kryhen nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar për lejet minerare të kërkim-zbulimit dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore për lejet minerar të shfrytëzimit referuar kjo në nenin 31 “Garancitë financiare për zhvillimin e veprimtarive minerare”, nenit 43 të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”; VKM nr. 440, datë 16.06.2011 “Për miratimin e formës të kushteve të rikthimit dhe mënyrës së llogaritjes, së garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit, për realizimin e programit minimal të punës dhe për realizimin e investimit” dhe në përputhje e zbatim të Udhëzimit nr. 718, datë 03.10.2011 “Për mënyrën e vlerësimit të garancive financiare të lejeve minerare”.

Me shpalljen zonës Krastë-Verjon në Bashkinë e Krujës “Peizazh i mbrojtur” sipas VKM nr. 468, datë 26.07.2018, në një sipërfaqe 1469.239 ha, nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës

janë revokuar 21 leje minerare shfrytëzimi, pasi u gjetën në shkelje të kushteve teknike të lejeve. Sipas Udhëzimit nr. 718, datë 03.10.2011 janë depozituar vlerat e garancisë sipas tabelës së më poshtë:

Tabela Garancitë e rehabilitimit për lejet e revokuara te Krujës

| Nr. i Lejes | Data fillestare | SUBJEKTI | Rrethi | Minerali | Garancia rehabilitimit |
|---------------|-----------------|--------------|--------|----------------|------------------------|
| 597/1 | 01.11.2011 | S. SHPK | Kruje | Gur gelqeror | 926,065 |
| 666/1 | 19.03.2012 | M.SHPK | Kruje | Gur gelqeror | 572,030 |
| 695/1 | 26.02.2003 | G . K. | Kruje | Gur gelqeror | 769,173 |
| 708 | 08.07.2003 | K. SHPK | Kruje | Gur gelqeror | |
| 756 | 16.03.2004 | Y. SHPK | Kruje | Gur gelqeror | 1,308,586 |
| 764/1 | 20.10.2014 | A.SHPK | Kruje | Argjilë | 219,009 |
| 874/1 | 27.05.2015 | P. SHPK | Kruje | Gur gelqeror | 552,300 |
| 894/1 | 12.02.2016 | L., SHPK | Kruje | Gur gelqeror | 255,205 |
| 899 | 08.08.2005 | B. SHPK | Kruje | Gur gelqeror | 140,389 |
| 900/1 | 08.08.2005 | K. D. SH.P.K | Kruje | Gur gelqeror | 183,599 |
| 926/1 | 19.01.2006 | L. T. | Kruje | Gur gelqeror | 806,864 |
| 936/1 | 17.04.2006 | K. SHPK | Kruje | Gur gelqeror | 560,769 |
| 971/1 | 05.09.2006 | V. SH.P.K | Kruje | Gur gelqeror | 1,408,468 |
| 1166 | 19.03.2008 | B. SHPK | Kruje | Gur gelqeror | 723,590 |
| 1330 | 17.03.2009 | A. SHPK | Kruje | Gur gelqeror | 322,750 |
| 1341 | 11.05.2009 | XH. SHPK | Kruje | Gur gelqeror | 1,455,112 |
| 1343 | 11.05.2009 | S. SHPK | Kruje | Gur gelqeror | 4,085,995 |
| 1439 | 01.10.2009 | D.SHPK | Kruje | Brekçie shpati | 225,926 |
| 1612/1 | 31.01.2013 | B. C. SHPK | Kruje | Gur gelqeror | 2,660,346 |
| 1756 | 21.05.2015 | F. –K. C. A. | Kruje | Gur gelqeror | 2,057,854 |
| 1775 | 03.11.2015 | M. | Kruje | Gur Gelqeror | 361,160 |
| Totali | | | | | 19,595,190 |

Për të përmbushur planin e rehabilitimi për zonat e prekura nga aktiviteti minerar, brenda zonës së mbrojtur Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore sipas dokumentacionit që disponon dhe korrespondencën me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës relaton se fondi i krijuar nga depozitimi i garancive prej 19,595,190 lekë nuk mund të përballojë rehabilitimin e sipërfaqeve sipas lejeve minerare të revokuara. AKBN ka kërkuar nga MTM bashkëpunim për ngritjen e grupit të përbashkëte punës për hartimin e termave të referencës për rehabilitimin e zonës “Krastë-Verjon” Bashkia Krujë.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit drejtuar AKBN me nr. 5586/5, datë 28.10.2024 “Mbi rehabilitimin e zonës Krastë-Verjon” përcjell mendimin dhe dokumentacionin teknik për rehabilitimin e kësaj zone.

Në bazë të termave të referencës dhe Udhëzimit nr. 5 datë 30.07.2024 2011 “Për mënyrën e vlerësimit të garancive financiare të lejeve minerare”, AKBN i ka llogaritur kostot e rehabilitimit bazuar mbi sipërfaqet e shfrytëzuara dhe gjendja aktuale e sipërfaqeve të shfrytëzuara.

Vlera për rehabilitimin e zonës së Krujës e dërguar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është 49,551,656 lekë, për sa më lart rehabilitimi mjedisor në zonën e mbrojtur Krastë- Verjon konsiderohet i vështirë dhe aktualisht nuk ka asnjë masë a plan konkret për rehabilitimin.

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të administruar në Bashkitë Krujë, Selenicë, Skrapar, Berat, Dimal si dhe nga vizitat në terren u konstatua se, nuk ka rehabilitim mjedisor në proces konkretisht: Janë rehabilituar vetëm 145.5 ha nga sipërfaqja e dhënë për aktivitet minerar prej 3604.58 ha ose kanë kryer rehabilitim 4 subjekte përkatësisht në Bashkinë Krujë 3 subjekte; dhe 1 subjekt rehabilitim pjesor në Bashkinë Çorovodë, nga 87 leje minerare aktive për periudhën nën auditim vitet 2021-2023⁷⁴.

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të administruar në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore si dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit u konstatua se vlera për rehabilitimin e zonës së mbrojtur Krastë-Verjon e dërguar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

⁷⁴ Udhëzimit nr. 5 datë 30.07.2024 2011 “Për mënyrën e vlerësimit të garancive financiare të lejeve minerare”,

është përcaktuar prej 49,551,656 lekë. Ndërkohë për rehabilitimin e sipërfaqeve të shfrytëzuara sipas lejeve të revokuara në zonën e mbrojtur Krastë-Verjon fond financiar i depozituar nga 21 subjekte është prej 19,595,190 lekë. Diferenca prej 29, 956,466 lekë që përbën vlerën e nevojshme për të kryer rehabilitimin e zonës së mbrojtur Krastë-Verjon është llogaritur në bazë të termave të referencës dhe Udhëzimit nr. 5 datë 30.07.2024 2011 (nr.718, datë 03.10.2011) “Për mënyrën e vlerësimit të garancive financiare të lejeve minerare”.

9. Konkluzioni: Mos përmbushja e detyrimit për rehabilitimit mjedisor nga subjektet të pajisur me leje kërkimi/shfrytëzimi ka sjellë dëme të pa riparueshme në mjedis.

13.1. Rekomandim: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Pyjeve, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe Bashkitë Krujë, Selenicë, Skrapar, Berat, Dimal në bashkëpunim, të marrin masa për rillogaritjen me vlerat e reja të rritura të garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit nga subjektet me aktivitet minerar që ndikojnë në fondin pyjor dhe arkëtimin e tyre si dhe të ndjekë realizimin e planit të rehabilitimit të mjedisit prej tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

14.1. Rekomandim: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të marrin masa për rehabilitimin e sipërfaqeve të shfrytëzimit të 21 lejeve minerare të revokuara në zonën e mbrojtur Krastë-Verjon.

Deri në 30.06.2025

Bashkitë Dimal, Berat, Çorovodë, Selenicë dhe Krujë nuk disponojnë kontrata mbi marrjen e detyrimit të përcaktuar për pyllëzimin, ripyllëzimin apo përmirësimin e fondit pyjor të hequr si pasojë e aktivitetit minerar.

Në zbatim të nenit 5, të ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”, ka dalë VKM nr. 537, datë 22.9.2021 “Për përcaktimin e kostove të përlllogaritura për pyllëzim kompensues, në rastet e ndryshimit të destinacionit të fondit pyjor” që përcakton:

-në pikën 1 *Subjektet përfituese, për të cilat është miratuar ndryshimi i destinacionit të fondit pyjor kombëtar, paguajnë paraprakisht kostot e përlllogaritura për pyllëzimin kompensues përkatës, si rezultat i ndryshimit të destinacionit të përdorimit të fondit pyjor, të lejuara nga ligji.*

-në pikën 3. Përlllogaritja e kostove për sipërfaqet zëvendësuese ose kompensuese të rehabilitimit të fondit pyjor bëhet mbi bazën e:

a) trefshit të sipërfaqes që hiqet nga fondi pyjor, për pyjet me formë qeverimi trungishte dhe cungishte;

b) barazimit me sipërfaqen që hiqet nga fondi pyjor, për pyjet me formë qeverimi shkurre, si dhe për sipërfaqet me bimësi pyjore⁷⁵.


Për periudhën e viteve 2021 - 2023 në territoret që administrojnë Bashkitë Selenicë, Skrapar, Krujë, Dimal dhe Berat, ushtrojnë aktivitet minerar 87 subjekte me leje minerare aktive që ndikojnë në fondin pyjor në një sipërfaqe totale prej 3604.58 ha⁷⁶ (për 31 subjekte prej tyre Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk disponon të dhëna apo kërkesa për heqje nga fondi pyjor, si dhe nuk ka një rakordim të dhënash midis MTM, MIE, AKBN, dhe Bashkive për ndikimin në fond pyjor të lejeve minerare). Kanë miratimin me aktet ligjore (Urdhër Ministri, VKM apo Ligj) që vendos për heqjen e sipërfaqeve pyjore, vetëm 7 subjekte prej tyre, për sipërfaqen 395.07 ha.

⁷⁵ Urdhër i Ministrit Mjedisit me nr. 1937, date 21.10.2014 “Mbi përcaktimin e detyrimit të subjekteve për të zëvendësuar sipërfaqet pyjore dhe përmirësuar sipërfaqet kullimore që hiqen nga fondi pyjor dhe fondi kulloror nëpërmjet pyllëzimit, ripyllëzimit dhe përmirësimin e tyre”

⁷⁶ Sipas informacioneve zyrtare me e-mail nga AKBN dhe MTM

Në të gjitha rastet e lejeve aktive pranë Bashkive Selenicë, Skrapar, Krujë, Dimal dhe Berat nuk ka dokumentacion mbi marrjen e detyrimit të përcaktuar për pyllëzimin, ripyllëzimin apo përmirësimin e fondit pyjor të hequr si pasoje e aktivitetit mineral.

Nga dokumentacioni i administruar në Bashkitë Selenicë, Skrapar, Krujë, Dimal dhe Berat si dhe nga vizitat në teren u konstatua se, vetëm në 1 rast kemi pyllëzim kompensues në Bashkinë Dimal në një sipërfaqe prej 16.2 ha që korrespondon me lejen minerare nr. 1632, 10.06.2013 të subjektit "S." Sh.p.k për shfrytëzim në sipërfaqe prej 16.2 ha.



15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të depozituar në Bashkitë Dimal, Berat, Çorovodë, Selenicë dhe Krujë për subjektet të pajisur me leje minerare që ndikojnë në fondin pyjor u konstatua se:

- Nga 87 subjekte me leje minerare aktive që ndikojnë në fondin pyjor në një sipërfaqe totale prej 3604.58 ha, vetëm 7 subjekte për sipërfaqen 395.07 ha kanë miratimin me aktet ligjore (Urdhër Ministri, VKM apo Ligj).

- Nuk ka rakordim të dhënash midis Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës, Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe Bashkive për ndikimin në fond pyjor të lejeve minerare.

- Në asnjë rast nuk ka kontrata mbi marrjen e detyrimit të përcaktuar për pyllëzimin, ripyllëzimin apo përmirësimin e fondit pyjor të hequr si pasoje e aktivitetit mineral, si dhe nuk ka punime për zbatimin e detyrimit të përcaktuar në aktet ligjore (Urdhër Ministri, VKM apo Ligj) që vendos për heqjen e sipërfaqeve pyjore.

10.Konkluzioni: Konstatohet një ndikim i pa kthyeshëm në mjedis dhe fondin pyjor nga mos kryerja e ripyllëzimit apo përmirësimin e fondit pyjor të hequr si pasoje e aktivitetit mineral si dhe mos kryerja e punimeve kompensuese

15.1. Rekomandim: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Agjencia Kombëtare të Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Pyjeve në bashkëpunim edhe me Bashkitë Krujë, Selenicë, Skrapar, Berat, Dimal, të marrin masa për evidentimin dhe përcaktimin e saktë të sipërfaqeve të fondit pyjor që ndikohen nga lejet minerare aktive për të mundësuar lidhjen e kontratave, ndjekjen e

punimeve kontraktore për pyllëzimin, ripyllëzimin apo përmirësimin e fondit pyjor të hequr si pasojë e aktivitetit minerar nga subjektet që operojnë në territorin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. TRAJTIMI I OBSERVACIONEVE

-Për sa trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit janë paraqitur observacione nga **Agjencia Kombëtare e Pyjeve** me nr. 983 prot., datë 30.12.2024, administruar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me nr.771/22 prot., datë 31.12.2024.

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me Gjetjen, nr. 1, të projekt raportit nëpërmjet observacioneve Agjencia Kombëtare e Pyjeve ka paraqitur pretendimet e saj në lidhje me gjetjet e auditimit si më poshtë vijojnë: Treguesit që monitorohen gjatë vitit pasardhës nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve miratohen në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, pavarësisht treguesve për monitorim të kërkuar nga AKP.

Për të dhënat e treguesve të fondit pyjor që mungojnë sipas gjetjeve të auditimit sqarojmë se: llojet drusore të rrezikuara janë dhënë në RGJM e viteve 2021-2023; të dhëna për hotspote nuk janë planifikuar në PKMM, sipërfaqet e dëmtuara nga faktorë të tjerë atmosferikë si dëbora, furtuna etj (ato përmenden në PKMM si indikatorë por nuk hartohen projekte monitorimi me të tretë për tu zbatuar gjatë vitit, arsyeja mungesa e fondeve).

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në observacionet e sjella nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve nuk janë bashkëngjitur dokumente justifikues. Për sa më sipër pretendimi nuk pranohet, sipas shpjegimit dhënë më sipër.

-Për sa trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit janë paraqitur observacione nga **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit** me nr. 120/1 Prot. datë 07.01.2025, administruar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me nr.771/23 Prot. datë 08.01.2025.

Pretendimet e subjektit:

Subjekti në lidhje me “Gjetjet nga auditimi” të projekt raportit nëpërmjet observacioneve MTM ka paraqitur pretendimet e saj në lidhje me gjetjet e auditimit si më poshtë vijojnë :

Mbi, **Gjetjen, Pika 2, faqe 26 shpjegimi:**

Ju informojmë se, DPP është monitoruar dhe të dhënat janë në raportin e AKP, vënë në dispozicion nga Sektori i Pyjeve dhe Kullotave, “Raport mbi vlerësimin e performancës dhe aktiviteteve menaxhuese dhe kontrolluese në sektorin e pyjeve nga strukturat apërgjegjëse prane nj.q.v. (bashkive).

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Përsa më sipër, lidhur me observacionet e subjektit ju sqarojmë se Dokumenti i Politikave të Pyjeve në referencë të legjislacionit për pyjet është plani i nivelit më të lartë strategjik, që lidh qëllimin dhe vizionin e qeverisjes me masat dhe aktivitetet konkrete për realizimin e tyre. DPP-ja shërben si bazë për hartimin e strategjive dhe programeve të zhvillimit, hartimin dhe zbatimin e rregullave, orientimin e buxheteve, ngritjen dhe përmirësimin e institucioneve përgjegjëse. DPP-ja miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit. Monitorimi dhe kontrolli i zbatimit të DPP-së dhe PKP-së bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe ciklike nga strukturat përgjegjëse sipas këtij ligji, duke bërë vlerësimin e ecurisë dhe ndryshimin e tyre çdo 3 vjet dhe rishikimin tërësor çdo 10 vjet. Të gjitha institucionet apo autoritetet e tjera publike, veprimtaria e të cilave lidhet apo ndikon në fondin pyjor kombëtar, detyrohen që përpara miratimit të nismave apo akteve planifikuese të sektorëve që mbulojnë të bashkërendojnë dhe të konsultohen. Për arsyet e mësipërme observacioni juaj nuk merret parasysh dhe do të trajtohet në raportin e auditimit.

Mbi Gjetjen e pikës 3, faqe 31 *shpjegimi:*

Lidhur me këtë gjetje, ju informojmë se, AKP është krijuar në vitin 2019 dhe jo në vitin 2014. Gjithashtu, AKP ka dërguar shkresë për marrjen e informacionit kadastral në datë 23.12.2020 dhe në vijim të kësaj kërkesë, në takimet e bërë me përgjegjësën e sektorit të Inventarizim Kadastrës dhe Drejtorin e Përgjithshëm të AKP, i kemi informuar se, për marrjen e këtij informacioni digjital, kërkohet një hard disk i jashtëm duke patur parasysh madhësinë e informacionit i cili, përveç database në access, përmbante edhe hartografinë e vjetër të pa digjitalizuar. Nëpërmjet Projektit të Shërbimeve Mjedisore u përgatit konsulencia për ngritjen e Sistemit Shqiptar të Informacionit në Pyje (ALFIS) i cili është përfunduar në muajin Maj 2021.

Për të ngritur këtë sistem, fillimisht konsulenti prodhoi D., si një element që sillte të tërë informacionin arkivë të kadastrës në një program i cili mund të inkorporohej në ALFIS. D. ka në përbërjen e tij të gjithë informacionin e vjetër kadastral si dhe hartografinë e digjitalizuar. Çertifikimi i D. është bërë nga komisioni prej tre vetësh, pjesë e të cilit është edhe Drejtori i AKP i asaj kohe. Në përfundim të konsulencës së ALFIS, është bërë trajnimi i stafit të bashkive në qershor 2021, ku pjesë e këtij trajnimi kanë qënë përfaqësuesit e AKP. Për më tepër, ndjekja e këtij trajnimi është bërë vetëm nga AKP dhe jo nga Sektori i Pyjeve dhe Kullotave në MTM. Gjithsesi, hard disk-u me informacionin për të dhënat e kadastrës arkivë dhe hartografinë është përcjellë tek AKP në rrugë zyrtare në datë 28.07.2021.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Përsa më sipër, lidhur me observacionet e subjektit ju sqarojmë se grupi i auditimit është shprehur qartë mbi faktet që mungesa e infrastrukturës dhe mosfunksionimi i sistemit të integruar të informacionit (ALFIS) ka bërë që mos të vijohej me procesin e inventarizimit të pyjeve i cili duhet të ishte përfunduar në vitin 2014. Ky proces ka nisur në vitin 2018 dhe ka përfunduar në vitin 2021. Deri në tetor 2022, nuk ka pasur publikim të të dhënave të inventarizimit. Për shkak të mungesës së fondeve, procesi pasardhës i inventarizimit të pyjeve (25% e fondit pyjor), i cili duhet të kryhej në vitin 2023, nuk ka nisur ende. Regjistri Kombëtar i Fondit Pyjor (RKFP)⁷⁷ dhe Sistemi i integruar i informacionit për pyjet (ALFIS) nuk funksionojnë. Aktualisht nuk ka kadastrë pyjesh funksionale dhe me informacion te plotë dhe te përditësuar. Për arsyet e mësipërme observacioni juaj nuk merret parasysh dhe do të trajtohet në raportin e auditimit.

Mbi Gjetjen Pika 4, faqe 32, shpjegimi:

Si detyrë e AKP, në Raportin mbi vlerësimin e performancës dhe aktiviteteve menaxhuese dhe kontrolluese në sektorin e pyjeve nga strukturat përgjegjëse prane nj.q.v, janë dhënë gjetjet e monitorimit të AKP për këto struktura si dhe orientime për mënyrën e organizimit të këtyre strukturave. Për më tepër, edhe në ligjin nr. 57/2020 “Për Pyjet” është e përcaktuar numri dhe struktura si dhe detyrat që duhet të plotësojë struktura e menaxhimit të pyjeve në bashki.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Përsa më sipër, lidhur me observacionet e subjektit ju sqarojmë se:

Në disa nga njësitë e vetëqeverisjes vendore objekt auditimi në strukturat përgjegjëse për pyjet vërehet se njësia përgjegjëse e pyjeve i bashkëlidhet sektorëve të bujqësisë, mjedisit, ujërave, baseneve etj, nuk ka një orientim dhe organizim të qartë. *Pothuajse në të gjitha bashkitë strukturat menaxhuese dhe kontrollues/inspektuese janë brenda një sektori duke sjellë paqartësi të ndarjes së kompetencave menaxhuese dhe kontrolluese që rrjedhin nga ligji 57/2020 “Për pyjet”.* Paqartësia e kompetencave dhe mungesa e një sistemi të integruar nga Ministria përgjegjëse deri tek përdoruesi në pyje e bën të paqëndrueshëm dhe të paqartë rolin e strukturave inspektuese për pyjet në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, në raport me mbrojtjen e fondit pyjor. Për arsyet e mësipërme observacioni juaj nuk merret parasysh dhe do të trajtohet në raportin e auditimit.

Mbi Gjetjen Pika 6, faqe 33, shpjegimi: Ju informojmë se, për periudhën nën auditim, MTM (Drejtoria e Natyrës dhe Pyjeve, Sektori i Pyjeve dhe Kullotave), ka shqyrtuar të gjitha kërkesat e ardhura nga subjektet për shfrytëzimin minerar dhe statusin e tyre dhe ju ka informuar sipas tabelës të kërkuar).

⁷⁷ Pika 1, neni 6, e Ligjit nr. 57/2020, datë 30.4.2020 “Për Pyjet”

Për 18 subjektet të cilat kanë dokumentacion të plotë, janë në fazë draftimi dhe shqyrtimi nga strukturat e ministrisë e lidhur kjo edhe me ndryshimet ligjore të fundit, emërtesat etj.

Për 7 subjekte është miratuar heqja nga fondi pyjor dhe për 30 subjekte, procedurat janë në vijim ose për plotësim dokumentacioni ose në procedura me bashkitë përkatëse për hartimin e raportit tekniko-ekonomik si dhe vendimin e këshillit bashkiak për dhënien e dakortësisë për heqjen nga fondi pyjor. Gjithashtu, duke mbajtur në konsideratë përcaktimet sipas pikës 1, neni 12, të ligjit 57/2020, “Për pyjet”, “.....për shkak të vlerës dhe rëndësisë, pyjet janë pasuri kombëtare dhe trajtohen si të tilla. Funkzioni i pyjeve si një e mirë publike prevalon mbi çdo interes tjetër të çdo subjekti dhe garantohet me vendosjen e kufizimeve përkatëse. Institucionet shtetërore garantojnë trajtimin prioritar të pyjeve sipas statusit të tyre “pasuri kombëtare” dhe interesit publik që ato përmbushin”, miratimi i heqjes nga fondi pyjor lidhet edhe me faktin që deri tani nuk është kryer asnjë lloj rehabilitimi. Rehabilitimi si detyrim i lejeve të shfrytëzimit minerar, nuk është i lidhur me detyrimin e pyllëzimit kompensues si rezultat i heqjes nga fondi pyjor dhe duhet të ishte kryer në mënyrë periodike sipas planit të rehabilitimit të miratuar i cili është kusht për miratimin e lejes së shfrytëzimit minerar.

Heqja nga fondi pyjor dhe detyrimi i pyllëzimit kompensues nuk është kusht i realizimit të planit të rehabilitimit. Realizimi i planit të rehabilitimit është një nga kushtet për revokimin e lejes së shfrytëzimit. Në ligjin minerar, në nenin 47 pika 1/b, e cila citon rastet e revokimit, nuk përmendet që një nga kushtet është heqja nga fondi pyjor, gjithashtu, në asnjë nga nenet e ligjit minerar nuk ka të cituar kur hyn në fuqi leja minerare dhe që pas kësaj dite llogaritet 180 ditëshi për revokimin. Pra si përfundim, miratimi i heqjes nga fondi pyjor nuk është i lidhur me revokimin e lejes minerare.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Përsa më sipër, lidhur me observacionet e subjektit ju sqarojmë se grupi i auditimit është shprehur qartë mbi mungesën e koherencës dhe paqartësinë e kompetencave në aktet rregullatorë midis MTM, AKP, MIE, AKBN dhe Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të cilat sjellin për rrjedhojë menaxhim të dobët të ekonomive pyjore nga sektorët e pyjeve dhe monitorim të dobët të ndikimit të aktivitetit minerar në fondin pyjor. Nga aktorët pjesëmarrës për unifikimin e procesit të ruajtjes së fondit pyjor nga ndikimi i aktivitetit minerar, nuk ka pasur as grupe pune të përbashkëta apo tryeza diskutimesh duke përcaktuar akte ligjore dhe nënligjore të cilat identifikojnë kompetenca të qarta, pa krijuar vonesa në aktet e miratimit të heqjes nga fondi pyjor dhe krijimin e infrastrukturës së nevojshme për ruajtjen e fondit pyjor nga ndikimi i aktivitetit minerar. Institucionet përgjegjëse për sektorin e pyjeve kanë role apo funksione të copëzuara, duke u kthyer në institucione jofunksionale, që nuk shkojnë në drejtim të zbatueshmërisë së ligjit. Për arsyet e mësipërme observacioni juaj nuk merret parasysh dhe do të trajtohet në raportin e auditimit.

Mbi Gjetjen Pika 7, faqe 34, shpjegimi : Lidhur me këtë rekomandim, ju informojmë se, herët në kohë është bërë një diskutim i tillë midis MTM dhe MIE dhe nuk u konkludua me vendimarrje. Mendojmë se ky rekomandim, kërkon shumë ndryshime ligjore dhe nënligjore. Gjithsesi, do të jetë objekt i një diskutimi të përbashkët midis aktorëve për të parë mundësinë e realizimit. Sa i takon lejes mjedisore, kjo leje merret përpara, miratimit përfundimtar të lejes së shfrytëzimit minerar.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Përsa më sipër, lidhur me observacionet e subjektit ju sqarojmë se grupi i auditimit është shprehur qartë mbi mungesën e koherencës dhe paqartësinë e kompetencave në aktet rregullatorë midis MTM, AKP, MIE, AKBN dhe Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të cilat sjellin për rrjedhojë menaxhim të dobët të ekonomive pyjore nga sektorët e pyjeve dhe monitorim të dobët të ndikimit të aktivitetit minerar në fondin pyjor.

Për këtë arsye nga KLSH inkurajohet dhe rekomandohet që Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore si dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore pjesëmarrëse në këtë proces, të marrin masa që sipas kompetencave dhe përgjegjësisë funksionale të përditësojnë aktet rregullatorë në mënyrë që procesi i heqjes nga fondi

pyjor i këtyre sipërfaqeve të kryhet paralel me marrjen e lejes së shfrytëzimit dhe mjedisit dhe pa mbylljen e këtij procesi të mos zbardhet leja e mjedisit dhe e shfrytëzimit të aktivitetit. Nga ana tjetër të konsiderohet hartimi i një formati leje më vete me përmbajtje dhe detyrime, e cila do të kushtëzojë mos fillimin e aktivitetit minerar, pa u kryer heqja nga fondi pyjor e sipërfaqes ku do të punojë subjekti, i cili e ka marrë lejen e aktivitetit minerar.

-Për sa trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit janë paraqitur observacione nga **Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore** me nr. 251 Prot. datë 14.01.2025, administruar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me nr.771/26 Prot. datë 15.01.2025.

Pretendimet e subjektit:

Subjekti në lidhje me “Gjetjet nga auditimi” të projekt raportit nëpërmjet observacioneve AKBN ka paraqitur pretendimet e saj në lidhje me gjetjet e auditimit si më poshtë vijojnë :

Mbi Gjetjen, Pika 2, faqe 26 shpjegimi:

Referuar Ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Nenin 15, pika 5, “Me miratimin e lejes minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, zona e lejuar e shfrytëzimit hiqet nga fondi pyjor e kullësor, pronë shtetërore, zëri “Tokë e zënë, tokë me bimësi pyjore” dhe regjistrohet në zërin “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për ushtrimin e veprimtarisë minerare”. Brenda 10 ditëve nga miratimi i lejes, zotëruesi i saj përgatit dokumentacionin përkatës dhe e dorëzon pranë ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë minerare, e cila brenda 10 ditëve përgatit aplikimin dhe e dërgon pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin.”

Neni 24, pika 10 “Me miratimin e lejes minerare të shfrytëzimit me karrierë të grupit të mineraleve ndërtimore zona e lejuar e shfrytëzimit hiqet nga fondi pyjor e kullësor, pronë shtetërore, zëri “Tokë e zënë, tokë me bimësi pyjore”, dhe regjistrohet në zërin “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për ushtrimin e veprimtarisë minerare”, sipas legjislacionit në fuqi për ndryshimin e zërit kadastral të fondit pyjor e kullësor. Brenda 10 ditëve nga miratimi i lejes, zotëruesi i saj përgatit dokumentacionin përkatës dhe e dorëzon pranë ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë minerare, e cila brenda 10 ditëve përgatit aplikimin dhe e dërgon pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin.” Rekomandimi juaj qëndron. Nga ana e saj Drejtoria e Monitorimit (Sektori i Monitorimit Minerar) dhe Drejtoria Minerare pranë AKBN-së, ka të dhëna të sakta sa i përket sipërfaqeve të prekura nga aktiviteti minerar. Këto sipërfaqe azhurnohen çdo vit dhe pasqyrohen në raportet përkatëse vjetore. Për sa shpreheni mbi vlerësimin e gjendjes reale të fondit pyjor në vend mendojmë se nuk është objekt i veprimtarisë së AKBN-së. Megjithatë, AKBN është e hapur për të ofruar ndihmën e saj sipas kërkesave të institucioneve ligjëbërëse lidhur me këtë problematikë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Përsa më sipër, lidhur me observacionet e subjektit ju sqarojmë se grupi i auditimit është shprehur qartë mbi mungesën e koherencës dhe paqartësinë e kompetencave në aktet rregullatorë midis MTM, AKP, MIE, AKBN dhe Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të cilat sjellin për rrjedhojë menaxhim të dobët të ekonomive pyjore nga sektorët e pyjeve dhe monitorim të dobët të ndikimit të aktivitetit minerar në fondin pyjor. KLSH inkurajon formimin e grupeve të punës të përbashkëta apo tryeza diskutimesh duke përcaktuar akte ligjore dhe nënligjore të cilat identifikojnë kompetenca të qarta, pa krijuar vonesa në aktet e miratimit të heqjes nga fondi pyjor dhe krijimin e infrastrukturës së nevojshme për ruajtjen e fondit pyjor nga ndikimi i aktivitetit minerar.

Mbi Gjetjen, Pika 6, faqe 33 shpjegimi : Në misionin e saj, AKBN si institucion në varësi të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, ka objekt të veprimtarisë zhvillimin, mbikëqyrjen e shfrytëzimit racional të burimeve natyrore, në bazë të politikave qeverisëse, dhe monitorimin e postshfrytëzimit të tyre, në sektorin minerar, hidrokarbur dhe energjetik. Lejet minerare të shfrytëzimit jepen me Akt Miratim nga Ministri sipas planeve 3 – vjeçare të miratuara me VKM pasi janë marrë mendimet dhe miratimit përkatëse nga Institucionet vendimmarrëse qendrore e vendore.

Në zbatim të ligjit minerar dhe detyrave të saj funksionale, AKBN miraton në Këshillin Teknik të saj projektet e shfrytëzimit si dhe sipërfaqet e projektuara që do të preken deri në fund të afatit të

lejes minerare sipas studimit tekniko-ekonomi të paraqitur nga subjektet private që kanë fituar të drejtën e zhvillimit të aktivitetit minerar të shfrytëzimit në procedura konkurruese.

Referuar sipërfaqes totale që do të preket deri në fund të shfrytëzimit, llogaritet vlera totale dhe ajo vjetore e garancisë së rehabilitimit sipas Udhëzimit nr.718 datë 03.10.2011, vlerë e cila tashmë llogaritet sipas vlerave të Udhëzimit nr. 5 datë 30.07.2024 “Për mënyrën e vlerësimit të garancive financiare të lejeve minerare”. Lidhur me heqjen e sipërfaqes së licencuar nga fondi pyjor kullësor është kompetencë e MTM, sipas Nenit 15, pika 5 dhe Neni 24, pika 10 e ligjit minerar 10304 datë 15.07.2010, i ndryshuar. Për përmirësimin e kuadrit ligjor, janë ndërmarre edhe akte/udhëzime si: Udhëzim i Përbashkët, Nr. 18, datë 24.8.2022 “Mbi Garancinë Financiare Për Realizimin E Planit Të Rehabilitimit Të Mjedisit Për Veprimtaritë Minerare” dhe Udhëzim i Përbashkët, datë 24.8.2022 “Për Miratimin E Formatit Standard Për Hartimin E Planit Të Rehabilitimit Të Mjedisit Në Veprimtaritë Minerare”.

AKBN mbetet e hapur për bashkëpunim për çdo iniciativë që do të merret nga institucionet përgjegjëse për ndryshimin e akteve ligjore lidhur me thjeshtimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqeve që do të preken nga aktivitetit minerar.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Përsa më sipër, lidhur me observacionet e subjektit ju sqarojmë se grupi i auditimit është shprehur qartë mbi mungesën e koherencës dhe paqartësinë e kompetencave në aktet rregullatorë midis MTM, AKP, MIE, AKBN dhe Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të cilat sjellin për rrjedhojë menaxhim të dobët të ekonomive pyjore nga sektorët e pyjeve dhe monitorim të dobët të ndikimit të aktivitetit minerar në fondin pyjor, dhe inkurajon thjeshtimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqeve që do të preken nga aktivitetit minerar. Rekomandimi është gjithëpërfshirës për çdo aktor të përfshirë sipas kompetencave dhe përgjegjësisë funksionale të iniciojnë formimin e grupeve të punës të përbashkëta apo tryeza diskutimesh duke përcaktuar akte ligjore dhe nënligjore të cilat identifikojnë kompetenca të qarta, pa krijuar vonesa në aktet e miratimit të heqjes nga fondi pyjor dhe krijimin e infrastrukturës së nevojshme për ruajtjen e fondit pyjor nga ndikimi i aktivitetit minerar.

Mbi Gjetjen, Pika 7, faqe 34 shpjegimi : Për sa citoni në gjetjen tuaj dhe rekomandimin përkatës, procesi i heqjes së sipërfaqes nga fondi pyjor në kushtet aktuale dhe në zbatim të ligjit minerar, është procedure e cila ndiqet nga MIE, MTM dhe struktura të pushtetit vendor. Rekomandimi qëndron dhe jemi plotësisht dakord që procesi i heqjes së sipërfaqeve që do të preken nga shfrytëzimi minerar nga fondi pyjor/kullësor të bëhet njëkohësisht me marrjen e Lejes Mjedisore.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Përsa më sipër, lidhur me observacionet e subjektit ju sqarojmë se grupi i auditimit është shprehur mbi kompetenca gjithëpërfshirëse në zbatim të ligjit minerar duke pasur parasysh që AKBN bën monitorime dhe inspektime të subjekteve që ushtrojnë aktivitet minerar. Rekomandimi është gjithëpërfshirës për çdo aktor të përfshirë sipas kompetencave dhe përgjegjësisë funksionale të iniciojnë formimin e grupeve të punës të përbashkëta apo tryeza diskutimesh duke përcaktuar akte ligjore dhe nënligjore të cilat identifikojnë kompetenca të qarta, pa krijuar vonesa në aktet e miratimit të heqjes nga fondi pyjor dhe krijimin e infrastrukturës së nevojshme për ruajtjen e fondit pyjor nga ndikimi i aktivitetit minerar.

-Për sa trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit janë paraqitur observacione nga **Agjencia Kombëtare e Pyjeve** me nr. 983 Prot. datë 30.12.2024, administruar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me nr.771/22 Prot. datë 31.12.2024.

Pretendimet e subjektit:

Mbi Gjetjen, Pika 3, faqe 31 shpjegimi: Në mbështetje të ligjit 57/2020, datë 30.04.2020: “Për Pyjet”, neni 6, pika 2, AKP-ja ka hartuar programin për nisjen e procesit të IKPK-së. Për realizimin e procesit të Inventarit Kombëtar të Pyjeve dhe Kullotave (IKPK) të këtyre grup sipërfaqeve provë (104 clusterave), është kërkuar një buxhet prej 5.855.200,00 lekë, ku janë përfshirë; Trajnimi i Grupeve të Terrenit që do të kryejnë matjet në terren, Grumbullimi i të

dhënave të terrenit dhe kryerja e matjeve në sipërfaqet provë nga grupet e terrenit, si dhe Kontrolli i Cilësisë së matjeve të kryera nga grupet e terrenit që do të kryhet nga ekipi kyç i IKPK-së pranë AKP-së. Për realizimin e grumbullimit të dhënave të terrenit dhe kryerjes së matjeve në grup sipërfaqet provë, janë planifikuar tre grupe pune terreni me nga tre specialist për grup, grupe këto që do të ngriheshin me krijimin e Agjencive Rajonale për Pyjet.

-Mos krijimi i Agjencive Rajonale për Pyjet (kjo në zbatim të VKM-570 datë 17.07.2019 “për Krijimin, Organizimin dhe Funkcionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”), e bën të pamundur krijimin e grupeve të punës, për kryerjen e matjeve dhe grumbullimin e të dhënave të terrenit e për rrjedhojë mos fillimin dhe vazhdimin e procesit të Inventarit Kombëtar të Pyjeve dhe Kullotave.

-AKP-ja i është drejtuar MTM-së me shkresë Nr. 550/1 Prot për fillimin e punimeve në kuadër të IKPK-së duke i sqaruar problematikën në lidhje me mungesën e personelit për kryerjen e grumbullimit të të dhënave dhe matjeve të terrenit (bashkëlidhur shkresa drejtuar MTM-së)

-Pavarësisht pamundësisë së realizimit të programit për arsyet e mësipërme, AKP-ja ka nisur ciklin e Ri të Inventarizimit Kombëtar të Pyjeve dhe Kullotave me një grup punë prej tre specialistësh, të drejtorisë së Analizës dhe Performancës në Pyje, sektori i Inventarit Kombëtar të Pyjeve. Në bazë të programit të hartuar dhe miratuar për fillimin e punimeve për kryerje e Inventarin Kombëtar të Pyjeve dhe Kullotave, kemi kryer inventarizimin në terren të 16 tufave të sipërfaqeve provë të qarkut Fier, pjesë e 1100 tufave totale të sipërfaqeve provë të IKPK-së. Ky proces do të vazhdojë deri në përmbylljen e ciklit të plotë të Inventarizimit Kombëtar të Pyjeve dhe Kullotave (IKPK).

-Agjencia Kombëtare e Pyjeve ka inicuar procesin e përmirësimit të ALFIS-it që gjatë vitit 2022 duke qënë pjesë e hartimit të termave të referencës për përmirësimin e sistemit.

- Në mënyrë të vazhdueshme i jemi drejtuar institucioneve përgjegjëse dhe AKSHI-it për sigurimin e fondeve dhe zhvillimin sa më parë të procedurave të tenderimit.

- Ky proces është finalizuar së fundmi ku AKP do të ndjekë zbatimin e kontratës me objekt “Përmirësimi i Sistemit Shqiptar të integruar të informacionit në pyje “ALFIS”.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Përsa më sipër, lidhur me observacionet e subjektit ju sqarojmë se grupi i auditimit është shprehur qartë mbi faktet që mungesa e infrastrukturës dhe mosfunksionimi i sistemit të integruar të informacionit (ALFIS) ka bërë që mos të vijojej me procesin e inventarizimit të pyjeve i cili duhet të ishte përfunduar në vitin 2014. Ky proces ka nisur në vitin 2018 dhe ka përfunduar në vitin 2021. Deri në tetor 2022, nuk ka pasur publikim të të dhënave të inventarizimit. Për shkak të mungesës së fondeve, procesi pasardhës i inventarizimit të pyjeve (25% e fondit pyjor), i cili duhet të kryhej në vitin 2023, nuk ka nisur ende. Regjistri Kombëtar i Fondit Pyjor (RKFP)⁷⁸ dhe Sistemi i integruar i informacionit për pyjet (ALFIS) nuk funksionojnë. Aktualisht nuk ka kadastër pyjesh funksionale dhe me informacion të plotë dhe të përditësuar. Për arsyet e mësipërme observacioni juaj nuk merret parasysht dhe do të trajtohet në raportin e auditimit.

-Për sa trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit janë paraqitur observacione nga **Bashkia Selenicë** me nr. 15 Prot. datë 06.01.2025, administruar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me nr.771/24 Prot. datë 08.01.2025.

Pretendimet e subjektit:

Mbi **Gjetjen, Pika 2, Për hartimin e planeve të mbarështimit dhe planet operationale vjetore shpjegimi:**

Vit për vit, që me transferimin e pyje/kullotave Bashkive, në vitin 2016, e deri tani që u mbyll ky vit buxhetor, struktura përgjegjëse e pyjeve në Bashki, ka bërë kërkesë me shkrim për fondet e nevojshme që duhen për të realizuar hartimin e planeve të mbarështimit të ekonomive pyjore, si kushtetuta, nga ana teknike e administrimit të fondit pyjor, por deri tani kërkesat tona kanë rënë në vesh të shurdhet. Për vitin 2025 janë planifikuar 5 000 000 lekë, për hartimin e një plani

⁷⁸ Pika 1, neni 6, e Ligjit nr. 57/2020, datë 30.4.2020 “Për Pyjet”

mbarështimi, te 1 Ekonomie Pyjore, në sipërfaqen e rreth 2 300 ha. Të shohim gjatë zbatimit për realizimin e këtij buxheti.

-Për deri sa nuk janë hartuar planet e mbarështimit të Ekonomive Pyjore, nuk ka sesi të hartohen planet operacionale vjetore të mbarështimit, që është dokumenti i planifikimit të të ardhurave dhe shpenzimeve nga aktivitetet në pyjet publike, buxheti i shteti, donacionet ose grantet e ndryshme për realizimin e punimeve të përcaktuara ose rekomanduara nga planet e mbarështimit, të veprimtarive për zhvillimin dhe mbrojtjen e fondit pyjor.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Përsa më sipër, lidhur me observacionet e subjektit ju sqarojmë se grupi i auditimit është shprehur se Ligji për pyjet në nenin 25 të tij parashikon dhënien në shfrytëzim/përdorim për zhvillimin e veprimtarive në fondin pyjor (p.sh. nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte në karrierë, kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit dhe shfrytëzimit të mineraleve, hidrokarbureve dhe të ujit). Procedurë e cila inicohet nga bashkia, me shpalljen e vendeve dhe shesheve të fondit pyjor ku mund të kryhen këto veprimtari. Këto bëhen duke u lidhur marrëveshje me bashkinë përkatëse ku kryhet aktiviteti mineral referuar Urdhrit të Ministrit të Mjedisit nr. 1, datë 09.06.2016, i cili përcakton rregullat për dhënien në përdorim të Fondit Pyjor nga ana e bashkisë.

Ka mungesë koordinimi kompetencash dhe mungesë koherence në aktet rregullatorë midis MTM, AKP, MIE, AKBN dhe Njësite të Vetëqeverisjes Vendore në iniciimin dhe vazhdimin e aktivitetit mineral në fondin pyjor, sepse zonat pyjore me aktivitet mineral janë në territore të bashkive të cilat aktualisht, kanë probleme me regjistrimin e pasurive pyjore të tyre, të cilat administrohen nga ato.

Për arsyet e mësipërme inkurajohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të marrin masa për hartimin dhe përditësimin e planeve të mbarështimit të ekonomive pyjore dhe mbikëqyrjen e tyre për arritjen e objektivave strategjike, të përcaktuara në Dokumentin e Politikave të Pyjeve.

-Për sa trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit janë paraqitur observacione nga **Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore** me nr. 251 prot., datë 14.01.2025, administruar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me nr. 771/26 prot., datë 15.01.2025.

Pretendimet e subjektit:

Subjekti në lidhje me “Gjetjet nga auditimi” të projekt raportit nëpërmjet observacioneve, AKBN ka paraqitur pretendimet e saj në lidhje me gjetjet e auditimit si më poshtë vijojnë :

-Mbi **Gjetjen** 9.1, faqe 41, shpjegimi:

Spektori i Monitorimit Mineral, Drejtoria e Monitorimit pranë AKBN-së gjatë procesit të monitorimit, verifikon në terren zbatimin e zhvillimit të veprimtarisë minerare të shfrytëzimit në bazë të planit të vjetor të miratuar. Në lidhje me rehabilitimin progresiv të mjedisit , theksojmë se lejet minerare zhvillojnë aktivitetin e tyre të shfrytëzimit në sipërfaqe relativisht të vogël krahasuar me atë të licensuar , për rrjedhojë nuk janë krijuar për rehabilitim progresiv.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa më sipër, sqarojmë se më shpjegimin e dhënë, subjekti nuk hedh poshtë konstatimin cituar më sipër.

-Mbi **Gjetjen** 11.1, faqe 42, shpjegimi:

Monitorimi i subjekteve minerare nga ana e sektorit përkatës në AKBN realizohet sipas një plani të mirëpërcaktuar dhe miratuar nga MIE. Për sa i përket rehabilitimit të mjedisit nuk është detyrë parësore funksionale e AKBN-së pasi në këtë pikë ushtrohen monitorime periodike edhe nga Ministria e Mjedisit, AKM. Megjithatë, Drejtoria e Monitorimit dhe Drejtoria Minerare pranë AKBN-së, aty ku ka qenë e mundur teknikisht ka lënë detyrat përkatëse për fillimin, kryerjen e rehabilitimit progresiv.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa më sipër, sqarojmë se më shpjegimin e dhënë, subjekti nuk hedh poshtë konstatimin cituar më sipër.

-Mbi **Gjetjen** 12.2, faqe 42, shpjegimi: *Lidhur me revokimin e lejes minerare për arsye të mosmiratimit të planit vjetor të punës ka një vakuum ligjor në ligjin minerar dhe të akteve nënligjore të tij. AKBN ka dërguar në MIE me shkresën nr. 5796 prot., datë 28.12.2023 projekt draft për ndryshimet në ligjin minerar ku priten edhe ndryshimet e tij, i cili do të vijojë me ndryshimet e akteve nënligjore të tij.*

Sa më sipër, lidhur me observacionet e subjektit, ato japin një pamje të gjerë dhe qartësojnë proceset e propozimeve për ndryshimet në ligjin minerar, grupi i auditimit i merr në konsideratë këto përpjekje që do të trajtohen në raportin e auditimit, por gjetjet dhe rekomandimet qëndrojnë të pandryshuara, pasi AKBN-ja duhet të sigurohet që të gjitha iniciativat e nisura gjatë vitit 2023, të finalizohen dhe zhvillohen me sukses.

-Për sa trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit janë paraqitur observacione nga **Bashkia Selenicë** me nr. 15 prot., datë 06.01.2025, administruar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me nr. 771/24 prot. datë 08.01.2025.

Pretendimet e subjektit:

Subjekti në lidhje me “Gjetjet nga auditimi” të projekt raportit nëpërmjet observacioneve Bashkia Selenicë ka paraqitur pretendimet e saj në lidhje me gjetjet e auditimit si më poshtë vijojnë:

Për periudhën audituese 2021-2023 Bashkia Selenicë ka kryer inspektime në fondin pyjor nga struktura përkatëse e ngritur, por për aktivitetin minerar që ushtrohet në fondin pyjor nuk janë realizuar kontrole dhe inspektime, pasi janë jashtë kompetencave tona.

2. Në strukturën përgjegjëse për pyjet, ka punonjës me arsim të lartë, por pa arsimin pyjor, pasi në burimet njerëzore që i përkasin territorit të bashkisë Selenicë nuk listohen të ketë persona që e kanë një arsim të tillë.

3. Bashkia Selenicë nuk ka realizuar kryerjen e inspektimeve nëpërmjet sistemit unik e- inspektimi për subjektet minerare që operojnë në fondin pyjor, pasi punonjësit e sektorit të inspektim-kontrollit nuk janë trajnuar nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve, për fillimin e inspektimeve online, pasi në strukturën që funksiononte deri në muajin nëntor, kjo strukturë kishte në përbërjen e saj 2 inspektorë me arsim të mesëm.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa më sipër pretendimi nuk pranohet, sipas shpjegimit të dhënë më sipër.

Pretendimet e subjektit:

Për mos rehabilitimin mjedisor të zonës, që shfrytëzohet në fondin pyjor, nuk është përgjegjëse Bashkia, sipas legjislacionit të aplikueshëm për lejet minerare, por u është lënë në dorë subjekteve minerare, pasi të ketë mbaruar aktiviteti minerar, sipas parashikimeve të realizuara nga AKBN-ja. Siç shikohet dhe legjislacioni për “Sektorin minerarë në Republikën e Shqipërisë”, ka mangësi në kompetencat dhe përgjegjësitë që duhet të kenë Institucionet përkatëse, ku paqartësitë e deritanishme kanë bërë që të mos rehabilitohet mjedisi, në zonat e lejuara për këtë aktivitet.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa më sipër pretendimi nuk pranohet, sipas shpjegimit të dhënë më sipër.

-Për sa trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit janë paraqitur observacione nga **Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore** me nr.251 prot., datë 14.01.2025, administruar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me nr.771/26 prot., datë 15.01.2025.

Pretendimet e subjektit:

Lidhur me rekomandimin tuaj nr. 13.1. faqe 45, për rillojaritjen e vlerave të garancive financiare të rehabilitimit sipas vlerave të rritura të Udhëzimit të MIE, Nr. 5 datë 30.07.2024, nuk qëndron pasi ky Udhëzim nuk ka fuqi prapavepruese. Subjektet private që ushtrojnë aktivitetet minerar në bashkitë e cituara nga Ju, paguajnë rregullisht çdo vit, garancinë financiare të rehabilitimit të mjedisit për lejet përkatëse. Në momentin e përfundimit të afatit ligjor të lejes minerare, subjektet e kanë detyrim ligjor rehabilitimin e sipërfaqeve të prekura nga aktiviteti minerar i shfrytëzimit dhe paraqitjen në Këshillin Teknik pranë AKBN-së, të Planit Përfundimtar të Mbylljes së objektit.

Pas miratimit të udhëzimit të ri, për subjektet të cilat kanë aplikuar për tu pajisur me leje të re shfrytëzimi, zgjerim sipërfaqje apo zgjatje afati nga ana e Këshillit Teknik në AKBN, vlerësimi për llogaritjen e vlerës së garancisë financiare të rehabilitimit është kryer sipas këtij udhëzimi.

Në vijimësi për subjektet, të cilëve do t'ju revokohet leja minerare, do i mbaroj afati, apo subjektet të cilat do të kërkojnë mbyllje të aktivitetit minerar dhe nuk do të bëjnë rehabilitimin e mjedisit por do të lidhin marrëveshje me MIE-n, nga ana e AKBN-së llogaritja e garancisë së rehabilitimit për sipërfaqen e prekur do të bëhet sipas Udhëzimit të MIE Nr. 5 datë 30.07.2024.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Përsa më sipër, lidhur me observacionet e subjektit ju sqarojmë se grupi i auditimit është shprehur qartë për marrjen e masave për rillogaritjen me vlerat e reja të rritura të garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit nga subjektet me aktivitet minerar që ndikojnë në fondin pyjor dhe arkëtimin e tyre si dhe të ndjekë realizimin e planit të rehabilitimit të mjedisit prej tyre. Pretendimi nuk pranohet, sipas shpjegimit të dhënë më sipër.

Pretendimet e subjektit:

Lidhur me **Gjetjen nr. 14.1. faqe 45**, përsa i përket lejeve të revokuara në territorin e bashkisë Krujë, në zonën e mbrojtur “Krastë - Verjon” sipas VKM nr. 468 datë 26.07.2018, janë revokuar/mbaruar afati 21 leje minerare të cilat kanë depozituar vlerat e garancive të rehabilitimit në shumën 19,595,190 lekë. Kjo shumë nuk mjafton për rehabilitimin e sipërfaqes së prekur në këtë zonë pasi duhet të merret parasysh edhe ndryshimi i pagesave për fuqinë punëtore, çmimin e bimëve, etj. Pas revokimit të këtyre lejeve në këtë zonë është punuar nga persona të palicensuar të cilët kanë zgjeruar sipërfaqen e prekur, kanë dëmtuar elementet teknik të karrierës dhe nuk kanë paguar garanci rehabilitimi.

Përsa më sipër AKBN bëri azhurnimin faktik të sipërfaqes së prekur nga aktiviteti i shfrytëzimit dhe përpiloi projektin teknik lidhur me punimet gërmim –sistemimit që duhet të kryhen në këtë zonë. Në bashkëpunim me MTM u përcaktuan termat e referencës për rehabilitimin e zonës së prekur nga shfrytëzimi ku me shkresën nr. 5586 datë 28.10.2024 nga MTM u përcoll mendimi dhe dokumentacioni teknik për rehabilitimin e zonës. Në bazë të termave të referencës dhe Udhëzimit Nr. 5 datë 30.07.2024 u bë rillogaritja e vlerave për koston e rehabilitimit në vlerën 49,551,656 lekë, për rehabilitimin e zonës së ish lejeve në zonën “Krastë-Verjon”.

Me qëllim realizimin e rehabilitimit të kësaj zone dhe kthimin e saj në identitet dhe atraksion turistik, AKBN me shkresën nr. 3462/2 prot datë 04.09.2024 i është drejtuar, Ministrisë së Mbrojtjes ku i kërkohet mbështetje nga forcat e xhenios, me makineri dhe pajisje me qëllim realizimin e punimeve inxhinjerie për ndërtimin e shkallëve/skarpateve dhe përgatitjen e tyre për rehabilitim. Gjatë kësaj periudhe janë kryer në terren verifikime me grupe pune të përbashkëta AKM, AKBN dhe përfaqësues të forcave xheniere lidhur me rehabilitimin e zonës.

AKBN ngelet e hapur për bashkëpunim për të ofruar ndihmën e saj Teknike për realizimin e procesit të rehabilitimit të kësaj zone.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa më sipër pretendimi nuk pranohet, sipas shpjegimit të dhënë më sipër.

Pretendimet e subjektit:

Lidhur me **Gjetjen nr. 15.1. faqe 47**, Rekomandimi Juaj qëndron për institucionet të cilat kanë nën varësi të tyre sipërfaqet përkatëse të pyjeve e kullotave. Drejtoria e Monitorimit dhe Drejtoria Minerare pranë AKBN-së, theksojmë edhe njëherë, ka të dhëna të sakta lidhur me sipërfaqen e prekur nga aktiviteti minerar në bashkitë që Ju përmendi, madje për gjithë territorin e vendit. Këto të dhëna azhurnohen çdo 6 muaj dhe pasqyrohen edhe në raportet përkatëse. Subjektet minerare e kanë detyrim ligjor kryerjen e pagesës së Garancisë Financiare të Rehabilitimit të Mjedisit, vlerë e cila paguhet çdo vit në thesarin e shtetit në llogarinë përkatëse. AKBN është e gatshme të bashkëpunojë me të gjitha institucionet e sipërcituara, duke vënë në dispozicion këto të dhëna.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa më sipër pretendimi nuk pranohet, sipas shpjegimit të dhënë më sipër.

-Për sa trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit janë paraqitur observacione nga **Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit** me nr. 120/1 prot., datë 07.01.2025, administruar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me nr. 771/23 prot., datë 08.01.2025.

Pretendimet e subjektit: Lidhur me **Gjetjen nr. 15, faqe 47, Gjetje:** Konstatohet një ndikim i pakthyesëm në mjedis dhe fondin pyjor nga moskryerja e pyllëzimit kompensues si pasojë e aktivitetit minerar. Ju informojmë se, rehabilitimi si detyrim i lejeve të shfrytëzimit minerar, nuk është i lidhur me detyrimin e pyllëzimit kompensues si rezultat i heqjes nga fondi pyjor dhe duhet të kryhet në mënyrë periodike, sipas planit të rehabilitimit të miratuar i cili është kusht për miratimin e lejes së shfrytëzimit minerar.

Përcaktimi i saktë i sipërfaqeve të fondit pyjor që ndikohen nga lejet minerare aktive, bëhet nëpërmjet përcaktimeve në raportet tekniko-ekonomike, të cilat përgatiten nga strukturat e menaxhimit të pyjeve në bashki, për ato subjekte të cilat kanë aplikuar për heqjen nga fondi pyjor dhe kanë dokumentacion të plotë.

Kontratat për pyllëzimin kompensues apo pagesat për detyrimin e pyllëzimit kompensues, lidhen pas miratimit të heqjes nga fondi pyjor dhe ky detyrim përcaktohet në aktin e miratimit. Ky detyrim është sipas referencave të VKM nr. 537/2021.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa më sipër pretendimi nuk pranohet, pasi rekomandimi konsiston në marrjen e masave për evidentimin dhe përcaktimin e saktë të sipërfaqeve të fondit pyjor që ndikohen nga lejet minerare aktive për të mundësuar lidhjen e kontratave, ndjekjen e punimeve kontraktore për pyllëzimin, ripyllëzimin apo përmirësimin e fondit pyjor të hequr si pasojë e aktivitetit minerar nga subjektet që operojnë në territorin e tyre.

6. ANEKSE

Tabela me lejet minerare aktive në Bashkitë Krujë, Selenicë, Skrapar, Berat, Dimal dhe ndikimi në fondin pyjor sipas MIE, AKBN dhe MTM

| Nr | Nr. Leje | Data Akt-Miratimit | Data QKB | Emri i subjektit | Nipt | Bashkia | Emertimi i vendburimit | Lloji i Mineralit | S=km2 | Lloji i Lejes | Statusi ne MTM |
|----|----------|--------------------|------------|------------------|------------|----------|-------------------------------------|-------------------------|--------|---------------|--|
| 1 | 355/1 | 17.06.1997 | 17.06.1997 | S. B. | K.....M | Selenicë | Selenice | Bitum, Zhavor Bituminoz | 1.543 | Shfrytëzimi | pa kerkese tek ne |
| 2 | 390/1 | 22.01.1998 | 22.01.1998 | R. shpk | J.....N | Selenicë | Jorgo - Mali i Jashikut | Zhavor Bituminoz | 0.099 | Shfrytëzimi | pa kerkeses tek ne |
| 3 | 623/2 | 13.06.2001 | 13.06.2001 | V. LL. shpk | K.....U | Dimal | Konizbalte | Gur Gëlqeror | 0.014 | Shfrytëzimi | draft I përgatitur dt. 17.05.2023, per info per rehabilitimin nr. 1500, dt. 23.02.2024. Nuk ka dhene info |
| 4 | 685/3 | 23.12.2002 | 23.12.2002 | S. Sh.p.k | J.....G | Dimal | Konizbalte-Dinaku | Gur Gëlqeror | 0.1797 | Shfrytëzimi | plotesim dok. nr. 7944/1, dt. 14.12.2020 |
| 5 | 697/2 | 30.04.2003 | 30.04.2003 | G. I B. shpk | K.....O | Dimal | Guri I Bardhe, Veterik | Gur Gëlqeror | 0.0894 | Shfrytëzimi | pa kerkese tek ne |
| 6 | 704/2 | 02.06.2003 | 02.06.2003 | G. C. | K.....K | Dimal | Kodra e Gjelbert | Gur Gëlqeror | 0.012 | Shfrytëzimi | pa kerkese tek ne |
| 7 | 728/2 | 22.09.2003 | 22.09.2003 | SH. shpk | J.....F | Dimal | Ura Vajgurore | Gur Gëlqeror | 0.03 | Shfrytëzimi | pa kerkese tek ne |
| 8 | 739/2 | 05.12.2003 | 05.12.2003 | 2. shpk | K82611004M | Dimal | Poshnjë, Berat | Gur Gëlqeror | 0.059 | Shfrytëzimi | kerkesa te ardhura nga MIE jo nga subjekti, pergjigjur MIEper pezullim procedurash dt. 12.11.2021 per rishikimin e akteve ligjore |
| 9 | 742/2 | 05.12.2003 | 05.12.2003 | A. K.shpk | K.....W | Dimal | Kodra e gjelbert Pashalli Konizbalt | Gur Gëlqeror | 0.121 | Shfrytëzimi | per plotesime nr. 504/1, dt. 9.02.2018, per riplotesime nr. 7249/1, dt. 10.10.2019, per rap.tek.bashkise nr. 7249/3, dt. 31.10.2019, nuk ka ardhur |
| 10 | 778/1 | 26.07.2004 | 26.07.2004 | R. shpk | J.....C | Dimal | Konizbalte, Ura Vajgurore, | Gur Gëlqeror | 0.0383 | Shfrytëzimi | pa kerkese tek ne |
| 11 | 779/1 | 26.07.2004 | 26.07.2004 | ZH. shpk | K.....T | Dimal | Veterrik, jug te Ures Vajgurore | Gur Gëlqeror | 0.053 | Shfrytëzimi | pa kerkese tek ne |
| 12 | 793/1 | 18.08.2004 | 18.08.2004 | A. shpk | K.....B | Dimal | Guri I Bardhe | Gur Gëlqeror | 0.0215 | Shfrytëzimi | pa kerkese tek ne per kete leje |

| | | | | | | | | | | | |
|----|--------|------------|------------|-------------------------------|------------|----------|--------------------------|-------------------------|--------|----------------|---|
| 13 | 794/1 | 20.08.2004 | 20.08.2004 | D. G. shpk | J.....U | Krujë | Borizane | Gur Gëlqeror | 0.198 | Shfrytëzimi | raport teknik nr. 3142/1, dt. 3.05.2018, per statusin nr. 1397/3, dt. 19.09.2022, nuk ka ardhur dok nga bashkia |
| 14 | 795/1 | 08.09.2004 | 08.09.2004 | F.-K. C. F. shpk (S. shpk NK) | K71827801E | Krujë | Zallë, Krujë | Gur Gëlqeror | 1.195 | Shfrytëzimi/NK | rap teknik bashkise nr. 3119/1, dt. 4.05.2017, nga sektori juridik bashkise per VKB nr. 1915/2, dt. 30.04.2021, per regullimin e vkb nr. 1915/5, dt. 27.07.2021, draft ligj i pergatitur, dt. 30.08.2021 |
| 15 | 796/1 | 08.09.2004 | 08.09.2004 | F.-K.C. F. shpk (L. shpk NK) | K.....E | Krujë | Zallë, Krujë | Argjilë | 0.216 | Shfrytëzimi/NK | pa kerkese tek ne |
| 16 | 862/2 | 26.05.2005 | 26.05.2005 | S.P. shpk | K.....U | Skrapar | Melovë | Gëlqeror i mermerizuar | 1.3594 | Shfrytëzimi | per miratim ne KM nr. 2699/4, date 14.06.2017, rishkruar, derguar ne MIE per bashkefirmosje nr. 106, dt. 9.01.2019, bashkise per pagesen nr. 245, dt. 14.01.2019; riderguar ne MIE nr. 6212, dt. 3.07.2019, kthye nga MIE për rishikim ne vitin 2022, draft ligj i pergatitur |
| 17 | 875/2 | 23.06.2005 | 23.06.2005 | V. LL. shpk | K.....U | Dimal | Konizbalte | Gur Gëlqeror | 0.038 | Shfrytëzimi | ka vetem je kerkese per kete subjekt si me lart statusi |
| 18 | 877/1 | 23.06.2005 | 23.06.2005 | M. B. sha (M. shpk NK) | K.....C | Krujë | Derven | Argjilë | 0.0357 | Shfrytëzimi/NK | pa kerkese tek ne |
| 19 | 898/1 | 08.08.2005 | 08.08.2005 | K. shpk | J.....H | Dimal | Guri I Bardhe | Gur Gëlqeror | 0.1015 | Shfrytëzimi | pa kerkese tek ne |
| 20 | 911/3 | 02.09.2005 | 02.09.2005 | S. Sh.p.k | J.....G | Dimal | Guri I Bardhe | Gur Gëlqeror | 0.135 | Shfrytëzimi | pa kerkese tek ne |
| 21 | 969/1 | 05.09.2006 | 05.09.2006 | B. shpk | J.....N | Dimal | Kodra e Gorices | Gur Gëlqeror | 0.1 | Shfrytëzimi | bashkise + subjektit nr. 4458/1, dt. 14.06.2017, pezulluar leja mjedisore |
| 22 | 970/2 | 06.09.2006 | 06.09.2006 | F. shpk | K.....A | Skrapar | Melove | Gëlqeror i mermerizuar | 0.172 | Shfrytëzimi | pa kerkese tek ne |
| 23 | 987/1 | 02.02.2007 | 02.02.2007 | A. C. sh.a (Sh.M. NK) | K.....R | Krujë | Borizane, Droje | Argjilë | 0.5894 | Shfrytëzimi/NK | pa kerkese tek ne |
| 24 | 988/1 | 02.02.2007 | 02.02.2007 | A. C. sh.a (Sh. M. NK) | K.....R | Krujë | Borizane, Picrage, Kruje | Gëlqeror | 0.998 | Shfrytëzimi/NK | miratuar me VKM nr.53, dt. 25.01.2017 |
| 25 | 999/1 | 16.03.2007 | 16.03.2007 | SH. – A. shpk | K.....N | Krujë | Picrage | Gur Gëlqeror | 0.351 | Shfrytëzimi | per miratim ne KM nr. 2697/4, dt. 8.06.2017, per VKB bashkise Kruje nr. 2456, dt. 11.03.2019 |
| 26 | 1101/1 | 06.12.2007 | 06.12.2007 | T.- E. Shpk | J.....G | Berat | Roshnik | Ranor silicor | 0.069 | Shfrytëzimi | ne sistemin e-akte dt. 30.07.2019, bashkise per pagesen e rap.tek. Nr. 7145, Dt. 5.08.2019, rishikuar drafti pas ndryshimeve ligjore |
| 27 | 1115/1 | 12.12.2007 | 12.12.2007 | Xh.K. shpk | K.....D | Selenicë | Resulaj | Zhavor Bituminoz | 1.09 | Shfrytëzimi | pa kerkese tek ne |
| 28 | 1256/1 | 15.10.2008 | 15.10.2008 | E. V. – C. Shpk | K.....U | Krujë | Borizane | Gur Gëlqeror | 0.079 | Shfrytëzimi | pa kerkese tek ne |
| 29 | 1342/2 | 11.05.2009 | 11.05.2009 | I. shpk | L.....H | Krujë | Guri i Lekes | Gur Gëlqeror | 0.0935 | Shfrytëzimi | plotesim dok. Nr. 5264/1, dt. 3.08.2021, bashkise nr. 203/1, dt. 21.01.2022, draft urdher I pergatitur per 0.8271 ha brenda lejes minerare, ne proces shqyrtimi |
| 30 | 1359 | 08.06.2009 | 08.06.2009 | P. R. e S.-B. shpk | K.....D | Berat | Karkanjoz Berat | Ranor silicor | 0.115 | Shfrytëzimi | Mbaruar afati vlefshmerise, nuk ka bere kerkese |
| 31 | 1371 | 22.06.2009 | 22.06.2009 | M. B. shpk | K.....E | Selenicë | Kume-Murriz | Bitum, Zhavor Bituminoz | 0.324 | Shfrytëzimi | pa kerkese tek ne |
| 32 | 1378/1 | 24.06.2009 | 24.06.2009 | M. shpk | K.....H | Dimal | Kodra e Gurit te Bardhe | Gur Gëlqeror | 0.181 | Shfrytëzimi | pa kerkese tek ne |
| 33 | 1379/1 | 03.07.2009 | 03.07.2009 | B. S. shpk | K.....A | Berat | Vodicë Bogdani - Roshnik | Ranor Masiv | 0.167 | Shfrytëzimi | per plotesime dt. 29.01.2018 |
| 34 | 1401/2 | 24.08.2009 | 24.08.2009 | B. & K. shpk (Sh. sh.p.k NK) | L.....R | Krujë | Borizane | Gur Gëlqeror | 0.214 | Shfrytëzimi/NK | per plotesime nr. 1687/1, dt. 19.04.2018 |
| 35 | 1451/1 | 25.01.2010 | 25.01.2010 | K. shpk | M.....F | Krujë | Gryka Shkalles | Gur Gëlqeror | 0.06 | Shfrytëzimi | pa kerkese tek ne |
| 36 | 1496/2 | 10.07.2013 | 10.07.2013 | B. M. I. shpk | K.....Q | Selenicë | Treblove, Romes, Vlore | Rërë Bituminoze | 1.638 | Shfrytëzimi | Leja Nr.1496/2, Revokuar me Nr.1075, prot MIE, dt. 27.01.2023. Leja Nr.1496/3,revokuar |
| 37 | 1496/3 | 20.11.2014 | 26.11.2014 | B.M. I. shpk | K.....Q | Selenicë | Treblove, Romes, Vlore | Rërë Bituminoze | 1.171 | Shfrytëzimi | |

| | | | | | | | | | | | | |
|----|--------|------------|------------|-------------------------------------|---------|----------|--|------------------------|--------|----------------|---|--------------------------------------|
| | | | | | | | | | | | | me Nr.1076 prot MIE, DATE 27.01.2023 |
| 38 | 1502/1 | 13.09.2010 | 08.09.2010 | B. I. shpk | K.....L | Krujë | Mali I Madh, Borizane | Gur Gëlqeror | 0.077 | Shfrytëzimi | pergjigjur Mie per pezullim procedurash dt. 12.11.2021, pasi jane kerkese te ardhura nga MIE jo nga subjekti | |
| 39 | 1541/2 | 04.03.2011 | 09.03.2011 | X. shpk | K.....Q | Krujë | Picërragë | Gur Gëlqeror | 0.218 | Shfrytëzimi | me dokumentacion te plote per draft vkm info per rehabilitimin nr. 1502, dt. 23.02.2024 | |
| 40 | 1548/1 | 27.06.2011 | 29.06.2011 | T.- E. shpk | J.....G | Skrapar | vendoset afer fshatit Mëlove dhe Zaloshnje | Gëlqeror i mermerizuar | 0.642 | Shfrytëzimi | per rap.tek. Bashkise nr. 1597/1, dt. 11.03.2019, draft I pergatitur dt. 7.07.2021, per firme ne kabinet dt. 9.07.2021, draft I r I pergatitur dt. 3.08.2021, per firme ne kabinet, perseritur me ndryshimet dt. 4.10.2021 | |
| 41 | 1562/1 | 01.07.2013 | 04.07.2013 | S. & G. shpk | L.....Q | Berat | Objekti Mbjeshove | Gëlqeror masiv | 1.874 | Shfrytëzimi | pa kerkese tek ne, Heqje dore nga leja | |
| 42 | 1577 | 07.09.2012 | 07.09.2012 | A. shpk | K.....P | Dimal | Objekti "Kodra e Konizbaltes", Ura Vajgurore, Berat. | Gur Gëlqeror | 0.098 | Shfrytëzimi | me dokumentacion te plote per draft vkm per sip. 9.89 ha , draft vkm e pergatitur | |
| 43 | 1578 | 20.09.2012 | 24.09.2013 | B. M. I. shpk (B. P. shpk NK) | K.....Q | Selenicë | "Zona e dyte Resulaj" | Zhavor Bituminoz | 0.137 | Shfrytëzimi/NK | kemi vetem dy leje minerare si me lart | |
| 44 | 1597 | 19.11.2012 | 26.11.2012 | E. shpk | K.....W | Berat | Fshati Kostren i vogël, Berat. | Ranor silicor | 0.0919 | Shfrytëzimi | ngarkuar ne sistemin e-akte per mendim nr. 1073/1, dt.6.03.2017 | |
| 45 | 1617 | 19.03.2013 | 19.03.2013 | Z.F. shpk | L.....T | Skrapar | Zaloshnje | Gëlqeror i mermerizuar | 0.997 | Shfrytëzimi | miratuar me VKM nr. 115, date 15.02.2017 | |
| 46 | 1632 | 10.06.2013 | 11.06.2013 | S. Sh.p.k | J.....G | Dimal | Ura Vajgurore | Gur Gëlqeror | 0.162 | Shfrytëzimi | Miratuar me VKM nr. nr. 906, dt. 21.12.2016 | |
| 47 | 1633 | 13.06.2013 | 14.06.2013 | P.-X shpk (E. M.C. NK) | K.....O | Krujë | Borizanë | Gur Gëlqeror | 0.18 | Shfrytëzimi/NK | per raport teknik Bashkise Kruje nr. 43714, dt.6.07.2016 draft vkm e pergatitur ne v. 2016, | |
| 48 | 1644 | 02.07.2013 | 02.07.2013 | A.-I.shpk (Z. shpk NK) | L.....B | Selenicë | Selenicë | Zhavor Bituminoz | 0.36 | Shfrytëzimi/NK | pa kerkese tek ne | |
| 49 | 1653 | 07.08.2013 | 07.08.2013 | W. S. shpk (M. K-P 2. NK) | L.....U | Skrapar | Melove, Rrethi Skrapar | Gëlqeror i mermerizuar | 0.346 | Shfrytëzimi/NK | pa kerkese tek ne | |
| 50 | 1656 | 16.08.2013 | 16.08.2013 | V. H. shpk (M.-B.NK) & (D. shpk NK) | L.....R | Skrapar | Melove | Gëlqeror | 0.239 | Shfrytëzimi/NK | në procedurë tek bashkia për vkb, dhe për ndryshim drafti me ndryshimet ligjore te ndodhura | |
| 51 | 1658 | 26.08.2013 | 27.08.2013 | A. shpk | K.....B | Dimal | Ura Vajgurore | Gur Gëlqeror | 0.077 | Shfrytëzimi | per plotesime nr. 3154/1, dt. 2.06.2020, rap tek. Nr.m 3154/3, dt. 1.10.2020, ne sistem , per bashkerendim dt. 29.01.2021, ngarkuar dt. 18.03.2021, per pagesen e rap.tek. Nr. 2002, dt. 19.03.2021, per ribashkerendim me MFE, ne kabinet per firme dt. 4.10.2021, per update te draftit me ndryshimet ligjore te ndodhura | |
| 52 | 1659 | 27.08.2013 | 30.08.2013 | V. LL. shpk | K.....U | Dimal | Kodra e Konizbaltës | Gur Gëlqeror | 0.194 | Shfrytëzimi | draft I pergatitur dt. 17.05.2023 tek juristet per shyrtim, zbardhur dt. 6.06.2023, per info per rehabilitimin nr. 1500, dt. 23.02.2024 | |
| 53 | 1661/2 | 06.11.2014 | 06.11.2014 | T.- E. shpk | J.....G | Skrapar | Objekti Mëlovë | Gëlqeror i mermerizuar | 0.931 | Shfrytëzimi | draft ligj I pergatitur perseri m ndryshimet ligjore te ndodhura | |
| 54 | 1675 | 06.09.2013 | 11.09.2013 | V. I. shpk | L.....J | Krujë | Fushe Kruje | Gur Gëlqeror | 1.628 | Shfrytëzimi | Miratuar me VKM nr. 247, dt. 30.3.2016 | |
| 55 | 1694 | 27.03.2014 | 02.04.2014 | T. B. | K.....E | Berat | Bistrivicë, Sinjë, Berat | Gur Gëlqeror | 0.11 | Shfrytëzimi | me dokumentacion te plote per draftim VKM | |
| 56 | 1703 | 23.05.2014 | 23.05.2014 | H.F. | L.....U | Berat | Mbreshtan | Gëlqeror Dekorativ | 0.0757 | Shfrytëzimi | pa kerkese tek ne | |
| 57 | 1719 | 12.06.2014 | 13.06.2014 | D. 2. shpk | L.....B | Skrapar | Objekti "Dorez", Qarku Berat | Ranor silicor | 0.0717 | Shfrytëzimi | miratuar me VKM nr. 824, dt.26.11.2014 | |
| 58 | 1722 | 19.06.2014 | 20.06.2014 | T.- E. Shpk | J.....G | Berat | Karkanjoz | Ranor silicor | 0.061 | Shfrytëzimi | pa kerkese tek ne | |
| 59 | 1750 | 23.04.2015 | 23.04.2015 | XH. shpk | J.....O | Krujë | Objekti Abazaj | Gur Gëlqeror | 0.074 | Shfrytëzimi | pa kerkese tek ne per kete objekt mminerar | |

| | | | | | | | | | | | |
|----|--------|------------|------------|------------------|------------|----------|---------------------------|------------------------|--------|----------------|--|
| 60 | 1753 | 15.05.2015 | 21.05.2015 | B.&A. C. Shpk | L.....A | Selenicë | Objekti Selenicë | Zhavor bituminoz&bitum | 0.322 | Shfrytëzimi | per plotesime dt. 23.10.2017 |
| 61 | 1754 | 21.05.2015 | 22.05.2015 | B. G. | L.....I | Selenicë | Objekti Selenicë | Zhavor bituminoz&bitum | 0.251 | Shfrytëzimi | pa kerkese tek ne |
| 62 | 1755 | 21.05.2015 | 21.05.2015 | A. shpk | K.....D | Skrapar | Objekti Përroi I Bigasit | Ranor silicor | 0.062 | Shfrytëzimi | bashkise epr rap.tek. Nr. 2922, dt. 16.03.2018, per bashkefirmosje ne MIE nr. 8716, dt. 26.10.2018, per pagesen dhe VKB dt. 5.01.2019, per rregullim te vkb nr. 586, dt. 17.01.2020, ardhur dt. 27.10.2020, rishkruar dt. 19.02.2021, tek juristet, zbardhur ne kabinet per firme dt. 23.02.2021, ngarkuar ne sistem dt. 2.03.2021, per bashkerendim me MFE ne kabinet per firme dt. 9.04.2021, per pagesen e rap tek nr. 2547, dt. 12.04.2021, per bashkerendim me MFE nr. 2590, dt. 14.04.2021, per miratim ne KM nr. 5943, dt. 26.08.2021, ngarkuar ne sistem dt. 1.09.2021 |
| 63 | 1756 | 21.05.2015 | 28.05.2015 | F. K. C. F. shpk | K04226208A | Krujë | Objekti Fush Krujë | Gur Gëlqeror | 0.793 | Shfrytëzimi | rap teknik bashkise nr. 3119/1, dt. 4.05.2017, bashkise rikujtese nr. 1915, dt. 16.03.2021, draft ligj I pergatitur, dt. 30.03.2021. nga sektori juridik bashkise per VKB nr. 1915/2, dt. 30.04.2021, per rregullimin e vkb nr. 1915/5, dt. 27.07.2021, draft ligj i pergatitur, per sip. 62.09 ha |
| 64 | 1768 | 21.09.2015 | 21.09.2015 | D. shpk | L.....U | Skrapar | Objekti "Bregu i Kallmit" | Ranor silicor | 0.063 | Shfrytëzimi | miratuar me VKm nr. 824, dt.26.11.2014 per lejen nr.1719, dt.12.06.2014 |
| 65 | 1785 | 10.12.2015 | 10.12.2015 | H. shpk | K.....V | Krujë | Shkëmbi I Vajës | Gur Gëlqeror | 0.0265 | Shfrytëzimi | bashkise Kruje per raport teknik nr. 4410, dt.8.07.2016, subjektit nr. 948/1, dt. 15.11.2017, subjektit nr. 948/2, dt. 16.01.2018, per subjektin nr. 7876/1, dt. 4.11.2019 AKZM ka kerkuar heqjen e lejes mjedisore pasi prek zonen buferike te monumentit te natyres"Gryka e Vajës", pergjigjur per mosvijimin e procedurave |
| 66 | 1789 | 14.01.2016 | 14.01.2016 | Y. S. shpk | L.....T | Selenicë | Lepenicë | Gëlqeror Dekorativ | 0.198 | Shfrytëzimi | MEI nr.592, dt.26.01.2017, Lepenive ne MIE nr. 6790, dt. 15.08.2018, per VKB, nr. 83, dt. 8.01.2019, rikerkesa per VKB nr. 9396, dt. 4.11.2019, info per proceduren nr. 6566/1, dt. 12.09.2022, dokumentacion I plote per miratimin me ligj per sip. 19.8 ha |
| 67 | 1792/1 | 10.03.2016 | 10.03.2016 | A.-2. shpk | L.....B | Selenicë | Lepenicë, Vlorë | Gëlqeror Dekorativ | 0.268 | Shfrytëzimi | per plotesime nr. 5974/1, dt. 17.08.2017, rap. Tek. Bashkise nr. 7458, dt. 14.09.2018, draft vkm e pergatitur, per rishikim te aktit pas ndryshimeve ligjore pasi sip eshte 14 ha dhe kerkohet miratim me ligj |
| 68 | 1806 | 21.06.2016 | 22.06.2016 | K. shpk | L.....A | Dimal | Objekti Vokopolë | Gur Gëlqeror | 0.554 | Shfrytëzimi | pe plotesime nr. 524/1, dt. 9.02.2018 |
| 69 | 1811 | 12.07.2016 | 13.07.2016 | D. (R. shpk NK) | L.....H | Skrapar | Objekti Mëlovë | Gëlqeror i mermerizuar | 0.66 | Shfrytëzimi/NK | pa kerkese tek ne |

| | | | | | | | | | | | |
|----|--------|------------|------------|------------------|------------|----------|--------------------------|---|-------|-------------|---|
| 70 | 1816 | 29.08.2016 | 13.09.2016 | B. shpk | J.....N | Dimal | Objekti Pashallia, Berat | Gur Gëlqeror | 0.17 | Shfrytëzimi | bashkise + subjektit nr. 4458/1, dt. 14.06.2017, pezulluar leja mjedisore |
| 71 | 1826 | 12.12.2016 | 12.12.2016 | M.P. shpk | L.....U | Selenicë | Lepenicë, Vlorë | Gelqeror Organogjeno Coprizor | 0.997 | Shfrytëzimi | per rap tek nr. 4772/4, dt. 3.12.2018, ne MIE nr. 6428, dt. 10.07.2019, kthyer per rishikim nga MIE v. 2022, per statusin dt. 29.09.2023, per info per rehabilitimin nr. 1499, dt. 23.02.2024 |
| 72 | 1833 | 10.05.2017 | 21.03.2017 | B. & B. shpk | K.....T | Skrapar | Objekt Radësh | Gur Gëlqeror | 0.027 | Shfrytëzimi | per rap tek bashkise nr. 4183/1, dt. 30.05.2017 |
| 73 | 1834 | 13.06.2017 | 15.06.2017 | G. M. M. A. shpk | L.....K | Skrapar | Objekti Gryka Devrie | Gëlqeror i mermerizuar | 3.242 | Shfrytëzimi | per plotesime dt. 20.11.2017, per rap.tek. Bashkise nr. 2825/1, dt. 19.04.2018, subjektit nr. 2825/3, dt. 21.06.2018, bashkise + subjektit nr. 8060/1 dt. 30.09.2019, per vijim procedurash bashkise pasi ka fituar gjyqin nr. 6364, dt. 25.09.2020 |
| 74 | 1851 | 09.11.2017 | 10.11.2017 | P. N. shpk | K.....Q | Skrapar | Objekti Zogasi | Ranor Silicor | 0.031 | Shfrytëzimi | Miratuar VKM nr. 427, dt. 11.07.2018 |
| 75 | 1863 | 16.07.2018 | 17.07.2018 | S. M. shpk | L.....K | Selenicë | Brataj | Gëlqeror masiv | 1.329 | Shfrytëzimi | per plotesime nr. 80/1, dt. 17.01.2022, ardhur dt. 7.02.2022, per pezullimin e procedurave nga ndryshimet ligjore te ndodhura dt. 21.02.2022, per statusin e procedures nr. 2578/1, dt. 23.03.2022 |
| 76 | 1867 | 17.10.2018 | 17.10.2018 | B. A. | L.....G | Selenice | Kaninë | Gur Gëlqeror | 2.48 | Shfrytëzimi | per bashkefirmosje ne MIE nr. 2600, dt. 13.03.2019, per mendim nr. 5681, dt. 17.06.2019, hedhur ne sistem dt. 17.06.2019, per pagesen nr. 5753, dt. 18.06.2019, nuk eshte miratuar ne KM |
| 77 | 1890/1 | 10.04.2020 | 10.04.2020 | P.M.G. shpk | K.....D | Skrapar | Objekti Nikollara | Gëlqeror i mermerizuar | 0.522 | Shfrytëzimi | bashkiesnr. 3090/1, dt. 14.05.2020 |
| 78 | 1891 | 18.05.2020 | 20.05.2020 | S. shpk | K.....A | Dimal | Objekti Ura Vajguore | Gur Gëlqeror | 0.365 | Shfrytëzimi | procesuar nr. 1238/1, dt. 27.02.2023, ardhur aplikimi on line dt. 10.07.2024, per plotesime nr. 4673, dt. 12.07.2024 |
| 79 | 1895 | 11.11.2020 | 12.11.2020 | R.E. shpk | L.....U | Krujë | Arrameras | Argjilë me ndërthurje të pakta ranorësh të shkrifët | 0.023 | Shfrytëzimi | pa kerkese tek ne |
| 80 | 1896 | 11.11.2020 | 13.11.2020 | P.S. shpk | L.....L | Skrapar | Sinje | Ranor Silicor (shtrese-trashe) | 0.07 | Shfrytëzimi | per plotesime nr. 1997/1, dt. 18.10.2021, ardhur vkb+ok prefektit dt. 11.05.2022, per riplotesime nr. 4169/1, dt. 19.05.2022 |
| 81 | 1906 | 18.01.2021 | 21.01.2021 | XH. shpk | J745172020 | Krujë | Picrage 2 | Gur Gëlqeror | 0.306 | Shfrytëzimi | plotesim dok nr. 6614/1, dt. 1.10.2021, bashkise per rap.tek.+vkb nr. 6614/3, dt. 27.10.2021, per statusin e procedures pergjigjur MIE+subjektit nr.5459/1, dt. 1.11.2023, me dokumentacion te plote per draft ligj per sip. 18.97 ha |
| 82 | 1909 | 19.05.2021 | 20.05.2021 | K. shpk | K.....J | Berat | Mbreshtan | Gëlqeror pllakor | 0.135 | Shfrytëzimi | me dokumentacion te plote per hartim vkm |
| 83 | 1930 | 24.03.2022 | 28.03.2022 | M. shpk | K.....H | Skrapar | Objekti Leshnje | Gëlqeror i mermerizuar | 0.426 | Shfrytëzimi | pa kerkese tek ne |
| 84 | 1943 | 17.02.2023 | 17.02.2023 | B. S. shpk | M.....E | Selenicë | Objekti Brataj | Gëlqeror Dekorativ | 0.24 | Shfrytëzimi | procesuar nr. 1357/1, dt. 27.02.2023, per rap.tek. Bashkise nr. 1357/3, dt. 17.05.2023, ardhur nga bashkia dt. 1.06.2023, draftuar dt. 6.06.2023 |
| 85 | 1948 | 14.06.2023 | 16.06.2023 | S. A. shpk | K.....C | Skrapar | Objekti Nikollara | Gëlqeror Dekorativ | 0.194 | Shfrytëzimi | pa kerkese tek ne |
| 86 | 1950 | 17.07.2023 | 19.07.2023 | K.-S. shpk | L.....C | Skrapar | Objekti Polenë | Ranor Pllakor (bllok) | 0.095 | Shfrytëzimi | per kerkesen on line dt. 6.02.2024 |
| 87 | 1958 | 13.12.2023 | 15.12.2023 | G. A. shpk | K.....S | Krujë | Objekti Borizanë | Gur Gëlqeror | 0.161 | Shfrytëzimi | pa kerkese tek ne |

Foto të kryera gjatë vizitave në terren

Bashkia Çorovodë



Pamje nga një rehabilitim pjesor Bashkia Çorovodë (Grupi i auditimit, 2024)

Bashkia Krujë



Pamje nga një rehabilitim Bashkia Krujë (Grupi i auditimit, 2024)




Pamje nga shfrytëzim mermeri pa rehabilim Bashkia Çorovodë (Grupi i auditimit, 2024)

Bashkia Selenicë



Pamje nga shfrytëzim mermeri pa rehabilim Bashkia Selenicë (Grupi i auditimit, 2024)

Bashkia Berat



Pamje nga shfrytëzim guri gëlqeror pa rehabilitim Bashkia Berat (Grupi i auditimit, 2024)

Bashkia Dimal



Pamje nga shfrytëzim guri gëlqeror pa rehabilitim Bashkia Dimal (Grupi i auditimit, 2024)

Bashkia Krujë



Pamje nga shfrytëzim guri gëlqeror pa rehabilitim Bashkia Krujë (Grupi i auditimit, 2024)

Bashkia Dimal



Pamje nga ripyllëzim kompensues Bashkia Dimal (Grupi i auditimit, 2024)

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT